AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT

Janar – Dhjetor 2015

RAPORT VJETOR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

31 MARS 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES 2

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR VITIN 2015 6

TË ARRITURAT KRYESORE 6

SHITJA E ASETEVE 6

LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE 7

PAGESAT PËR PUNËTORËT E NDËRMARRJEVE SHOQËRORE (20%) 8

TRAJTIMI I ASETEVE TË UZURPUARA 8

FINANCAT DHE BUXHETI 11

SFIDAT KRYESORE NË PERIUDHËN E ARDHSHME 12

SFIDAT KRYESORE NË PËRMBYLLJEN E LIKUIDIMIT TË NSH-VE 13

RREGULLORET DHE PROCEDURAT E APROVUARA GJATË VITIT 2015 NGA AGJENCIA 14

PASQYRA E GJENDJES SË PROCESEVE 14

PASQYRA E GJENDJES SË FONDEVE NË MIRËBESIM 17

2. KORNIZA LIGJORE 20

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM NË KUADËR TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT 20

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT 22

3.1. MISIONI DHE VIZIONI 22

3.2. KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT 22

4.FUSHËVEPRIMI QË E MBULON AGJENCIA 23

BORDI I DREJTORËVE 24

ORGANIZIMI, VEPRIMTARIA, BURIMET NJERËZORE DHE PAGAT E AGJENCISË, ASETET 27

SHPALOSJE LIDHUR ME BORDIN E DREJTORËVE DHE MENAXHMENTIN 28

RËNDËSIA, NDËRLIDHJA DHE SFIDAT KRYESORE PËR REALIZIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR VITIN 2016 28

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 30

5.1. DEPARTAMENTI I SHITJES 30

SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E VEÇANTË E GJYKATËS SUPREME 30

SHITJET E PAPËRFUNDUARA: 31

5.2. NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITOR 32

5.3. NJËSIA PËR KONTROLLË DHE MBIKËQYRJE 34

5.4. NJËSIA E ADMINISTRIMIT DIREKT 46

5.5. DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUDIMIT 50

NJËSIA PER MENAXHIMIN E PROJEKTIT TË LIKUIDIMIT 50

NJËSIA PËR LIKUIDIMIN E NSH-VE NGA AKP-JA 53

NJËSIA PËR LISTAT E PUNËTORËVE PËR 20% 53

5.6. NJËSIA E RIORGANIZIMIT DHE ADMINISTRIMI I NSH-VE 54

5.7. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL 57

TRAJTIMI I ASETEVE TË UZURPUARA 57

5.8. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT 59

5.9. DEPARTAMENTI LIGJOR 65

5.10. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS 67

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE 67

NJËSITË TJERA TË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS 70

5.11. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT 72

5.12. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM 74

5.13. NJËSIA PËR MEDIA DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN 77

5.14. KOMISIONET 78

KOMISIONI I BANESAVE PËR NSH-TË - SHITJA 78

KOMISIONI PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE JOLIGJORE NË PRONAT E NSH-VE 78

KOMISIONI PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE - KPS 79

6. PJESA TEKSTUALE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA 80

7. RAPORTI PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 85

SHTOJCA 1. LISTA E NDËRMARRJEVE NËN ADMINISTRIM DIREKT SIPAS NENIT 6.1 96

SHTOJCA 2. LISTA E TRANSAKSIONEVE SIPAS NENIT 9 96

SHTOJCA 3. LISTA E NDËRMARRJEVE NË PROCES TË RIORGANIZIMIT 96

SHTOJCA 4. LISTA E NDËRMARRJEVE TË LIKUIDUARA SIPAS NENIT 9 97

SHTOJCA 5. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT 98

8. LISTA E RAPORTEVE FINANCIARE VJETORE 99

PJESA TABELARE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA TË KUVENDIT TË KOSOVËS (FAQE 1 DERI 12) 99

EKSTRAKTE NGA PASQYRAT FINANCIARE TË BUXHETIT VJETOR TË AGJENCISË (FAQE 1 DERI 19) 99

EKSTRAKTE NGA PASQYRAT FINANCIARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM (FAQE 1 DERI 29) 99

PËR VËMENDJEN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS:

Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit i plotëson kërkesat ligjore për raportim sipas nenit 20.1 të ligjit të AKP-së.

Raporti është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së dhe dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform nenit 20.1 të ligjit të AKP-së.

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE PËR VITIN 2015

Në këtë kapitull është paraqitur një përmbledhje e shkurtër për periudhën deri më 31 Dhjetor 2015 lidhur me këto fusha:

- Të arriturat kryesore;
- Shitja e aseteve;
- Likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Pagesat për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (20%);
- Administrimi dhe monitorimi i NSH-ve;
- Trajtimi i aseteve të uzurpuara;
- Përmbledhje lidhur me financat.

TË ARRITURAT KRYESORE

- Përkushtimi i personelit të Agjencisë në tejkalimin e sfidave të paraqitura;
- Shpërndarja e 20 % për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Rritja e efikasitetit në administrimin, kontrollimin dhe monitorimin e NSh-ve, Spin-Offet special dhe privatizimeve me kushte;
- Trajtimi i aseteve të uzurpuara apo të shfrytëzuara pa bazë ligjore nga palët e treta;
- Rritja e jashtëzakonshme e inkasimit të qirasë;
- Bashkëpunimi me Komunat;
- Shqyrtimi i kërkesave të kreditorëve.

SHITJA E ASETEVE

Gjatë vitit 2015 AKP nuk ka realizuar asnjë shitje të aseteve për shkak të mungesës së Bordit të Drejtorëve.

Rezultatet tabelare të numrit të shitjeve (kontratave të nënshkruara) dhe totali i shitjeve nga Qershor 2002 – Dhjetor 2015:

	Tërë procesi Qershor 2002 – Dhjetor 2015	Gjithsej të ardhurat nga shitjet
Shitja e ndërmarrjeve të reja	763	572,987,929
Shitja e aseteve të NSH-ve në likuidim	523	87,235,540
Gjithsej numri i kontratave	**1,286**	**660,223,469**

Një përmbledhje lidhur me numrin e shitjeve të Ndërmarrjeve të Reja dhe aseteve në likuidim është paraqitur në dy tabelat e mëposhtme.

Numri i NSH-ve nën administrim të AKP-së	**518**	**1**	
Numri i NSh-ve në likuidim për të cilat ka pasur shitje (ndërmarrje e re apo shitje në likuidim)	316	2	
Numri i NSh-ve të cilat nuk janë në likuidim, por që ka pasur shitje të Ndermarrjeve të Reja	13	3	
Numri i NSH-ve nga të cilat ka pasur shitje të pronave	**329**	**4=2+3**	**68%**
Numri i NSH-ve të cilat nuk kanë asete	31	5	
Numri i NSH-ve nga të cilat NUK ka pasur shitje të pronave	**158**	**6=1-4-5**	**32%**

Numri i NSH-ve në likuidim	462
Numri i NSh-ve të cilat nuk kanë asete e që janë vendosur në likuidim*	18
Numri i NSH-ve të cilat janë në likuidim, por që s'ka pasur asnjë shitje	129

LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Numri total i NSh-ve për të cilat ka filluar procesi i likuidimit është 462. Gjatë periudhës raportuese janë dorëzuar 820 kërkesa kreditore, përderisa janë shqyrtuar dhe dërguar 7,825 vendime tek pretenduesit. Autoritetet e Likuidimit të NSh-ve në Likuidim kanë përgatitur raportet përfundimtare dhe raportet për shpërndarje për 25 Ndërmarrje Shoqërore, si dhe 263 Draft Raporte për Shpërndarje për Ndërmarrjet Shoqërore në Likuidim.
Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë nën procesin e likuidimit, vetëm për 25 NSh janë përgatitur raportet përfundimtare, ose ato të shpërndarjes përfundimtare apo të përkohshme të fondeve. Procedurat e likuidimit janë në vazhdim e sipër për 455 NSh (7 NSh janë të mbyllura).

Rezultatet tabelare të likuidimit:

	Janar - Dhjetor 2015	**Tërë procesi**
Numri i NSh-ve në likuidim	2	462
Numri i kërkesave të parashtruara të kreditorëve	820	89,630
Numri i kërkesave të shqyrtuara	7,825	89,268
Numri i NSh-ve të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) (NSh-të pa asete apo pa kërkesa kreditore)	0	7
Numri i raporteve përfundimtare dorëzuar nga AL[1] te Dhoma e Posaçme për mbyllje të NSh-së (në pritje të vendimit)	0	6
Numri i raporteve të shpërndarjes përfundimtare	0	19
Numri i draft raporteve për shpërndarje të pagesave të kreditorëve	108	263

[1] AL – Autoriteti i Likuidimit

PAGESAT PËR PUNËTORËT E NDËRMARRJEVE SHOQËRORE (20%)

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia nuk ka publikuar lista të punëtorëve. Shpërndarja e pjesshme të 20 % për punëtorët e kualifikuar për 67 Ndërmarrje Shoqërore dhe shpërndarjen nga shitjet e mëpastajshme të aseteve.

Rezultatet tabelare të 20%-it:

	Janar - Dhjetor 2015	Tërë procesi
Shuma e shpërndarjeve të 20%-it për punëtorët e NSh-ve	8,028,314	104,245,154
Lista finale të punëtorëve	0	312
Vendime të formës së prerë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës	23	127
Listat në pritje për shqyrtim nga gjykata		185
Numri i punëtorëve për të cilët janë bërë pagesat		43,053
Shuma e fondeve të gatshme për shpërndarje punëtorëve posa të shqyrtohen ankesat nga Gjykata Supreme		25,021,170

TRAJTIMI I ASETEVE TË UZURPUARA

Duke marrë në konsideratë pengesat e njëpasnjëshme që kanë paraqitur uzurpatorët para dhe gjatë procesit të shitjes, më 21 Nëntor 2014 Menaxhmenti ka marr vendim që tash e tutje të gjitha asetet që do të publikohen për shitje paraprakisht të lirohen nga uzurpatorët me ndihmën e Policisë së Kosovës sipas nenit 26 të ligjit të AKP-së dhe se asnjë kontratë nuk do të përfundohet/dorëzohet te blerësi pa u liruar aseti nga uzurpatorët. Më 10 Dhjetor 2014 Menaxhmenti ka aprovuar Udhëzuesin për Trajtimin e Aseteve të Uzurpuara.

Vendimi i është përcjellë të gjitha 9 (nëntë) Odave ekonomike në Kosovës si dhe të gjithë investitorëve në databazën e Agjencisë.

Numri i aseteve që shfrytëzohen nga palët e treta (deri 3 Mars 2016 është paraqitur më poshtë):

Sipas rajoneve dhe llojit të shfrytëzuesit

Rajoni	uzurpator	rast social	institucion vendor	institucion nderkombetar	ndërmarrje publike	shprehje e interesit per qira	Gjithsej
Prishtina	49	2	7	1	1	4	64
Peja	27	3	0	0	1	3	34
Prizren	3	0	21	0	2	1	27
Gjilan	1	2	21	2	4	0	30
Mitrovica	87	6	15	0	0	7	115
Gjithsej	**167**	**13**	**64**	**3**	**8**	**15**	**270**

Sipas rajoneve dhe subjektit fizik apo juridik që i shfrytëzon asetet

Rajoni	fizik	juridik	
Prishtina	**23**	**41**	**64**
Peja	**26**	**8**	**34**
Prizren	**3**	**24**	**27**
Gjilan	**3**	**27**	**30**
Mitrovica	**78**	**37**	**115**
Gjithsej	**133**	**137**	**270**

Planifikohet që adresimi i aseteve të uzurpuara të bëhet në vazhdim gjatë vitit 2016.

Është planifikuar që nuk do të ketë asete të uzurpuara, përveç atyre aseteve lirimi i të cilave nuk varet krejtësisht nga veprimet dhe vullneti ynë, mirëpo kryesisht kanë të bëjnë me probleme të ndryshme që janë përtej kontrollit të AKP-së. Si rrjedhojë në vitin 2016 fokus i yni në segmentin e trajtimit të aseteve të uzurpuara do të jetë trajtimi i problemeve ligjore/pronësore në mënyrë që edhe këto asete të trajtohen konform udhëzuesit për lirimin e aseteve të Uzurpuara.

Lirimi i aseteve përbën një prej lajmeve më dobiprurëse në të mirë të investitorëve dhe në përmirësimin e pasqyrimit të Kosovës ndaj investitorëve të huaj.

Të dhënat në lidhje me numrin e lirimit të aseteve të NSH-ve nga uzurpatorët dhe numrin e kontratave të nënshkruara, pas marrjes së vendimit për lirimin e aseteve nga uzurpatorët dhe aprovimin e Udhëzuesit më 10 Dhjetor 2014 e deri në fund të periudhës raportuese është si në vijim:

Pershkrimi	Gjilani	Mitrovica	Prishtina	Prizreni	Peja	Gjithsej
Liruar nga Uzurpatorët	6	14	57	14	25	**116**
Hyrja në marrëdhenie kontraktuale me ish-shfrytëzuesit që e kanë pranuar autoritetin administrativ të AKP-së	11	36	77	10	60	**194**

Si rrjedhojë e veprimeve të marra nga Agjencia për lirimin e aseteve të uzurpuara si dhe rritjes së efikasitetit në administrimin e aseteve paraqiten rritje të theksuara të inkasimit të qirasë në vitin 2015 në krahasim me vitin 2014:

Lloji i llogarive bankare	Të hyrat nga inkasimi i Qirasë Viti 2015	Të hyrat nga Inkasimi i Qirasë Viti 2014	Rritja e qirasë	Rritja me %
Likuidim	1,838,944	975,844	**863,099**	**88.45%**

Para të NSH-ve në mirëbesim	1,398,804	475,407	**923,397**	**194.23%**
GJITHSEJ	**3,237,748**	**1,451,252**	**1,786,496**	**123.10%**

* Të hyrat e qirasë në këtë tabelë nuk përfshijnë inkasimin e qirave të NSh-ve në likuidim si Tregu, ABC Genci, Grand Hotel dhe Pallati i Rinisë Kulturës dhe Sporteve.

Ndërsa nëse llogarisim periudhën para dhe pas marrjes së vendimit për lirimin e aseteve:

	A	B	**C=A+B**	E=B/C
Lloji i llogarive bankare	**Para marrjes së vendimit 1 Janar 2003 deri 20 Nëntor 2014**	**Pas marrjes së vendimit 21 Nëntor 2014 deri 31 Dhjetor 2015**	**Gjithsej**	**Pjesëmarrja e shumës totale të inkasuar**
Likuidim	2,070,803	1,962,679	**4,033,482**	48.66%
Para të NSH-ve në mirëbesim	6,866,643	1,494,154	**8,360,797**	17.87%
GJITHSEJ	**8,937,446**	**3,456,833**	**12,394,279**	**27.89%**

Prej vitit 2002 e deri më 21 Nëntor 2014 janë inkasuar 8.9 milion euro, prej tyre 4.5 milion janë inkasuar përmes marrëveshjeve me institucionet ndërkombëtare për pagesa të borxheve ndaj NSH-ve, ndërsa 4.4 milion janë inkasuar me qiradhënësit tjerë.

Ndërsa, prej marrjes së vendimit për lirimin e aseteve nga uzurpatorët më 21 Nëntor 2014, pra vetëm gjatë periudhës 13 mujore (Dhjetor 2014 deri 31 Dhjetor 2015) janë inkasuar 3.45 milion euro nga qiradhënia e aseteve apo 77% sa tërë inkasimi i qirasë (4.4 milion) që është realizuar në 12 vitet e mëparshme.

Sa i përket vendimit për lirimin e pronave nga uzurpatorët ka rezultuar në perfomancë të shkëlqyer në administrimin e aseteve.

Sipas nenit 3.7.1. të Udhëzuesit për Likuidim i aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në Shtator 2011, Autoritetet e Likuidimit janë të autorizuara të vazhdojnë kontratat e qirasë ose dhënien me qira të cilësdo pronë të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim.

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e muajit Gusht 2014 kishte aprovuar Rregulloren për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat ende nuk janë vendosur në procesin e likuidimit. Në të njëjtën mbledhje, Bordi kishte vendosur dhe autorizuar Autoritetin e Likuidimit që në bashkëpunim me Menaxhmentin të përgatitë edhe rregulloren për qiradhënie e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim.

Aprovimi dhe zbatimi i vendimit për largimin e uzurpatorëve, Udhëzuesit për Trajtimin e Uzurpatorëve dhe Rregullave të Qiradhënies së Aseteve të NSH-ve në likuidim ka mundësuar që Agjencia të administroj sic duhet asetet e NSH-ve dhe të inkasoj 2.8 milion euro të qirasë sic është paraqitur në këtë raport.

Që nga aprovimi në Gusht 2014 dhe Nëntor 2014 i vendimeve dhe rregulloreve për vendosjen nën administrim ligjor të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, janë shpallur gjithsej 27 tenderë publik për qiradhënie afat shkurtër për 357 asete të NSH-ve.

Të gjitha fondet e inkasuara të qirasë janë të vendosura në llogaritë bankare në mirëbesim në Bankën Qendrore të Kosovës dhe nuk përdoren për nevojat e Agjencisë në asnjë rast.

Agjencia në bazë të obligimeve ligjore është duke bërë në mënyrë progresive identifikimin dhe administrimin në mirëbesim të aseteve deri në likuidimin e NSH-ve. Gjatë vitit 2015 janë identifikuar edhe 79 asete të reja.

Agjencia është zotuar se në të ardhmen asnjë shitje nuk do të ndodhë pa u liruar aseti nga uzurpatorët, duke mundësuar kështu rritje të numrit të të interesuarve për blerjen e këtyre aseteve dhe rrjedhimisht rritjes së çmimit të shitjeve.

FINANCAT DHE BUXHETI

Pasqyrat Financiare të buxhetit vjetor

Pasqyrat financiare për periudhën janar - dhjetor 2015 janë dorëzuar brenda afatit ligjor në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave. Burim kryesor i financimit për buxhetin e Agjencisë janë të Hyrat e Dedikuara që mbulon aktivitetet direkte administrative dhe operative të saj sipas nenit 21 të ligjit të AKP-së.

Përmbledhja e rezultateve financiare nga buxheti vjetor i të hyrave të dedikuara dhe Granti Qeveritar:

BUXHETI PËRFUNDIMTAR	JANAR – DHJETOR 2015
Buxheti deri më 31 Dhjetor 2015	6,822,356
Alokimet vjetore	**6,775,720**
Shpenzimet: (87 % të buxhetit apo 88% të alokimeve)	5,970,268
Numri i transaksioneve	2,877

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim

Pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim për periudhën janar – dhjetor 2015 janë dorëzuar brenda afateve ligjore në Ministrinë e Financave. Buxheti për Fondet në mirëbesim është për ndërmarrjet shoqërore të cilat hyjnë në likuidim është rreth 13.3 milion euro për shpenzimet e likuidimit si dhe 20 milion euro për Autoritetin e Likuidimit. Buxheti përfshinë periudhën që nga hyrja e Ndërmarrjes në likuidim e deri në përfundim të saj.

Përmbledhja e rezultateve financiare të fondeve në mirëbesim:

Hyrjet kryesore gjatë tërë procesit

Të hyrat nga shitjet e aseteve (ndërmarrjet e reja dhe shitja e aseteve në likuidim, shitja e banesave dhe shitjet tjera nga NSh në tranzicion)	664,936,872
Të hyrat nga komercializimi	5,021,319
Të hyrat nga qiraja e rregullt	14,877,023
Fondet tjera në mirëbesim të NSh-ve (para likuidimit) dhe tarifat për pjesëmarrjen e tenderëve	12,635,154
Të hyrat nga interesi në bankë (prej të cilave nga depozitimet kohore janë gjeneruar 7,2 milion)	34,844,700

Numri i transakcioneve hyrëse	182,600
Numri i transakcioneve dalëse	79,750
Gjithsej	**262,350**

Të dhënat janë edhe në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim.

SFIDAT KRYESORE NË PERIUDHËN E ARDHSHME

Arritja e synimeve dhe objektivave të AKP-së në të ardhmen mund të ngadalësohet marrë parasysh sfidat e mëposhtme që janë identifikuar:

- Kompletimi i Menaxhmentit;
- Menaxhimi i procesit të riorganizimit të Agjencisë;
- Rishqyrtimi i rregullativës së shitjes së aseteve në të ardhmen;
- Përshpejtimi i procesit të shitjes dhe trajtimit të aseteve në mënyra tjera;
- Trepça;
- Pagesa e mjeteve të shpronësimit[2] nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shpronësimet e vendosura në pronat shoqërore. Për asnjë NSH nuk mund të mbyllet procesi i likuidimit pa u paguar fondet e shpronësimit, prej të cilave poashtu pritet të paguhet 20%-i për punëtorët e NSH-ve;
- Vendosja e ndërmarrjeve të mbetura në likuidim;
- Të siguruarit që asnjë kontratë e shitjes në të ardhmen të mos përfundohet/dorëzohet pa u liruar aseti nga uzurpatorët;
- Bashkëpunimi me Komunat në ofrimin e shërbimeve kadastrale në mënyrë ekspeditive;
- Mungesa e stafit deficitar sic janë Zyrtarët Kadastral;
- Trajtimi i shitjeve kur dokumentet janë të paqarta apo mungojnë dokumentet e pronësisë;
- Vonesat në trajtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës;

[2] Që prej themelimit të AKP-së në vitin 2008, Qeveria ende nuk e ka paguar asnjë shpronësim për pronat shoqërore. Deri më 10 Shtator 2015 gjithsej janë marrë 555 vendime për shpronësime të pronave shoqërore. Gjatë vitit 2016 parashihet që Agjencia të dërgoj letrat formale me kërkesë për pagesë të këtyre shpronësimeve.

- Vonesat në trajtimin e lëndëve nga Gjykatat Themelore;
- Trajtimi i ndërtimeve joligjore; dhe
- Trajtimi i aseteve jashtë Kosovës.
- Vetëdijësimi i komunave rreth kompetencave të tyre në raport me pronën shoqërore, pasi që në shume raste Komunat kanë bërë ndërrime në mënyrë të njëanshme prej titullarit të pronave shoqërore – prona të cilat janë nën mandatin a AKP-së;
- Mungesa e bashkëpunimit me disa komuna në pjesën veriore të Kosovës. Kjo drejtpërdrejtë ndikon në procesin e privatizimit dhe likuidimit pasi që aty ekziston një numër i konsiderueshëm i pronave të NSh-ve.

Disa prej sfidave të mësipërme varen direkt prej institucioneve tjera.

SFIDAT KRYESORE NË PËRMBYLLJEN E LIKUIDIMIT TË NSH-VE

Procesi i privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) duhet të vazhdoj pa vonesa[3] të mëtejme.

Sfidat kryesore për përmbylljen e procesit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore janë:

1. Agjencia ende nuk i ka shitur **1,685** asete të NSH-ve[4]; dhe
2. Janë rreth **29,373 raste gjyqësore** në instancat e ndryshme gjyqësore:
   - 2.1. Rreth 15,000 ankesa[5] të kreditorëve të NSH-ve që ende janë në shqyrtim e sipër në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (DHPGJS);
   - 2.2. Rreth 6922 ankesa me 10,122 ankues në listat e punëtorëve të NSH-ve që ende janë në shqyrtim e sipër (për 185 NSH deri në fund të periudhës raportuese) në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (DHPGJS). Këto raste mbrohen nga Departamenti Ligjor i AKP-së;
   - 2.3. Janë 2,564 raste gjyqësore që procedohen nga zyret rajonale të Agjencisë në Gjykatat Themelore;
   - 2.4. Janë 180 raste të inicuara për përmbarime nga zyret rajonale të Agjencisë në Gjykatat Themelore;
   - 2.5. Rreth 4,705 raste gjyqësore që procedohen nga Departamenti Ligjor i Agjencisë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme;
   - 2.6. Janë 2 raste në Gjykatën Kushtetuese.
3. Agjencia i ka trajtuar një numër tejet të kufizuar të ndërtimeve joligjore në pronat e NSH-ve.

[3] Preambula e ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në ka paraparë themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe delegimin në këtë Agjenci të autorizimeve të gjëra publike administrative mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

[4] Sipas Raportit Përmbledhës të Aktiviteteve të AKP-së janë nënshkruar 1,286 kontrata të shitjes së Ndërmarrjeve të Reja dhe të shitjes së aseteve të NSH-ve në likuidim nga Qershor 2002 (themelimi i ish-AKM-së) e deri më 31 Dhjetor 2015.

[5] Në Autoritetet e Likuidimit (AL) të NSH-ve janë dërguar nga DHPGJS rreth 1,650 Urdhëra për Përgjigje në ankesat e kreditorëve për vendimet e lëshuara nga AL-të. Në bazë të disa parashikimeve të mostrave të ankesave dhe numrit të NSH-ve, mund të jenë edhe rreth 13,350 ankesa tjera për të cilat AKP ende nuk është njoftuar nga DHPGJS, në total pra rreth 15,000 ankesa të kreditorëve të NSH-ve. Sipas komunikatës për shtyp të DHPGJS në Dhjetor 2015, janë 23,327 lëndë gjyqësore të mbetura që kanë të bëjnë me proceset e Agjencisë,ku vetëm brenda vitit 2015 janë pranuar 4,117 lëndë të reja, ndërsa janë zgjidhur gjatë vitit 1,797 lëndë në të dy Shkallët në DHPGJS. Pra, sipas informatave nga DHPGJS numri i lëndëve gjyqësore në shqyrtim është 21,530.

Për këtë arsye është e rëndësisë kritike që:

I. Çështjet të cilat janë nën kontrollin e Agjencisë, siç janë likuidimi/shitja dhe trajtimi i aseteve, të kryhet me priotitet të lartë ashtu që raportet e Autoriteteve të Likuidimit t'i paraqiten Bordit të Drejtorëve me kohë;
II. Institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të përgatisin strategjinë përkatëse në përshpejtimin e shqyrtimit të lëndëve gjyqësore nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe të lëndëve në Gjykatat Themelore; dhe
III. Në koordinim me Qeverinë dhe organet komunale të përgatitet një strategji e veçantë për trajtimin e ndërtimeve joligjore jashtë proceseve administrative të Agjencisë.

Është e qartë se pa u likuiduar asetet dhe pa u shqyrtuar të gjitha ankesat kreditore në DHPSGJ përfshirë ankesat në kërkesat pronësore lidhur me asetet e NSH-ve në likuidim, nuk mund të likuidohen Ndërmarrjet Shoqërore.

Megjithatë, Autoriteti i Likuidimit / Agjencia mund të bëj shpërndarjen e përkohshme të pagesave ndaj kreditorëve me aprovim të Bordit të Drejtorëve (parakusht për këtë është që të dihet numri i ankesave dhe vlera e ankesave të paraqitura në DHPSGJ).

RREGULLORET DHE PROCEDURAT E APROVUARA GJATË VITIT 2015 NGA AGJENCIA

Rregulloret dhe procedurat e aprovuara gjatë periudhës raportuese janë:

1. Udhëzuesi për Teknologjinë Informative.

PASQYRA E GJENDJES SË PROCESEVE

Në këto tabela janë paraqitur të dhënat përmbledhëse të proceseve të Agjencisë.

Këtu janë paraqitur të dhënat përmbledhëse për:

- Kosto e procesit të privatizimit dhe likuidimit, Numri i aseteve shitura dhe të pashitura, Shitjet, Likuidimi, Lidhur me 20%-in e punëtorëve dhe të dhëna tjera përmbledhëse.

RAPORTI I GJENDJES SË PROCESEVE

	Të dhënat e fundit	31-Dec-15
Numri I aseteve të shitura	1,286	43%
Numri I aseteve të pashitura**	1,685	57%
Gjithsej*	**2,971**	**100%**

Asetet jashtë Kosovës (përfshirë 17 asetet e Trepçës)	179

Kosto e procesit të privatizimit dhe likuidimit	114,501,946

	numri	vlera
Toka të shitura*** (hektarë)	28,553	**€ 99,127,395**
Toka të pashitura**** (hektarë)	22,140	

* Ky numër mund të ndërroj në të ardhmen varësisht prej identifikimit të aseteve të reja apo heqjes dorë përmes Dhomës së Posaçme

** Këtu shënimet janë llogaritur asetet brenda Kosovës

*** Shuma e shitjes së tokave është e përfshirë në shumën totale të shitjes së aseteve. Pritet azhurnimi i shënimeve.

**** Në tokat e pashitura janë llogaritur të gjitha tokat me sipërfaqe më të madhe se 50 ari, pa marrë parasysh se a ka asete tjera në këto toka apo jo dhe cfarë kulturash të tokave.

SHITJET	**numri**	**vlera**
kontratat e nënshkruara	**1,286**	**€ 660,223,469**
shitjet me spin off të rregullt të Ndërmarrjeve të Reja	721	433,915,449
shitjet me negociata direkte	2	30,440,000
shitjet me spin off me kushte të veçanta	14	15,693,885
shitjet me Spin off special	26	92,938,595
Shitjet e aseteve në likuidim (neni 9)	523	87,235,540

shitja e banesave***	394	243,550
shitja e pronave lidhur me ndërtimet joligjore	-	-

**** Janë shqyrtuar 574 kërkesa, janë aprovuar 394, ndërsa janë refuzuar 180.

	numri	**vlera**
kontratat në pritje	**404**	**€ 2,588,806**
Shitjet e Ndërmarrjeve të Reja në pritje për nënshkrim	6	€ 2,380,451
Shitjet e aseteve në likuidim në pritje për nënshkrim	2	€ 208,355
Shitja e banesave në pritje për aprovim nga Bordi	396	-
shitja e pronave lidhur me ndërtimet joligjore për aprovim nga Bordi		-

LIKUIDIMI	**numri**

Numri i NSH-ve vendosur në likuidim	**462**
NSH-të e dërguara drejtpërdrejt në likuidim (pika 13a është përfshirë në pikën 13)	156
kërkesat kreditore të dorëzuara pranë Autoritetit të Likuidimit (AL)	89,630
Kërkesat kreditore të vendosura nga AL	89,268
kërkesat kreditore ende të pavendosura	*362*
numri I NSH-ve të mbyllura (NSH pa asete apo kërkesa kreditore)	7
Numri I raporteve përfundimtare dorëzuar nga AL te Dhoma e Posacme për mbyllje të NSH-së	6
numri I raporteve përfundimtare të shpërndarjes së pagesave për kreditorët	19
numri I draft raporteve për shpërndarje të pagesave të kreditorëve	263
Numri I NSH-ve që ende nuk është vendosur në likuidim	55

LIDHUR ME 20%-in E PUNËTORËVE

Gjithsej paguar BSPK-së	**€ 104,245,154**
Paguar BSPK-së nga të ardhurat e privatizimit	89,769,039
Paguar BSPK-së nga të ardhurat e likuidimit	10,584,933
Paguar BSPK-së nga të tjera	3,891,182

Fondet e gatshme për shpërndarje pas vendosjes së ankesave nga Gjykata	25,021,170

Numri i listave preliminare të punëtorëve të NSH-ve (për shqyrtim të ankesave në AKP)	0	
Numri i listave përfundimtare të punëtorëve të NSH-ve (për shqyrtim në Dhomën e Posaçme)	183	35%
Numri i listave të punëtorëve të NSH-ve miratuara nga Dhoma e Posaçme dhe të paguara	127	25%
Numri I NSH-ve për të cilat ende nuk janë përgatitur listat e punëtorëve	208	40%

TË DHËNA TJERA

Asetet e shpronësuara	555

Asetet e uzurpuara (deri 3 Mars 2016)	167
Asete tjera të shfrytëzuara pa kontratë (deri 3 Mars 2016)	103
Asetet me qira (NSH-të tjera)	781
Asetet me qira (Tregu dhe Pallatin e Rinisë)	826=661+165
Asetet në proces të komercializimit	0
NSH pa asete	55
Ndërmarrje të shitura me spin off special në monitorim	2
Ndërmarrje të shitura me kushte të veçanta në monitorim	9
NSH nën administrim direkt	3
NSH në proces të riorganizimit	0

Ekonomitë Pyjore (s'janë në kompetencën e AKP-së)	24
Kosovatransat (s'janë në kompetencën e AKP-së, në shqyrtim gjyqësor)	12
NSH që janë hequr me vendime të Bordit	30

NSH që kanë masë të përkohshme nga Dhoma e Posaçme	5
Shitjet që kanë ndalesa nga nga Dhoma e Posaçme	10
Raste tjera me masë të përkohshme nga Gjykatat	93
Kërkesa për masë të përkohshme nën shqyrtim nga Dhoma e Posaçme	195
Numri i rasteve gjyqësore në Dhomën e Posacme (21,992) dhe Gjykatat Themelore (7,451)	29,373

Ndërtime joligjore të shqyrtuara por që duhet vendosur në Bord	128
Ndërtime joligjore ende të pa shqyrtuara	1954

PASQYRA E GJENDJES SË FONDEVE NË MIRËBESIM

Këtu janë paraqitur të dhënat përmbledhëse për gjendjen e fondeve në mirëbesim[6]: Gjendja e fondeve në mirëbesim më 31 Dhjetor 2014, Hyrjet gjatë vitit 2015, Daljet gjatë vitit 2015; dhe Gjendja e fondeve në mirëbesim më 31 Dhjetor 2015.

[6] Të dhënat detaje paraqiten në pasqyrat financiare të vitit 2015.

PËRSHKRIMI	SHËNIMI SHPJEGUES NR.	1 GJENDJA MË 31 DHJETOR 2014	2 TRANSAKSIONET BANKARE GJATË VITIT FISKAL	3=1+2 GJENDJA MË 31 DHJETOR 2015
Të hyrat nga shitjet	1	665,248,630	(311,758)	664,936,872
Të hyrat nga qiraja	2	10,080,071	4,796,952	14,877,023
Qiraja nga komercializimi	3	5,021,319	-	5,021,319
Interesi i fituar	4	34,839,700	5,000	34,844,700
Tarifa për pjesëmarrjen në tenderat e shitjes	5	7,705,480	(193,016)	7,512,464
Të hyra të tjera	6	4,796,689	326,001	5,122,690
Kapitali themeltar i Agjencisë	7	1,013,200	-	1,013,200
GJITHSEJ TË HYRAT E REALIZUARA NË LLOGARITË BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM		**728,705,088**	**4,623,179**	**733,328,267**
SHPENZIMET/SHPËRNDARJA				
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	11	96,216,840	8,028,314	104,245,154
Ofruesi I Shërbimeve Profesionale (Autoriteti I Likuidimit)	12	9,006,327	1,704,575	10,710,902
Mallra dhe shërbime	13	7,631,304	2,165,570	9,796,874
Shërbime publike	14	449,281	378,409	827,690
Tatimet	15	1,611,132	746,892	2,358,024

Vendimet e gjykatave/përmbaruesve (depozita dhe taksa)	16	978,292	761,709	1,740,001
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	17	20,348,000	5,500,000	25,848,000
Të tjera	18	683,722	8,626	692,348
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së	19	45,140	-	45,140
Fondet tepricë transferuar Qeverisë	20	28,934,282	61,310,628	90,244,911
GJITHSEJ SHPENZIMET/SHPËRNDARJA		**165,904,319**	**80,604,723**	**246,509,042**
GJENDJA BANKARE		**562,800,768**	**(75,981,544)**	**486,819,224**

31-Dec-15

2. KORNIZA LIGJORE

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 1 Korrik 2008 i ndryshuar me ligjin nr.04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011 (këtej e tutje "Ligji") i ndryshuar me ligjin nr. 05/L-080 që ka hyrë në fuqi më 24 Dhjetor 2015.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar si pasardhës e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) të themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12 "Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit" me ndryshime nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/18 dhe parasheh që të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit për Ndërmarrjet Shoqërore transferohen tek Agjencia Kosovare e Privatizimit.

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM NË KUADËR TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

1. Ligji i AKP-së;
2. Akti themelues i AKP-së;
3. Statuti i Bordit të Drejtorëve të AKP-së;
4. Politikat Operacionale të AKP-së dhe Anekset e saj:
    - 4.1. Rregullat e tenderit në privatizim
    - 4.2. Rregullat e tenderit në likuidim
    - 4.3. Rregullat e Procedurës të Komisionit për shqyrtim të ankesave ndaj listave të punëtorëve.
5. Procedurat Financiare të AKP-së;
6. Udhëzuesi i Likuidimit me Anekset e tij:
    - 6.1. Lista me Format/Formularët për Likuidim;
    - 6.2. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave të Caktuara të Punës (marrëdhënia e punës)
    - 6.3. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore (të NSH-së) gjate periudhës së transformimit.
    - 6.4. Aneks i Udhëzuesit të Likuidimit për Procedimin e Kërkesave Kolektive ne procedurën e likuidimit.
7. Rregullore për kompensimin e anëtarëve të Bordit
8. Udhëzuesi për Procedurën e shpërndarjes së hyrave nga 20%;
9. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore;
10. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim;
11. Procedurat e brendshme të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;
12. Procedurat Bankare të AKP-së;
13. Rregullorja Nr. 01/2012 mbi Ruajtjen e Integritetit te AKP-së;
14. Rregullorja për përdorimin të vulave zyrtare të Agjencisë dhe Autorizimit për lejimin e përdorimit të vulave zyrtare të Agjencisë nga Autoriteti i Likuidimit;
15. Statuti Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB);

16. Rregullore për përcaktimin e mënyrave të kompensimit për menaxherët si dhe punëtorët tjerë të NSH-ve nën mandatin e Njësisë së Administrimit Direkt;

17. Rregullore për procedurën e rekrutimit të Drejtorit Menaxhues, dy Zëvendës Drejtorëve Menaxhues dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;

18. Rregullore për Zhvillimin e punonjësve dhe ngritje te kapaciteteve;

19. Rregullore për procedurat dhe masat e nevojshme për sigurinë e personave që hyjnë dhe dalin në AKP;

20. Rregullore e brendshme të Agjencisë për Vlerësim të Performancës së Menaxhmentit;

21. Politikat mbi pagesën e pjesshme për punëtorët;

22. Udhëzuesi i prokurimit për ndërmarrjen Trepça nën Administrimin e AKP-së;

23. Rregullore e Shitjes e Ndërmarrjes Trepça në Administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

24. Procedurat bankare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;

25. Rregullorja e Pagave për nëpunësit e Agjencisë

26. Rregullorja e Personelit për nëpunësit e Agjencisë;

27. Rregullorja e Përdorimin e Veturave zyrtare të Agjencisë;

28. Rregullat e Procedurës për Shitjen e Banesave të NSH-ve;

29. Rregullat e Punës të Komisionit për ndërtimeve jo ligjore në pronat e ndërmarrjeve shoqërore;

30. Rregullorja për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;

31. Rregullorja për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim;

32. Rregullat e Procedurës së Komisionit për shqyrtimin e listave fillestare të punëtorëve (KShLFP);

33. Vendimi për lirimin e aseteve të uzurpuara të NSH-ve dhe Udhëzuesi për lirimin e aseteve nga uzurpatorët;

34. Rregullore për Procedurat e Njësisë së Kontrollit dhe mbimqyrjes gjatë Monitorimit të Ndërmarrjeve të Privatizuara me Spin Off Special dhe me Kushte;

35. Rregullore mbi Procedurat e trajtimit të llogarive të arkëtueshme;

36. Udhëzuesi për Menaxhimin e Performancës së Personelit;

37. Udhëzuesi për Teknologjinë Informative.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. MISIONI DHE VIZIONI

Misioni

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Për realizimin e këtij misioni, Agjencia mban dhe administron secilën ndërmarrje (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, si dhe shet ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin.

Vizioni

Agjencia është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet substanciale negative ekonomike dhe sociale si dhe nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjëra publike administrative që i ka Agjencia Kosovare e Privatizimit mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

3.2. KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej "Agjencia") është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues[7], Zëvendës Drejtori Menaxhues-Shitje dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues-likuidimi.

Agjencia ka departamentet në vijim:

- Departamenti i Shitjes;
- Departmanenti për Koordinim të Likuidimit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Administratës; dhe
- Departamentin e Prokurimit.

Agjencia e ka të themeluar edhe Njësinë e Auditimit të Brendshëm dhe Sekretarinë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve. Agjencia ka zyrën qendrore në Prishtinë. Ka pesë (5) zyra rajonale (Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan) dhe tre (3) zyra satelitore (Graçanicë, Shtërpce dhe Leposaviq).

Struktura organizative e Agjencisë është paraqitur në fund të raportit vjetor të Agjencisë.

[7] Mandati i Drejtorit Menaxhues ka përfunduar më 26 Janar 2014.

4.FUSHËVEPRIMI QË E MBULON AGJENCIA

Rreth 604 subjekte juridike në Kosovë kanë qenë të identifikuara nga ish-AKM si Ndërmarrje Shoqërore (NSH) apo njësi punuese të NSH-ve.

NSH-të kanë funksionuar në sektorë të ndryshëm duke përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotele, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë.

NSH-të zënë rreth 90% të industrisë dhe minierave në Kosovës, 50% të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe shumicën e pjesës malore të Kosovës.

Shumica e pronës industriale e Kosovës, toka bujqësore, pyje, tokë urbane komerciale dhe pronë komerciale janë pronë e NSH-së. Privatizimi i këtyre aseteve dhe tërheqja e investitorëve të huaj si dhe atyre nga diaspora, rajoni dhe Kosova pritet që të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Nga 604 ndërmarrje, janë 85 ndërmarrje të cilat nuk konsiderohen për vendosje në likuidim apo janë jashtë mandatit të Agjencisë varësisht sipas rastit përkatës (Trepça është nën administrim të AKP-së):

1.	Trepça	19
2.	Ekonomitë Pyjore	24
3.	Kosovatransat	12
4.	NSH që janë hequr me vendime të Bordit	30

Pra, numri i NSh-ve nën mandatin e Agjencisë është gjithsej 518 prej të cilave në procesin e likuidimit kanë hyrë gjithsej 462. Janë edhe 55 NSh që ende nuk janë vendosur në likuidim dhe presin deri në emërimin e Bordit të ri.

AKP-ja vazhdon me privatizimin e NSh-ve nëpërmjet dy metodave:

1. **“Spin-Off” -** Asetet dhe numri i kufizuar i përgjegjësive të NSH-së barten tek shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (“Ndërmarrja e Re sh.p.k.”) me aksionet e ndërmarrjeve të reja të tenderuara për shitje investitorëve privat. Detyrimet e mbetura ndaj kreditorëve dhe punëtorëve mbesin me Ndërmarrjen Shoqërore; dhe
2. **Likuidimi Vullnetar -** Asetet e NSH-ve do të likuidohen/shiten sipas ligjit dhe politikave operacionale të Agjencisë.

BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve të AKP-së takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas ligjit. Që nga Dhjetori 2015 Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në vitin 2008 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje.

Në vitin 2009 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) mbledhje.

Në vitin 2010 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur dymbëdhjetë (12) mbledhje.

Në vitin 2011 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) mbledhje.

Në vitin 2012 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur tetë (8) mbledhje.

Në vitin 2013 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) mbledhje.

Në vitin 2014 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur nëntë (9) mbledhje.

Në vitin 2015 Bordi i Drejtorëve ka mbajtur një (1) mbledhje.

Zhvillimet pas datës 31 Gusht 2014 lidhur me Bordin e Drejtorëve

Që nga 1 Shtatori 2014 Bordi i Drejtorëve nuk ka pasur kuorum për të mbajtur mbledhje të rregullta vendimmarrëse. Anëtarët ndërkombëtar të Bordit z. Hubert VVarsmann dhe z. Mohammed Omran kanë pasur mandat deri me 31 Gusht 2014 sipas Aktit të Emërimit nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar. Anëtarët vendor të Bordit të Drejtorëve, z. Skender Komoni Zëvendës Kryesues, anëtarët znj. Maja Milanovic dhe z. Haxhi Arifi kanë pasur mandat deri me 20 Shkurt 2015 dhe që nga ajo datë Agjencia nuk ka asnjë anëtar Bordi.

Në muajin Mars 2015 AKP-ja ka dorëzuar në Kuvendin e Kosovës Raportin Vjetor të përgatitur nga Menaxhmenti i AKP-së për vitin 2014 i cili do t'i nenshtrohet aprovimit te Bordi i Drejtorëve.

Takimet javore në mes 3 anëtarëve të Bordit, Menaxhmentit dhe Sekretaritit të Bordit (periudha 1 shtator 2014 deri 20 shkurt 2015):

Sipas vendimit të Bordit të datës 26/31 Gusht 2014 tre anëtarët e Bordit të mbetur do të jenë përgjegjës për çështjet si në vijim:

1. Prej datës 1 shtator 2014 e deri në përbërjen e re të Bordit kur do të ketë kuorum, dhe jo më pas datës 20 shkurt 2015, në bazë të nenit 11.2 të Ligjit për AKP-në, Bordi ia delegon të gjitha kompetencat e veta Drejtorit Menaxhues të Agjencisë dhe/ose dy Zëvendës Drejtorëve Menaxhues duke vepruar së bashku, përveç kompetencave të rezervuara sipas nenit 15 të po të njëjtit ligj.
2. Në rast se gjatë kësaj periudhe Menaxhmenti ka dyshim nëse një vendim i caktuar bie nën nenin 15 të ligjit apo jo, kjo do të vendoset nga anëtarët e mbetur të Bordit unanimisht, pas konsultimit të tyre me Drejtorin e Departamentit Ligjor dhe Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive.
3. Gjatë kësaj periudhe, anëtarët e mbetur të Bordit bashkërisht dhe veç e veç autorizohen të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme, monitorim dhe këshillim të Menaxhmentit në ushtrimin e

veprimtarisë së zakonshme të Agjencisë në frymën e misionit dhe mandatit të saj. Ky autorizim shtrihet por nuk kufizohet si në vazhdim:

a. Kryesuesi i Bordit (në mungesë të tij Zv. Kryesuesi) autorizohet të kryejë të gjitha aspektet administrative të punës që kanë të bëjnë me aprovimet e pushimeve, udhëtimeve zyrtare, shpenzimet apo të ngjashme për Menaxhmentin dhe Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive.

b. Anëtarët e Bordit, Menaxhmenti dhe Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive të takohen së paku një herë në javë për të koordinuar të gjitha aktivitetet për zbatimin e mandatit të Agjencisë brenda mundësive ligjore. Përmbledhjet e këtyre takimeve do të bëhen në formë raporti që do t'i vihen në dispozicion Bordit kur të ketë kuorum.

c. Menaxhmenti të raportojë me shkrim një herë në muaj lidhur me punën e tij. Këto raporte mujore të Menaxhmentit do t'i vihen në dispozicion Bordit kur të ketë kuorum.

d. Vendimet lidhur me kërkesat buxhetore të vitit 2015 në Ministrinë e Financave të merren në konsultim me anëtarët e Bordit.

Tre anëtarët vendor të Bordit që nga 1 Shtatori 2014 e deri më 20 Shkurt 2015 kanë mbajtur 22 mbledhje të rregullta javore me Menaxhmentin (u.d. Zëvendës Drejtorin Menaxhues –likuidimi) dhe Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve (9 mbledhje gjatë vitit 2015). Për këto mbledhje janë mbajtur agjenda dhe procesverbale të cilat do t'i dorëzohen anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

Gjatë kësaj periudhe përveç tjerave Agjencia e ka informuar Kuvendin, Kryetarin e Kuvendit, Komisionin për Zhvillim Ekonomik dhe Kryesinë e Kuvendit për gjendjen rreth mandateve të anëtarëve të Bordit dhe lutjen për të emëruar sa më shpejtë anëtarët e rinj të Bordit.

Ndër sfidat kryesore që 3 anëtarët vendor të Bordit në bashkëpunim me Menaxhmentin është dashur të kalojnë gjatë kësaj periudhe janë:

- Implementimi i vendimit të Bordit për tërheqjen e aksioneve të ndërmarrjes MIM Golesh, vendosja e ndërmarrjës nën Administrim Direkt, çështjet lidhur me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) , çështja e padisë nga ish blerësi në Dhomë të Posaçme;
- Diskutime të shumta me përfaqësuesit e punëtorëve të ndërmarrjes Fabrika e Gypave Ferizaj lidhur me udhëzimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për pretendimet e punëtorëve të ish Fabrikës për prodhimin e gypave ne Ferizaj sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese AGJ. 75/10 rasti KI 08/09 të datës 17 dhjetor 2010;
- Diskutime lidhur me procedurat e qiradhënies në përgjithësi dhe në vecanti të aseteve të: a) pompave të benzinës INA dhe Jugopetroll; b) NSH Urata në likuidim; c) parkingu i Përparimi në Podujevë; d) Tregu Bylmeti në Pejë; e) NSH KB Strellci në Pejë; f) kompania OLTI në Rahovec; g) kërkesë nga një palë për qiradhënie të 25HA në Leposaviq; h) NSH Tregu në Prishtinë; i) kërkesën e EU për përdorim të asetit të Barnator Prishtinë; j) Draft kontrata nga Komuna e Gjakovës për qiramarrje të Virgjinia, Metaliku dhe Jatex;
- Diskutime për auditimin e Ndër e re IDGJ Tobacco në Gjilan;
- Diskutim lidhur me gjendjen e ndërmarrjes së rë Kualiteti në Gjilan që ndërlidhet me rastin e Fabrikës FAN në Podujevë;
- Diskutim per vendimin e Bordit të datës 27 qershor 2014 lidhur me kërkesën e "Trepça-Ndërmarrje nën Administrim të AKP-së" për lejimin e mjeteve financiare për riaktivizimin e prodhimit në fabrikën e Zink Oksidit;

- Diskutim për trajtimin e aseteve të uzurpuara; hartimi i një rregulloreje për këtë cështje nga Menaxhmenti; takime përkatëse më Policinë e Kosovës për këtë cështje;
- Diskutim për kërkesat e komunave të ndryshme në Kosovës për shpronësim të tokave të NSH-ve;
- Diskutim për cështjen e nënshkrimit të kontratave për shitblerjen e banesave të NSH-ve;
- Diskutim për materialin per Aprovimin e Raporteve mujore dhe kuartale të kontraktorit nga Komisioni i Bordit për Autoritetin e Likuidimit;
- Auditimi nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm;
- Mungesa e Rregullores për përcaktimin e dokumenteve konfidenciale të Agjencisë;
- Formimi i Grupit Punues per pergatitjen e Udhezuesit me procedurat dhe percaktimin e vendimeve perkatese lidhur me ofertuesit me ndalese ofertimi;
- Kërkesa të Policisë për dokumentacion për raste të ndryshme që ndodhen nën hetime;
- Rekomandimet e NJAB-it për Departamentin e Koordinimit të Likuidimit dhe Autoritetit të Likuidimit;
- Konsultime lidhur me SHAL 27 dhe SHAL 28 dhe diskutim per Komisionin per pranim te ofertave, Komisionin per hapjen e Ofertave dhe Komisionin per regjistrim te ofertuesve te kualifikuar;
- Diskutime të ndryshme për rastet e privatizuara me Spin Off Special;
- Diskutime për Raportin e Aktiviteteve të Agjencisë për vitin 2014;
- Diskutime për Planin Vjetor të Agjencisë për vitin 2015;
- Kërkesa për t'u dërguar në Dhomë të Posaçme për shtyerje afati për Trepcën pasi që sipas afateve ajo duhej të hynte në likuidim me 2 Shkurt 2015;
- Diskutim për përgaditjen e të dhënave të Agjencise për kapitullin Reformat Strukturore në kuadër të Programit Ekonomik Fiskal 2015 në kuader te Programit të Qeverisë për vitin 2015-2018;
- Ankesa e një operatori ekonomik ndaj tenderit për furnizim me derivate në Trepcë;
- Njoftim për asetin Lux në Mitrovicë – mospërputhjet mes shënimeve kadastrale dhe gjendjes në terren sepse objekti nuk mund të gjendej;
- Diskutim për situatën e krijuar në Hotel Grand në Prishtinë me rastin e fillimit tëv likuidimit më 2 Shkurt 2015;
- Diskutim për raportet mujore të Menaxhmentit për periudhën 13 Gusht-30 Shtator 2014 dhe raportin për periudhën 01 Tetor-26 Nëntor 2014 të cilat iu janë dorëzuar 3 anëtarve vendor të Bordit;
- Diskutim lidhur me aktivitetet e Agjencisë pas 20 Shkurt 2015 dhe autorizimet e Menaxhmentit marrë parasysh vendimin e Bordit për delegim të kompetencave te Menaxhmenti deri më 20 Shkurt 2015;
- Diskutim lidhur me Rregullat e Qiradhënies së Aseteve në Likuidim të përgatitura sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve nga Autoriteti i Likuidimit në bashkëpunim me Menaxhmentit.

Zhvillimet tjera lidhur me Bordin e Agjencisë në vitin 2015:

- Kuvendi i Kosovës me 14 dhjetor 2015 ka miratuar Ligjin Nr. 05/L -080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-034 për AKP-së, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115.
- Ligji Nr. 05/L -080 është shpallur me dekretin Nr. DL-036-2015, datë 24.12.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

- Anëtarët e rinj të Bordit të Drejtorëve janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 17 Dhjetor 2015. Përbërja është si në vijim: Kryesues Petrit Gashi dhe anëtarët tjerë: Hasime Mazreku, Hamdi Jaha, Skender Komoni, Ismajl Januzi, Haxhi Arifi, Ranko Djokiq dhe Bajram Zejnullahu.

Mbledhjet e Bordit gjatë vitit 2015

Takimi i shtatëdhjetë (70) i Bordit të Drejtorëve të AKP-së (Bordi) është mbajtur me 30 Dhjetor 2015. Gjatë këtij takimi Bordi ka vendosur për amadamentimin e Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Bordi poashtu në mënyrë unanime miratoi vendimin për bartjen e shumës prej 61.3 milionë euro nga fondet e mirëbesimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim në buxhetin e Republikës së Kosovës, ashtu siç parashihet me Ligjin e AKP-së, për nevoja të shfrytëzimit nga ana e Qeverisë së Kosovës. Këto mjete janë ndarë nga fondet e përcaktuara si tepricë prej procesit të likuidimit të 125 ndërmarrjeve shoqërore. Gjithashtu, Bordi diskutoi lidhur me zhvillimet e fundit në ndërmarrjen shoqërore "Trepça" nën administrimin e AKP-së, dhe në këtë kuadër shqyrtoi, dhe me pajtimin e të gjithë anëtarëve prezent të bordit miratoi kërkesën e ndërmarrjes Trepça për shitjen e koncentratit të plumbit dhe zinkut.

ORGANIZIMI, VEPRIMTARIA, BURIMET NJERËZORE DHE PAGAT E AGJENCISË, ASETET

Lidhur me këtë nënkapitull, raportimi është bërë siç vijon:

a) organizimi – struktura organizative e Agjencisë është në shtojcën e raportit vjetor;
b) veprimtaria e Agjencisë dhe njësive organizative përkatëse – paraqitet në kapitullin "Aktivitetet për periudhën raportuese"
c) Numri i punëtorëve dhe pagat e Agjencisë – paraqiten në shtojcë në formatin e kërkuar nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa.
d) Asetet – raporti i aseteve paraqitet në shtojcë (pasqyrat financiare të buxhetit vjetor) në formatin e kërkuar nga Ministria e Financave.

Selia qendrore e Agjencisë është në rrugën "Agim Ramadani" nr. 23 (ish-"Ilir Konushevci" nr. 8) në Prishtinë. Agjencia ka mungesë të jashtëzakonshme të hapësirës përkatëse për punë për shkak të objektit të stërvjetruar.

Agjencia ka pranuar kërkesë nga Komuna e Prishtinës për lirimin e objektit për arsye të planeve zhvillimore të cilat janë planifikuar nga Komuna. Për këtë është njoftuar Ministria e Administratës Publike me të cilën Agjencia është në diskutime e sipër për zhvendosjen e zyreve të Agjencisë në ndonjë tjetër objet përkatës.

SHPALOSJE LIDHUR ME BORDIN E DREJTORËVE DHE MENAXHMENTIN

Periudha raportuese ka qenë me mjaft angazhime për Agjencinë, përkundër sfidave të vazhdueshme me të cilat Agjencia është ballafaquar. Përveç kompetencave të rezervuara të detyrave të Bordit të Drejtorëve sipas nenit 15 të ligjit të AKP-së e të cilat nuk mund të delegohen te Menaxhmenti, të gjitha detyrat tjera gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar me efikasitet të plotë.

Disa prej sfidave kryesore që e kanë përcjellë AKP-në edhe gjatë kësaj periudhe janë:

- Mungesa e tre anëtarëve në Bordin e Drejtorëve (që nga muaji maj 2013), ku deri më 31 gusht 2014 Bordi ka funksionuar vetëm me 5 anëtarë të Bordit (3 vendorë dhe 2 ndërkombëtar), ndërsa pas kësaj date 2 anëtarëve ndërkombëtar iu ka skaduar mandati dhe që nga 1 shtatori 2014 me mandat ishin vetëm 3 anëtarë të Bordit që nuk përbënin kuorum të plotë për vendimmarrjen sipas nenit 15 të ligjit të AKP-së për kompetencat të cilat janë rezervuar vetëm për Bordin e Drejtorëve. Për arsye të mungesës së plotë të Bordit, Agjencia nuk ka mundur të shpërndaj fondet për kreditorët në procedurën e likuidimit dhe as të organizoj shitjen e aseteve;
- Mungesa e Drejtorit Menaxhues nga 26 janari 2014, përkundër procesit të hapur të rekrutimit, Drejtori Menaxhues nuk është zgjedhur dhe si rrjedhojë konkursi publik ishte anuluar në maj 2014;
- Suspendimi nga Bordi i Drejtorëve i Zëvendësdrejtorit Menaxhues për likuidim më 7 maj 2014;
- Dorëheqja e Zëvendësdrejtorit Menaxhues për shitjet më 17 shtator 2014.

Në cilësinë e Menaxhmentit aktualisht është vetëm ushtruesi i detyrës së Zëvendës Drejtorit Menaxhues – likuidimi i cili e ushtron funksionin e Menaxhmentit në kuadër të nenit 3 (paragrafi 1.15) të ligjit të AKP-së dhe sipas opinionit ligjor të Ministrisë së Administratës Publike të lëshuar më 15 tetor 2014 se në mungesë të Drejtorit Menaxhues të AKP-së, ligjërisht kjo pozitë duhet të zëvendësohet nga Zëvendës Drejtori Menaxhues i AKP-së.

RËNDËSIA, NDËRLIDHJA DHE SFIDAT KRYESORE PËR REALIZIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR VITIN 2016

Çështjet e ngritura në objektivat e vitit 2016 janë përcaktuar që të jenë në përputhje me interesin e përgjithshëm të Kosovës për të përfunduar procesin e privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) pa vonesa[8] të mëtejme.

Kontrata[9] katërvjeçare me Ofruesin e Shërbimeve Profesionale[10] – OSHP për procesin e likuidimit është nënshkruar më 10 Korrik 2012 dhe përfundon më 10 Korrik 2016 me qëllim të kryerjes së detyrave të Autoritetit të Likuidimit[11].

Pengesat kryesore për përmbylljen e procesit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore janë:

1. Agjencia ende nuk i ka shitur 1,685 asete të NSH-ve[12]; dhe

[8] Preambula e ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në ka paraparë themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe delegimin në këtë Agjenci të autorizimeve të gjëra publike administrative mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.
[9] Kontrata është e nënshkruar me konsorciumin "Deloitte Central Europe dhe Tashko&Pustina".
[10] OSHP: shih neni 2.1 paragrafi 1.13 i shtojcës së ligjit të AKP-së.
[11] Shih pjesën III të shtojcës së ligjit të AKP-së për detyrat e Autoritetit të Likuidimit.

2. Janë rreth **29,373 raste gjyqësore** në instancat e ndryshme gjyqësore:
   a. Rreth 15,000 ankesa[13] të kreditorëve të NSH-ve që ende janë në shqyrtim e sipër në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (DHPGJS);
   b. Rreth 6922 ankesa me 10,122 ankues në listat e punëtorëve të NSH-ve që ende janë në shqyrtim e sipër (për 185 NSH deri në fund të periudhës raportuese) në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (DHPGJS). Këto raste mbrohen nga Departamenti i Ligjor i AKP-së;
   c. Janë 2,564 raste gjyqësore që procedohen nga zyret rajonale të Agjencisë në Gjykatat Themelore;
   d. Janë 180 raste të inicuara për përmbarime në nga zyret rajonale të Agjencisë në Gjykatat Themelore;
   e. Rreth 4,705 raste gjyqësore që procedohen nga Departamenti Ligjor i Agjencisë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme;
   f. Janë 2 raste në Gjykatën Kushtetuese.
3. Agjencia i ka trajtuar një numër tejet të kufizuar të ndërtimeve joligjore në pronat e NSH-ve.

Për këtë arsye është e rëndësisë kritike që:

I. Çështjet të cilat janë nën kontrollin e Agjencisë, siç janë likuidimi/shitja dhe trajtimi i aseteve, të kryhet me priotitet të lartë ashtu që raportet e Autoriteteve të Likuidimit t'i paraqiten Bordit të Drejtorëve me kohë;
II. Institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të përgatisin strategjinë përkatëse në përshpejtimin e shqyrtimit të lëndëve gjyqësore nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe të lëndëve në Gjykatat Themelore; dhe
III. Në koordinim me Qeverinë dhe organet komunale të përgatitet një strategji e vecantë për trajtimin e ndërtimeve joligjore jashtë proceseve administrative të Agjencisë.

Është e qartë se pa u likuiduar asetet dhe pa u shqyrtuar të gjitha ankesat kreditore në DHPSGJ përfshirë ankesat në kërkesat pronësore lidhur me asetet e NSH-ve në likuidim, nuk mund të likuidohen Ndërmarrjet Shoqërore.

Megjithatë, Autoriteti i Likuidimit / Agjencia mund të bëj shpërndarjen e përkohshme të pagesave ndaj kreditorëve me aprovim të Bordit të Drejtorëve (parakusht për këtë është që të dihet numri i ankesave dhe vlera e ankesave të paraqitura në DHPSGJ).

[12] Sipas Raportit Përmbledhës të Aktiviteteve të AKP-së janë nënshkruar 1,286 kontrata të shitjes së Ndërmarrjeve të Reja dhe të shitjes së aseteve të NSH-ve në likuidim nga Qershor 2002 (themelimi i ish-AKM-së) e deri më 30 Nëntor 2015.

[13] Në Autoritetet e Likuidimit (AL) të NSH-ve janë dërguar nga DHPGJS rreth 1,650 Urdhëra për Përgjigje në ankesat e kreditorëve për vendimet e lëshuara nga AL-të. Në bazë të disa parashikimeve të mostrave të ankesave dhe numrit të NSH-ve, mund të jenë edhe rreth 13,350 ankesa tjera për të cilat AKP ende nuk është njoftuar nga DHPGJS, në total pra rreth 15,000 ankesa të kreditorëve të NSH-ve. Sipas komunikatës për shtyp të DHPGJS në Dhjetor 2015, janë 23,327 lëndë gjyqësore të mbetura që kanë të bëjnë me proceset e Agjencisë,ku vetëm brenda vitit 2015 janë pranuar 4,117 lëndë të reja, ndërsa janë zgjidhur gjatë vitit 1,797 lëndë në të dy Shkallët në DHPGJS. Pra, sipas informatave nga DHPGJS numri i lëndëve gjyqësore në shqyrtim është 21,530.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

5.1. DEPARTAMENTI I SHITJES

Privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) është paraparë të ketë ndikim pozitiv në komunat e Kosovës nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë duke mundësuar rritjen dhe zhvillimin e sektorit privat. E rëndësishme është që ky proces të kryhet sa më shpejtë në mënyrë të drejtë dhe transparente dhe në përputhje me ligjin.

Departamenti i Shitjes përbëhet nga:

1. Njësia për Përgatitjen dhe Përmbylljen e Shitjes;
2. Njësia e Shqyrtimit të Dokumenteve të Shitjes; dhe
3. Njësia e Kadastrit.

Departamenti i Shitjes është përgjegjës për procesin e privatizimit dhe atë sipas menyrave të cekura më poshtë:

"Spin-Of" - Asetet dhe një numër i kufizuar i detyrimeve të NSH-së barten tek shoqëritë e porsaformuara aksionare (Ndërmarrja e Re) me aksionet e Ndërmarrjes së Re dhe më pas tenderohen për shitje investitorëve privat. Detyrimet ndaj kreditorëve potencial mbesin obligime të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe këto çështje zgjidhen përmes procesit të likuidimit. Pasiqë shumica e Ndërmarrjeve Shoqërore tashmë kanë hyrë në procesin e likuidimit, nuk pritet që të ketë shitje me Spin Of të rregullt.

"Likuidimi Vullnetar" do të mundësoj:

a) shitjen e aseteve që nuk janë shitur nëpërmjet privatizimit; dhe
b) shqyrtimin e ankesave të kreditorëve dhe shpërndarjen e fondeve të realizuara në përputhje me prioritetet e parapara me ligj.

Sa i përket pjesës raportuese për këtë periudhë, nuk është mbajtur asnjë valë e privatizimt apo shitjeve të aseteve përmes Likuidimit. Kjo ka ndodh si rrjedhim i moskompletimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, pasi që asnjë shitje nuk mund të mbahet pa miratim paraprak të Bordit, gjithnjë sipas politikave operacionale dhe ligjeve në fuqi.

Sidoqoftë, gjatë periudhës raportuese është bërë shqyrtimi kadastral, ligjor si dhe përgatitja e dokumenteve të shitjes për Shitjen e Aseteve 27 dhe Shitjen e Aseteve 28.

SHITJET QË KANË NDALESA NGA DHOMA E VEÇANTË E GJYKATËS SUPREME

Për dhjetë (10) shitje të organizuara kemi ndalesa nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe derisa nuk hiqen këto ndalesa nuk mund të vazhdohet me shitjen. Ndalesat vlejnë për ndërmarrjet/asetet në vijim:

1. Ndërmarrja e Re "AGROKOSOVA – Zyret Sh.P.K." – Vala 37;
2. Ndërmarrja e Re "Punëtoria Iliria Sh.P.K." – Vala 43.

3. Ndërmarrja e Re “Jugobanka Zyra në Skenderaj” – Vala 58;
4. Ndërmarrja e Re “ Ereniku Industria Depo në Zonën Industriale Prishtinë” – Vala 59.
5. Aseti në likuidim “Farmakos Blue Factory” Prizren.
6. Njësia nr. 11: Jugobanka Zyra në Zubin Potok – SHAL 23
7. Njësia nr. 12: Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme i - SHAL 20
8. Njësia nr. 12: Jugobanka Zyra në Zveçan – SHAL 23
9. Njësia nr. 13: Jugobanka Ndërtesa Administrative në Mitrovicë – SHAL 23
10. Njësia nr. 14: Jugobanka Banesa në Mitrovicë – SHAL 23

Nga 740 raste të dorëzuara në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për masa të përkohshme ndaj veprimeve të AKP-së, përgjatë periudhës së procesit të privatizimit dhe likuidimit nga qershor 2002 e deri më tani janë këto të dhëna:

- 93 masa të përkohshme janë ende në fuqi;
- 195 kërkesa për masë të përkohshme janë ende në shqyrtim e sipër nga Gjykata; dhe
- 452 kërkesa janë refuzuar nga Gjykata.

SHITJET E PAPËRFUNDUARA:

1. Njësia nr. 25: Tokë dhe Objekt në Qendër Mitrovicë (parcela 1451-1) – SHAL 24
2. Njësia nr. 12: Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme I, Fushë Kosovë SHAL 20
3. Ereniku Industria Depo në Zonën Industriale Prishtinë SH.p.k., Vala 59
4. Jugobanka Zyra në Skenderaj Sh.p.k., Vala 58
5. Punetoria "Iliria" Sh.p.k, Pejë, Vala 43
6. Kooperimi Toka Bujqësore Treboviq Sh.p.k., Pejë, Vala 42
7. Ndërmarrja e Re “KB Shtime Ndërtesa Administrative Sh.P.K. Shtime– Vala 42;
8. AGROKOSOVA OFFICES Sh.p.k., Prishtinë, Vala 37
9. Farmakos Blue Factory L.L.C. Prizren, Vala 2

5.2. NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITOR

Në përputhje me Planin Vjetor të Punës së AKP-së, Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor për periudhën janar-dhjetor 2015 ka planifikuar realizimin e aktiviteteve të parapara me qëllim të përmbushjes së objektivave të përgjithshme të AKP-së.

Plani i punës së Njësisë së Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor ka paraparë që do të sigurohet përkrahje të plotë për të gjitha shitjet e realizuara nga AKP- ja si dhe promovimin dhe ruajtjen e raporteve të mira me investitorët. Në aspektin e realizimit të shpalljes së shitjeve janë planifikuar plane multi-mediale marketingu, përfshirë përdorimin e mjeteve të duhura mediale, në përputhje me strategjinë për marketing masiv. Megjithatë, për shkak të mosfunksionalizimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së gjatë periudhës janar-dhjetor 2015 nuk është bërë asnjë shpallje e shitjeve të aseteve, çka ka rezultuar me mospërmbushje të planit operacional.

Aktivitete marketingu dhe aktivitete promovuese

Iniciativat e Reja të Marketingut

Me qëllim të promovimit të procesit të privatizimit dhe pasqyrimit të efekteve pozitive që ka pasur ky proces në ekonominë e Kosovës, me fokus të veçantë në performancën e kompanive të privatizuara dhe efektet në ekonomitë lokale, është iniciuar projekti për azhurimin e informatave ekzistuese të ndërmarrjeve që tashmë promovohen si privatizime të suksesshme si dhe identifikimin dhe pasqyrimin e një numri të konsiderueshëm të ndërmarrjeve që janë funksionalizuar dhe kanë ndikim pozitiv në aspektin e punësimit, investimeve dhe prodhimit, në periudhën post-privatizimit.

Për dallim nga strategjia e mëparshme e cila ka paraparë vetëm pasqyrimin e ndërmarrjeve të mëdha, kësaj radhe është menduar që përpos kompanive më të mëdha, të paraqiten edhe kompani më të vogla, duke u nisur nga premisa se "*Sukseset e çdo madhësie duhet të festohen, pasi që sukseset e vogla në kumulativ kontribuojnë drejt një historie të madhe suksesi për tërë programin e privatizimit dhe punës së Agjencisë*". Implementimi i këtij projekti ka filluar në tetor 2015, me c'rast është bërë azhurimi i informatave, bazuar në vizitat dhe intervistat e realizuara.

Gjithashtu, tashmë është bërë identifikimi i një numri të konsiderueshëm të ndërmarrjeve si potenciale për përfshirje në këtë projekt dhe kanë filluar vizitat në terren. Megjithatë, pjesa më e madhe e projektit mbetet të realizohet gjatë vitit 2016.

Njëkohësisht, në përputhje me qëllimin e përshkruar më lartë, si dhe me qëllim të kooperimit të ndërsjellë, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, në realizimin e një fushate për promovimin e potencialeve për investim që ofron Republika e Kosovës, janë realizuar bisedime me MTI dhe Agjencinë për Promovimin e Investimeve në Kosovë (KIESA) dhe është draftuar Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të AKP-së dhe KIESA-së në lidhje me realizimin e "Broshurës promovuese të Ndërmarrjeve dhe Aseteve të privatizuara". Përkundër faktit që plani dinamik ka paraparë realizimin e kësaj broshure gjatë vitit 2015, marrëveshja ende nuk është zyrtarizuar dhe AKP-ja është ende në pritje të komenteve nga MTI/KIESA.

Projekti i përshkruar më lartë mund të shërbej si bazë e mirë për inicimin e një hulumtimi të mirëfilltë mbi suksesin e privatizimit. Për faktin se është menduar që të kontaktohen të gjithë pronarët e rinj të pronave të privatizuara, numri i respondentëve do të përfaqësonte një mostër të kënaqshme mbi të cilën mund të ndërtohej një raport i paanshëm që do të pasqyronte gjendjen e vërtetë të efekteve të privatizimit.

Aktivitete promovuese

Në mbështetje të strategjisë për promovimin dhe tërheqjen e investitorëve njësia e Marketingut ka ndërmarrë aktivitete të ndryshme marketingu:

a) Realizimi i materialeve të shtypura promovuese - përfshirë konceptimin, dizajnin dhe mbikëqyrjen e shtypit. Disa nga materialet e realizuara përfshijnë:
   - Dizajnimi dhe koordinimi me operatorin ekonomik për shtypjen e materialit promovues për MIM Goleshin
   - Pako promovuese për delegacionin e Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA)
   - Dizajne për materiale promovuese (broshura, kalendari, notesë etj)

b) Pjesëmarrja në prezantimin e mundësive për privatizim për delegacionin e UEA, organizuar nga zyra e Presidentes së Kosovës, mbajtur në Prishtinë

c) AKP-ja është kontaktuar nga ana e Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë, në lidhje me vizitën e pritur të një delegacioni të investitorëve potencial nga India. Takimi është mbajtur në muajin korrik 2015 ku janë prezantuar puna e Agjencisë si dhe mundësitë investive përmes procesit të privatizimit.

d) Takim me investitorë potencial për Boksitet e Kosovës, ku janë prezantuar te dhënat e përgjithshme për AKP-ne, procesi i privatizimit si dhe të dhëna gjenerale për ndërmarrjen. Takimi është organizuar dhe ndërmjetësuar nga ana e ambasadës italiane

e) Janë bërë propozimet në lidhje me azhurimin e tekstit të paraqitur si storie të suksesit dhe pasurimin e kësaj liste me ndërmarrje të reja të identifikuara nga njësia e marketingut

Përgatitjet për shpallje te shitjeve

Në kuadër të aktiviteteve mbështetëse për shpalljen e shitjeve janë ndërmarrë veprimet si në vijim:

- Përgatitjet për shpalljen e Shitjes së Aseteve 27 dhe Shitjen e Aseteve 28
    1. Përgatitja e koncepteve për TV reklamë, përpunimi dhe realizimi i TV reklamës
    2. Përmbledhja e materialeve relevante, koordinimi me zyret rajonale dhe Njësinë për Përgatitjen e Tenderëve në lidhje me përgatitjen e shpalljeve për Shitje të Aseteve

Marrëdhënie me Investitorë

Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitorë vazhdon të mbetet pika primare e komunikimit me investitorët potencial vendor dhe ndërkombëtar, duke u përgjigjur kërkesave dhe ofruar udhëzime dhe këshillime rreth procesit të privatizimit dhe pjesëmarrjes në tenderët e shpallur, përfshirë parakualifikimin, koordinimin e hulumtimit paraprak dhe sigurimin e materialeve tenderuese (Rregullat e Tenderit, Memorandume Informimi etj) .

Ueb Faqja

Në shërbim të ngritjes së transparencës dhe nivelit të informimit, ëëebfaqja e AKP-së popullohet me të gjitha informatat publike në lidhje me procesin e privatizimit në Kosovë. Kjo përfshin lansimin e Valëve të Privatizimit dhe Shitjes së Aseteve, listat preliminare dhe finale të punëtoreve për shpërndarjen e 20%, raportet përfundimtare të likuidimit, komunikatave për media, raportet dhe rregulloret e AKP-së, rezultatet dhe vendimet për shitjet e Ndërmarrjeve të Reja dhe Aseteve, si dhe informatave të tjera të rëndësishme. Njëkohësisht, si pjesë integrale e ueb faqes së AKP-së është edhe linku për qasje në arhivën e ueb faqes së AKM-së, e cila pasqyron të dhënat mbi privatizimin deri në periudhën Qershor 2008, kur edhe është bërë transferimi i përgjegjësive në AKP.

Pas një analize të përmbajtjes së uebfaqes së AKP-së, Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitor ka identifikuar mungesat dhe mosunifikimin e informatave ekzistuese. Në këtë drejtim, është punuar intensivisht në përpunimin e materialeve dhe përgatitjen për publikim të të gjitha shitjeve të realizuara nga AKM/AKP-ja deri më tani. Pas finalizimit të formatit në përputhje me kërkesat e menaxhmentit të AKP-së, pritet që publikimi i shitjeve në uebfaqe të bëhet në fillim të muajit janar 2016.

5.3. NJËSIA PËR KONTROLLË DHE MBIKËQYRJE

Njësia për kontroll dhe mbikëqyrje ka për detyrë që të monitorojë përmbushjen e zotimeve për investime kapitale, zotimit për punësim dhe vazhdim të aktivitetit të biznesit, sipas Marrëveshjes për Zotime për ndërmarrjet e privatizuari përmes metodës së Spin Off-it Special dhe Spin Off-et me kushte.

Gjithashtu Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje bazuar në planin e biznesit për 2015 nga ndërmarrjet të cilat ende nuk janë futur në likuidim bën:

- Mbledhjen dhe analizimin e raporteve financiare të NSh-ve të si dhe
- Vizitat dhe kontaktet me institucionet tjera relevante në mënyrë që të kemi një komunikim më të mirë me institucionet e interesit të përbashkët si dhe koordinimin e aktiviteteve me njësitë tjera brenda AKP.

Në vazhdim po paraqesim raportin mbi ndërmarrjet që janë nën monitorim të NJKM.

“Spin off-et” Speciale

Që nga fillimi i procesit të privatizimit e deri më tani janë privatizuar 26 ndërmarrje përmes metodës së “Spin Off-it Special”. Nga këto ndërmarrje 20 janë liruar nga marrëveshja e zotimeve, 4 ndërmarrjeve për shkak të mospërmbushjes së zotimeve për investime dhe punësim me vendim të Bordit të AKP-së iu janë marrë aksionet kurse dy ndërmarrje të privatizuara me metodën e “Spin Off-ve Speciale” janë monitoruar nga Njësia për kontrollë e mbikëqyrje gjatë periudhes nga 01.01.2015 deri 30.09.2015 për shkak se në mungesë të Bordit të AKP ende nuk ka ndonjë vendim për këto ndërmarrje e të cilat janë ‘IDGJ Tobacco’’ Gjilan dhe ‘’ NBI Suhareka’’ (Agrokosova Holding)- Suharekë.

Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco” Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco” Shpk, është privatizuar përmes metodës së Spin Off-it Special në valën e 11-të shitjes, ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të parapara në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 13 Gusht 2008. Me datë 27 Mars 2012 është aprovuar Marrëveshja për Përtëritje (Novacion) e Marrëveshjes së Zotimeve lidhur me Ndërmarrjen e Re “IDGJ Tobacco” Shpk nga Grupi punues i AKP-së. Kjo Marrëveshje është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 mars 2012, si dhe është nënshkruar nga të gjitha palët e përfshira në këtë Marrëveshje me datë 12 prill 2012, ku kusht për këtë Ndërmarrje gjatë periudhës dy vjeçare është të realizoj Investime prej 4,000,000.00 € dhe të plotësoj numrin e punëtorëve prej 14 punëtor në muajin e parë, 35 punëtor në muajin e dytë, 55 punëtor në muajin e tretë dhe 90 punëtor nga muaji i katërt e deri në përfundim të Marrëveshjes së Novacionit. Periudha e raportimit për këtë ndërmarrje ka përfunduar me 10 shtator 2014. Në mënyrë që të verifikohen Investimet e realizuara dhe punësimi në këtë Ndërmarrje nga ana e Blerësit, AKP ka angazhuar kompaninë audituese të pavarur për të bërë auditimin e Investimeve dhe punësimit të realizuar. Kompania audituese më datën 19.12.2014 ka dorëzuar raportin e auditimit ku sipas këtij raporti Blerësi nga 4,000,000.00 Euro investime të zotuara ka realizuar investime në vlerë prej 3,254,238.07 apo shprehur në

përqindje 81.36 %. Sa i përket punësimit sipas raportit të auditimit Blerësi ka përmbushur zotimet për punësim në përqindje prej 95.68%.

Pas shkresës së dërguar tek Blerësi lidhur me kërkesën për përfundimin e monitorimit nga Blerësi i Ndërmarrjes së Re kemi pranuar përgjigjen në shkresë dërguar Menaxhmentit të AKP-së ku ai kërkon që t'i zgjatet afati i përmbushjes së zotimeve deri më 28.02.2015 ngase nga periudha e përfundimit të monitorimit që ka qenë 10 shtator 2014 deri më datën 28 Shkurt Blerësi thekson se ka bërë investime shtesë me të cilat investime shtesë sipas tij janë përmbushur zotimet për investime sipas marrëveshjes së zotimeve. Sipas Blerësit vlera e Investimeve në Ndërmarrje nga ana e Blerësit që nga fillimi deri në momentin e vizitës sillet rreth 4,818,609.47 €. Kërkesa e palës për t'iu zgjatur afati I investimeve do të dërgohet për shqyrtimin e Bordit të Drejtorëve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë bërë 6 vizita tek kjo ndërmarrje dhe e cila deri më tani nuk ka filluar prodhimin e duhanit por ka kryer vetëm punë përgaditore dhe ne nuk kemi parë ndonjë angazhim shtesë nga ana e Blerësit për të filluar prodhimtarin apo për ndonjë koperim me fermerët vendor.

Ndërmarrja e Re "NBI Suhareka/Agrokosova Holding"- është privatizuar me 27 gusht 2007 nga blerësi "Gruppo Vinicolo Fantinel" dhe "QMI" përmes metodës së "Spin Off-it Special" në valën e 19-të të shitjes ndërsa periudha e përmbushjes së zotimeve të paraparë në Marrëveshjen e Zotimeve ka përfunduar me datën 27 gusht 2009. Sipas Marrëveshjes së Zotimeve blerësi është zotuar se do të bëjë investime kapitale në vlerë prej 8,600,000 euro si dhe të punësoj 173 punëtorë gjatë 6 mujorit të parë ndërsa në fund të vitit të parë numri i të punësuarve do të arrij gjithsej 345 punëtorë. Në mbledhjen e Bordit të AKP-së të mbajtur më datën 26 dhe 31 gusht 2014 Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të privatizimit lidhur me çështjen e Ndërmarrjeve të reja të privatizuara ne Spin off Special ka vendosur që për Ndërmarrjen e Re "Agrokosova Holding" të anulohet vendimi i Bordit të datës 16 dhjetor 2011 për tërheqjen e aksioneve dhe t'i vazhdohet afati për përmbushjen e kushteve të Marrëveshjes për Zotime nga 27 gusht 2009 e deri me 31 dhjetor 2014 dhe pas përfundimit të afatit të auditohet ndërmarrja për tërë periudhën e investimeve sipas kontratës për të vërtetuar përmbushjen e zotimeve.

Nga blerësit e Neë Co Agrokosova Holding kemi pranuar kërkesën për zgjatje të afatit për realizimin e investimeve. Kjo kërkesë arsyetohet me kushtet dhe rrethanat e krijuara në këtë ndërmarrje si dhe kërkohet që ti shtyhet afati për investime deri më 30 Prill 2015.

Sipas raportit te auditimit të realizuar nga kompania e auditimit ''AK Konto'' për periudhën nga 27.08.2014 deri më 31.12.2014 ku nga vlera 8,600.000.00 Euro janë përmbushur 7,045,713.00 Euro apo 81.93 %. Pasi që kemi diferenca të theksuara në raportet e auditimit nga tri kompanitë audituese të angazhuara në auditimin tek kjo ndërmarrje ne kemi mbajtur një takim me kompanitë Audituese AK Konto, Univerzum Audit dhe Trend Biz ku është diskutuar në lidhje me diferencat në mes të auditimeve të mëhershme dhe auditimit të fundit në Ndërmarrjen e Re "Agrokosova Holding" Suharekë. Në diskutim e sipër me kompanitë, secila nga kompanitë audituese mbron qëndrimet e veta në lidhje me auditimet e realizuara dhe na kanë ofruar edhe njëhëre shkresat e tyre mbi auditimin e kryer nga ta tek kjo ndërmarrje. Lidhur me këtë situate ne kemi biseduar edhe me zyrtarët nga Këshilli Kosovar për Raportim financiar te Kosovës dhe ata theksuan se nuk kanë kapacitete për ndonjë angazhim shtesë dhe se nuk mund të përcaktojnë se cili raport i auditimit mund

të konsiderohet më i sakte prandaj nuk mund te ndërmarrin asnjë veprim ndaj ndonjërës prej kompanive audituese deri ne një faze nëse përcaktohet me ndonjë ekspertizë shtesë apo ndonjë auditim tjetër lidhur me saktësinë e raporteve të dorëzuara nga kompanitë audituese.

Nga përfaqësuesit e blerësit të Ndërmarrjes së Re ,,AgroKosova Holding'' është pranuar një raport detajuar në lidhje me investimet e realizuara për periudhën nga 01.01.2015 deri më 30.04.2015. Sipas këtij raporti vlera e investimeve të bëra është 1,805,500.00 Euro dhe për të cilat investime varësisht nga vendimi i Bordit të AKP-së duhet bërë një auditim i jashtëm. Pas kësaj periudhe Blerësi nuk ka raportuar ndonjë investim shtesë por vetëm është duke punuar në mirëmbajtje të vreshtave si dhe ka bërë mbljelljet të disa parcelave me prodhimtari vjeshtore.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar 5 vizita informuese ku nga vizitat nuk kemi parë ndonjë aktivitet prodhues në ndërmarrje por vetëm aktivitete në mirëmbajtjen e hardhive dhe ku numri i punëtorëve të angazhuar aty është sjellur nga 20 deri 25 punëtor.

Ndërmarrjet e Privatizuara me Kushte

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2015 , dhjetë Ndërmarrje të privatizuara me kushte kanë qenë në procesin e monitorimit të përmbushjes së kushteve të kontratës, kryesisht vazhdimit të aktivitetit të njëjtë të biznesit. Ndërmarrja " Llamkos'' L.L.C për shkak se Blerësi i saj kishte obligime ndaj një banke Angleze me vendim të Gjykatës Themelore ka filluar proceduara e likuidimit dhe është caktuar administratori i saj.

Tabela përmbledhëse e ndërmarrjeve të privatizuara me kushte:

Nr.	Emri i Ndërmarrjes	Statusi	Qyteti	Regjioni
1	Ndërmarrja e Re "SharrCem"	Nën monitorim	Hani i Elezit	Gjilan
2	Ndërmarrja e Re "Hotel Union"	Nën monitorim	Prishtinë	Prishtinës
3	Aseti "Llamkos"	Me vendim të gjykatës iu është caktuar administratori dhe nuk monitorohet nga AKP-ja	Vushtrri	Mitrovicës
4	Ndërmarrja e Re "Famipa"	Nën monitorim	Prizren	Prizrenit
5	Ndërmarrja e Re "Amortizatorët"	Nën monitorim	Prishtinë	Prishtinës
6	Ndërmarrja e Re "Dubrava DF"	Nën monitorim	Istog	Pejës
7	Ndërmarrja e Re "Emin Duraku-Edico"	Nën monitorim	Gjakovë	Pejës
8	Ndërmarrja e Re "Emin	Nën monitorim	Gjakovë	Pejës

	Duraku”- KI			
9	Ndërmarrja e Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça”	Nën monitorim	Pejë	Pejës
10	Ndërmarrja e Re “Hotel Onix dhe Banja e Pejës”	Nën monitorim	Pejë	Pejës

Ndërmarrja e Re “Sharrcem” është privatizuar me 9 dhjetor 2010 për shumën prej EUR 30.1 milion. Sipas Marrëveshjes për Shitblerjen e aksioneve blerësi ka marrë përsipër që gjatë 5 viteve në vijim të bëjë investime në vlerë prej 35 milion euro si dhe të vazhdojë të punësoj gjatë 3 viteve të para të gjithë ish-punonjësit e ndërmarrjes, gjithsej 503. Ndërmarrja e Re “Sharrcem” është e obliguar t’i raportoj AKP-së deri më 9 dhjetor 2015.

Janë realizuar 6 vizita të rregullta monitoruese në Ndërmarrjen e Re të privatizuar me kushte Sharrcem.
Gjatë këtyre vizitave dhe në bazë të raportimeve të Blerësit kemi vërejtur se niveli i investimeve ka rënë dhe është nën parashikimet e investimeve kapitale që duhet të bëj Blerësi në përputhje me marrëveshjen e zotimeve. Kryesishtë janë bërë disa investime të vogla në mirëmbajtje apo blerje të aparaturave të ndryshme por që vlera e investimeve gjatë vitit 2015 është dikund 1,437,000.00 Euro, kurse investimet totale nga periudha e fiilimit të monitorimit deri më tani të raportuara nga ana e Blerësit kanë qenë në shumë totale prej 25,437,000.00 euro. Blerësi ka bërë edhe disa investime të tjera që nuk janë përfshirë në këtë vlerë si blerja e një mulliri horizontal në vlerë prej 3,500,000.00 të cilin e ka paguar Blerësi por ende nuk ka ardhur . Gjithashtu Blerësi ka bërë blerjen e disa aksioneve në një kompani jashtë hapësirave të ndërmarrjes në vlerë prej 2,900.000.00 dhe ka blerë disa aksione jashtë Kosovës në vlerë prej 1,408,000.00 Euro dhe pretendon se edhe këto investimet e fundit duhet të njihen si investime kapitale. Të gjitha këto investime të raportuara nga ana e Blerësit do të auditohen nga një kompani audituese ndërkombëtare e cila është e paraparë me kontratë.

Në ndërmarrje janë të punësuar 406 punëtorë, kontratat e reja ju janë bërë me afat 2 vjeçar.

Sipas Blerësit gjatë këtij viti në periudhën e verës dhe më vonë ka pasur prodhimtari dhe shitje rekorde të cimentos. Ne jemi në fazën e angazhimit të kompanisë audituese ndërkombëtare e cila do të bën auditimin e përmbushjes së zotimeve për investime kapitale në përputhje me marrëveshjen e zotimeve dhe pas pranimit të raportit të auditimit do ti raportojmë Bordit të AKP-së mbi gjendjen në këtë ndërmarrje

Aseti “Llamkos Steel” Sh.p.k,

Aseti “Llamkos Steel” Sh.p.k, është privatizuar në valën 6 të shitjes përmes Likuidimit, ndërsa ratifikimi i Kontratës së Shitjes është bërë me datën 25 gusht 2011. Bazuar në Marrëveshjen e Shitblerjes se aseteve dhe Planin e Biznesit, blerësi i Ndërmarrjes së re Llamkos ka marrë përsipër që të punësoj 437 punonjës 6 muaj pas nënshkrimit të kontratës si dhe të bëjë investime ne vlerë prej 25 milion Euro vetëm gjatë dy viteve të para të veprimtarisë.
Blerësi i ndërmarrjes gjithashtu merr përsipër të zbatoj edhe dy faza të tjera investimesh, gjate fazës së dytë (18 muaj pas përfundimit të fazës së parë) do të investohen edhe 45 mil Euro ndërsa gjatë fazës së tretë (18 muaj pas përfundimit të fazës së dyte) do të investohen edhe 30 mil Euro të tjera.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar dy vizita monitoruese si dhe është mbajtur një takim me përfaqësuesit e sindikatës së pavarur të punëtorëve të Ndërmarrjes së Re Llamkos Galvasteel Vushtri. Gjatë këtij takimi janë theksuar problemet e punëtorëve të ndërmarrjes. Gjatë këtyre vizitave në ndërmarrje nuk kanë qenë i angazhuar ndonjë punëtorë dhe vazhdon të mos ketë asnjë aktivitet prodhues.

Është përgatitur fatura financiare me ndëshkime për muajin janar 2015 për Ndërmarrjen e Re të privatizuar me kushte Llamkos Galvasteel

Pas informimit nga sindikata e punëtorëve se "Coresteel'' Shpk me numër të regjistrimit të biznesit 70758695 si blerës i aseteve të ndërmarrjes së Re "Llamkos Steel"' Sh,p.k. me numër 70254965 me aktvendim të Gjykatës Themelore në Prishtinë numër 1/2015 është futur në procedurë të falimentimit dhe gjykata ka caktuar Administratorin e ndërmarrjes në falimentim dhe se falimentimi i ndërmarrjes është bërë me kërkesë të Kreditorit "Standard Bank" PLC me seli në Mbretërinë e Bashkuar për borxhin që "Coresteel" Sh.p.k. ka ndaj kësaj banke në shumë prej 27,588,908.66 Euro ne kemi mbajtur një takim me zyrën ligjore kurse më datën 26.02.2014 ka mbajtur një takim më të zgjeruar ku u konstatua se AKP duhet të bën kërkesë kreditore tek Administratori i Ndërmarrjes si dhe të tentoj që një zyrtar i AKP të jetë në Bordin e Kreditorëve i cili do të themelohet pasi të përfundon periudha e paraqitjes së kërkesave kreditore e cila është 23 mars 2015. Administratori I ndërmarrjes sipas informatave që ka AKP nuk ka formuar Bord të Kreditorëve por të gjitha kërkesat kreditore I ka adresuAr në Gjykatë e cila ka marrë vendime për kërkesat kreditore.

Gjithashtu pasi që aseti i ndërmarrjes së Re "Llamkos Steel" iu është shitur me kushte të caktuara "Coresteel" Sh.p.k si konstatim doli se si kërkese kreditore përveç ndëshkimeve që kemi llogarit deri më tani me vendim të Bordit të AKP- së si mospërmbushje e investimeve kapitale për fazën e parë,të llogariten edhe ndëshkimet për fazën e dytë dhe të tretë të investimeve dhe ndëshkimet për punësim për këto dy faza.

Së bashku me Departamentin Ligjor kemi përgatitur kërkesën kreditore për blerësin e Ndërmarrjes ''Coresteel'' Sh.p.k . Në shkrese janë paraqitur si kërkesë kreditore ndëshkimet e lëshuara deri më tani dhe kërkesat tjera për dëmin e shkaktuar për fazën e dytë dhe të tretë të cilat pas fillimit të procedurës se falimentimit nuk mund të përmbushen më në të ardhmen. Është mbajtur një seancë gjygjësore ku pritet të vendoset edhe për kërkesën tonë kreditore kurse nga Administratori kemi marr një përgjigje se sipas tij kërkesa jonë është e pabazuar për shkak se dëmi i cili është shkaktuar nga mospërmbushja e zotimeve për investime nuk mund të provohet se ka qenë i qëllimshëm. Zyra Ligjore do të ndërmarrë hapat e tjerë të nevojshëm lidhur me kërkesën tonë kreditore. Më datën 25.03.2016 zyra ligjore ka pranuar aktvendimin nga Gjykata ku kërkesa kreditore e AKP-së është refuzuar dhe tani zyra ligjore është duke përgaditur ankesë në këtë aktvendim.

Ndërmarrja e Re "Famipa" Ndërmarrja e Re "Famipa" sh.p.k është privatizuar në valën 49 të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitblerjes është nënshkruar me datën 13 Shtator 2011.
Shtojca 5, Seksioni B i Deklaratës së bartjes të aseteve dhe detyrimeve parasheh që blerësi i Ndërmarrjes së Re "Famipa" do të vazhdoj aktivitetin e njëjtë në ndërmarrje (prodhimin dhe përpunimin e metaleve) si dhe nuk do të çmontoj dhe dislokoj pajisjet nga ndërmarrja deri në përfundim të kontratës.

Duke pasur parasysh se nga përfundimi i marrëveshjes së zotimeve për shkak të mungesës së Bordit të AKP-së ndërmarrja ende nuk është liruar nga marrëveshja e zotimeve ne dy herë kemi kërkuar nga përfaqësuesit e Blerësit që të zhvillojmë vizitat në hapësirat e ndërmarrjes por një gjë e tillë nuk është pranuar nga përfaqësuesi i Blerësit me arsyetim se ka përfunduar marrëveshja e zotimeve dhe ne nuk kemi të drejtë të vizitojmë hapësirat e ndërmarrjes.

Me kërkesë te policisë se Kosovës janë përgatitur të gjitha shkresat në lidhje me këtë ndërmarrje si kontrata e shitblerjes, të gjitha shkresat hyrëse për këtë ndërmarrje, të gjitha shkresat dalëse, të gjithë raportet nga vizitat e bëra nga zyrtaret e monitorimit si dhe raportimet e bëra nga ana e Blerësit. Gjithashtu u është dorëzuar edhe raporti i auditimit për këtë ndërmarrje.

Ndërmarrja e Re "Hotel Union" Ndërmarrja e Re Hotel Union është privatizuar në valën 11, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 02 gusht 2006. Bazuar në Marrëveshjen e Zotimeve 541/2006, neni 2 dhe 3, blerësi i Ndërmarrje së Re është zotuar së do të restauroj dhe mirëmbajë pamjen e jashtme të ndërtesës në atë mënyrë që thellësisht të ruaj stilin dhe karakterin historik të ndërtesës si dhe t'i siguroj Aleancës së Shkrimtarëve të Kosovës një hapësirë prej 200 m^2 për 13 vitet e ardhshme.

Nga Blerësi i "Hotel Unionit" Beneton Group kemi kemi pranuar edhe njëherë ofertën e tyre për LSHK lidhur me hapësirën prej 200 metra katror që duhet lejuar për LSHK. Këtë ofertë e kemi adresuar tek Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës që të na njoftojmë në lidhje me vendimin e marrë pas propozimit nga Benetton Group. Zyrtaret nga Lshk nuk kane qenë të kënaqur me këtë propozim të Beneton Group prandaj lidhur me këtë përgjigje të tyre ne kemi njoftuar Blerësin e ndërmarrjes.

Ne kemi kërkuar nga të dy palët që të gjejnë një zgjidhje por deri më tani ata nuk po mund të arrijnë marrëveshje ngase Blerësi thekson se ata nuk janë të obliguar ti ofrojnë hapësirën prej 200 metrave LSHK brenda objektit të Hotel Unionit kurse LSHK kërkon që kjo hapësirë të jetë Brenda objektit të Hotel Unionit.

Blerësi edhe njëherë ka shprehur interesimin që të negocoj me LSHK për këtë hapësirë dhe ka theksuar se kërkesat që bëhen që LSHK të vendoset brenda hapësirës së objektit të ndërmarrjes janë në kundërshtim me kontratën dhe ndikojnë keq tek investitorët e huaj ngase ai e sheh atë si presion ndaj tij.

Ndërmarrja e Re ,, Hotel Onix Banja e Pejës dhe Banja e Shëndetit '' Pejë;

Ndërmarrja e Re "Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix" shpk, është privatizuar si projekt individual përmes tenderit ndërkombëtarë ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 22 prill 2013. Bazuar në shtojcën 1, Marrëveshja për Zotime e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për Shitblerjen e Aksioneve të thjeshta në Ndërmarrjen e Re "Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix" shpk, Blerësi është zotuar si në vijim:

Të vazhdoj aktivitetin aktual të biznesit që nënkupton vazhdimin e veprimtarisë së njëjtë të Ndërmarrjes Shoqërore në banjë shëndetësore dhe hotel deri më 22 prill 2016. Blerësi i Ndërmarrjes së Re siguron dhe garanton se do të vazhdoj dhe do të mbajë aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e Periudhës se Zotimit. Ndërmarrjen e Re "Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix", është duke zhvilluar

aktivitetin e tij në fushën e paraparë me kontratë dhe është duke ju përmbajtur kushteve të kontratës ashtu siç është zotuar. Përpos vazhdimit të veprimtarisë së biznesit blerësi ka bërë edhe investime të konsiderueshme në rindërtimin e objekteve dhe përmirësimin e infrastrukturës përcjellëse.

Janë realizuar 5 vizita monitoruese ku nga këto vizita dhe nga raportimet e Blerësit konstatojmë se Blerësi vazhdon të mbajë aktivitetin operues si dhe janë bërë investime kapitale në izolimin e objektit dhe është ndërtuar transporti i nxehjes i përbërë prej 9 gypave, punimet në basenet (terapitë), pastrimi i objektit, izolimi i kulmit si dhe është bërë përzgjedhja dhe përfundimi i punimeve të eksterierit tek objektet e ndërmarrjes. Blerësi gjithashtu thekson se kanë filluar punimet e vrazhda në Hotel Ilixha. Punimet do të realizohen sipas projektit të paraparë (përfundimi i punimeve të vrazhda brenda këtij viti)si dhe blerësi deklaron se kanë marrë autorizimin preliminar për të filluar ndërtimin e panelave solar. Deri në fillimin e punimeve për ndërtimin e këtyre panelave, presin autorizimin e plotë nga ZRE dhe realizimin e marrëveshjes me KEDS dhe që deri më tani nuk kanë arritur të pajisen me leje përfundimtare. Deri më tani është futur në funskion pishina gjysëm olimpike e tipit të mbyllur dhe janë duke u bërë edhe një numër investimesh me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të akomodimit për mysafir jo vetëm për qëllime shëruese por edhe për mysafir tjerë që vizitojnë këtë institucion rehabilitees.

Momentalisht ka të angazhuar nga 120 deri 122 punëtorë për të cilët ka kontrata si dhe ka ofruar dëshmi mbi pagesën e kontributeve pensionale për ta. Problemet me furnizimi me energji elektrike vazhdojnë edhe më tutje dhe këto reduktime janë duke ndikuar direkt në ushtrimin e aktivitetit të ndërmarrjes.

Gjatë kësaj periudhe është pranuar raporti gjashtëmujor për Ndërmarrjen e Re të privatizuar me kushte "Spitali Special për Rehabilitim të Përgjithshëm Onix" që përfshin periudhën deri më tetor 2015 dhe sipas këtij raporti gjatë vitit 2015 , Blerësi ka bërë investime kapitale në shumë prej 1,147,526.64 Euro dhe ka punësuar nga 120 deri në 122 punëtor. Pasi që Blerësi ka obligim kontraktual për raportim në periudha 6 mujore për periudhën tjetër raportuese nga tetori deri në përfundim të vitit 2015 respektivisht prill 2016 do të shpalosen në raportet vijuese.

Ndërmarrja e Re "Fabrika e Amortizatorëve"

Është privatizuar në valën 45A, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar më 31 mars 2011. Ndërmarrja e Re "Fabrika e Amortizatorëve" gjendet në Komunën e Prishtinës. Në bazë të marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe mbaj aktivitetin aktual të biznesit. Blerësi ka raportuar në periudha të rregullta ashtu siç parashihet edhe me Kontratë. Periudha e Monitorimit përfundon më 31 mars 2016. Ndërmarrja nuk ka prodhimtari serike por vetëm prodhon dhe rregullon amortizatorët me porosi dhe kohë paskohe sipas kërkesave individuale.Në kontratë të shitjes thuhet vetëm mbajtja e aktivitetit por pa cekur vlera si të prodhimit, shitjes, punësimit apo të ndonjë aktiviteti tjetër dhe kjo na shkakton vështirësi edhe në përcaktimin e saktë mbi mbajtjen apo jo t ë aktivitetit të ndërmarrjes.

Gajtë vitit 2015 janë realizuar gjashtë vizita monitoruese dhe në këto vizita Blerësi ka raportuar mbi shërbimet e tij që janë rregullimi dhe prodhimi i amortizatorëve të cilët bëhen kryesishtë me porosi d.m.th nuk ka linjë të prodhimit serik ngase Blerësi arsyetohet se nuk ka treg për ndonjë prodhim serik por kryesishtë bën riparimet e amortizatorëve të vjetër. Veprimtaria vazhdon në rregullimin e amortizatorëve

dhe pjesëve tjera mekanike, hidraulike dhe pneumatike për kombi, vetura, kamionë, etj. kryesisht aq sa ka porosi, dhe gjendja kryesishtë është e pandryshuar që nga fillimi i aktivitetit të tij. Sipas raportimeve të Blerësit që janë në periudha gjashtëmujore dhe nuk lidhen me vitin kalendarik, qarkullimi në periudhën raportuese për shërbimet e kryera deri më 12.10.2015 ka qenë në vlerë prej 8,521.00 Euro si dhe kanë pasur të hyra nga qiraja në vlerë prej 19,657.00 Euro. Shpenzimet për investime kapitale kanë qenë në vlerë prej 104,225.00 si dhe shpenzime të tjera operative ka pasur në vlerë prej 5,724.00 Euro. Për periudhën tjetër deri në fund të vitit raportimi i Blerësit bëhet në muajin prill të vitit 2016 dhë përfshin periudhën nga tetori I vitit 2015 deri në mars të vitit 2016.

Numri i punëtorëve të angazhuar në ndërmarrje gjatë kësaj periudhe ka qenë nga 18 deri në 20.

Blerësi furnizohet me lëndë të parë kryesisht në tregun e Kosovës dhe për ndonjë pjesë specifike furnizohet nga partneri Slloven "Amortizeri D.O.O).

Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Kompleksi Industrial" Shpk, është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 03 shtator 2012. Ndërmarrja e Re ""Emin Duraku Kompleksi Industrial" Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 03 shtator 2017. Pjesa dërmuese e ndërmarrjeve të shitura me kushte nuk kanë ndonjë obligim kontraktual për investime apo punësim me shifra por kanë kusht vetëm mbajtjen e aktivitetit actual të bisnesit. Edhe kjo ndërmarrje ka kusht vetëm mbajtjen e aktivitetit actual të bisnesit.

Gajtë kësaj periudhe janë realizuar 5 vizita monitoruese ku numri i punëtorëvë të angazhuar në ndërmarrje sillet nga 11 deri në 13 punëtor ku 7 prej tyre janë të angazhuar në procesin e prodhimit (kryesisht në këtë Ndërmarrje prodhohen dyshek të dimensioneve të ndryshme), ndërsa 6 punëtor janë të angazhuar si roje të kësaj Ndërmarrje. Për këta punëtor të punësuar në këtë Ndërmarrje, Blerësi kryen obligimet si: rroga, tatime dhe kontribute si dhe një shujtë të ngrohtë për këta punëtor.

Blerësi i kësaj ndërmarrje ka hyre në një partneritet me kompaninë INTERTEX shpk, ku theksuan se do të gjeneroj 70 vende pune. Sipas këtij partneritetit të lidhur ndërmjet Intertex dhe Blerësit të Ndërmarrjes së Re "Emin Duraku Kompleksi industrial" Blerësi do të ia ofroj objektin, ndërsa Intertex do të prodhoj mbulesa për një përdorim për Kompaninë e veturave "VOLVO".

Gjatë kësaj periudhe është pranuar raporti gjashtëmujor nga Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Kompleksi Industrial", i cili ka raportuar për vazhdimin e aktivitetit në këtë Ndërmarrje. Ne këtë raport Blerësi ka ofruar informata mbi disa fatura hyrëse të energjisë elektrike, dhe kontratat e punës për të punësuar si dhe disa informata mbi faturat shitëse të lëshura nga ana e blerësit. Gjithashtu ka ofruar fatura mbi investimet që është duke bërë në objektin tjetër afër objektit qe e shfrytëzonte deri me tani per prodhimin e tij. Nga vizitat e bëra shihet se blerësi është duke e rinovuar një pjesë të objektit prej rreth 1200 m² për ta bërë funksionale hapësirën për aktivitet ekonomik. Edhe ky blerës thekson se ka problem të vazhdueshem me furnizim të energjisë elektrike të tensionit të ulët. Gjendja në ndërmarrje vazhdon të jetë e njejtë ku përpos prodhimeve të dyshekëve nuk ka ndonjë prodhimtari tjetër në tekstil. Sipas raportimit të Blerësit gjatë kësaj periudhe ka bërë investime në vlerë prej 17,208.00 Euro dhe ka pasur të hyra nga shërbimet e tyre në vlerë prej 20,607.00 Euro.

Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Edico" Shpk, është privatizuar në Valën 45 A, ndërsa ratifikimi i kontratës është bërë me datën 14 gusht 2012. Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Edico" Shpk gjendet në Komunën e Gjakovës. Obligimin që ka marrë përsipër Ndërmarrja është vazhdimi i aktivitetit aktual të biznesit për periudhën prej 5 viteve, konkretisht deri më 14 gusht 2017.
Janë zhvilluar 8 vizita monitoruese ku nga këto vizita dhe nga raportimet e Blerësit konstatojmë se në ndërmarrje janë të punësuar nga 17 deri në 20 punëtor Blerësi kryen obligimet si: rroga, tatime dhe kontribute si dhe një shujtë të ngrohtë e realizon për këta punëtor, punëtorët po ashtu kane kontrata pune.
Ndërmarrja prodhon produkte nga tekstili, veshje sportive për mosha të ndryshme të njerëzve me dizajnë të ndryshëm.

Blerësi është duke e vazhduar aktivitetin në fushën e tekstilit, kryesisht prodhimin e trikove, veshjeve sportive dhe xhinseve.

Problem i veçantë sipas Blerësit ka mbetur edhe me tutje furnizimi me energji elektrike ngase kompania Kesco deri me tani nuk i ka dal në ndihmë Bleresit për vendosjen e një trafoje e cila do të siguronte furnizim stabil me energji elektrike. Blërësi ka bërë një kërkesë tek AKP-ja që t'i ndihmoj lidhur me këtë situatë ku zyra regjionale e Pejës ka asistuar tek kompania Keds për tejkalimin e kësaj situate. Gjatë fundit të vitit ka pasur disa dëmtime në objekt si rezultat i erërave të forta që kanë dëmtuar pullazin e objektit.

Sipas raportimeve të Blerësit Ndërmarrja gjatë vitit 2015 ka pasur një afarizëm pozitiv ku të hyrat kanë qenë në total në vlerë prej 158,116.00 Euro dhe shpenzimet totale në vlerë prej 129,472.00 në të cilat shpenzime përfshihen edhe pagat e punëtorëve që janë në vlerë prej 40,080.00 Euro si dhe disa investime kapitale që janë bërë nga ana e Blerësit .

Ndërmarrja e Re "Dubrava Dairy Farm" – është privatizuar në valën e 28 –të të shitjes, ndërsa Kontrata e Shitjes është ratifikuar me 19 dhjetor 2011. Ndërmarrja e Re "Dubrava Dairy Farm" gjindet në Komunën e Istogut. Në bazë të Marrëveshjes, si detyrim kontraktues Blerësi i Ri ka marrë përsipër që të vazhdoj dhe të mbaj aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së detyrimit kontraktues, respektivisht deri më 19 dhjetor 2016, (periudha prej 5 viteve). Detyrimi kontraktues që del nga kontrata është që Ndërmarrja e Re "Dubrava Dairy Farm" është e obliguar të mbaj të punësuar 17 punëtor, si dhe të mbaj 250 krerë gjedhe për këtë periudhë kohore në bazë të Kontratës.

Janë realizuar 8 vizita monitoruese ku nga to shihet se Bleresi ka bërë ndërrimin e linjës nga ajo e mishit ne linjen qumeshtore. Blerësi vazhdon aktivitetin e tij në përputhje me marrëveshjen e zotimeve dhe per momentin ka 260 krerë gjedha dhe 17 punëtor të cilëve përpos pagës iu siguron edhe shujtën e ngohtë. Ka kryer edhe mbjelljet vjeshtore në një numër të caktuar të hapësirave bujqësore që ka në dispozicion.

Gjatë periudhës raportuese ndërmarrja ka pasur të hyra nga shitja në vlerë prej 104,079.00 Euro si dhe shpenzime operative në vlerë prej 252,934.00 Euro në të cilat shpenzime përfshihen edhe pagat e punëtorëve të angazhuar në ndërmarrje që kanë qenë në vlerë prej 47,210.00 Euro. Blerësi ka raportuar edhe investime në blerjen e gjedhëve mjelëse ku nga Gjermania ka importuar gjedhe në vlerë prej 91,701.30 Euro si dhe ka bërë investime në mekanizëm bujqësor dhe shtalla në vlerë prej 24,949.00 Euro. Pjesa tjetër e shpenzimeve kanë qenë shpenzime për ushqim për kafshë dhe shpenzime tjera që janë nevojitur për mbjelljet e kulturave të ndryshme bujqësore.

Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça"

Ndërmarrja e Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça" Sh.p.k, është privatizuar si projekt individual, ndërsa kontrata e shitjes është ratifikuar me datën 14 qershor 2013. Me këtë Blerësi i Ri siguron dhe garanton se do të vazhdoj dhe do të mbaj aktivitetin aktual të biznesit deri në përfundimin e periudhës së Zotimit për tri vitet e ardhshme, konkretisht deri më 14 qershor 2016.

Në këtë Ndërmarrje janë realizuar 5 vizita të rregullta monitoruese ku sipas raportimeve të Blerësit dhe informative të marra konstatojmë se Blerësi po prodhon kryesishtë bateri me porosi, pasi që nuk ka treg për prodhimtari serike prandaj kjo ndikon që Ndërmarrja nuk prodhon bateri në proces të pandërprerë. Kryesishtë janë prodhuar bateri për Trepçën veriore dhe pak për eksport në Shqipëri.

Sipas raportimeve të Blerësit në ndërmarrje janë duke punuar 38 punëtor për të cilët edhe pagesat e pagave bëhen me vështërsi dhe me vonesa disa muajshe.

Gjatë kësaj periudhe nga Blerësi i Ndërmarrjes se Re "Fabrika e Baterive Industriale Trepça" është pranuar raporti 6 mujor ku Blerësi ka raportuar mbi vazhdimin e aktivitetit i cili aktivitet nuk përfshin ndonjë prodhim serik për shkak se ka mungesë të plasimit të produkteve por prodhohet kryesishtë sipas kërkesave individuale. Sipas raportit të pranuar për periudhën gjashtëmujore të hyrat nga shitja dhe shërbimet e realizuara kanë qenë në vlerë prej 71,448.00 Euro kurse shpenzimet totale kanë qenë në vlerë prej 128,050.00 euro nga të cilat për paga të punëtorëve janë paguar 88,744.00 Euro dhe pjesa tjetër prej 39,305.00 Euro kanë qenë shpenzime materiale të tjera si blerje të lëgurave, kutive dhe arkave të tjera metalike që nevojiten për prodhim dhe transport të produkteve që prodhohen në ndërmarrje.

Ndërmarrja e Re "Kualiteti International" Sh.p.k Gjilan

Është privatizuar në valën e 25 të shitjes dhe kontrata është nënshkruar më datën 26 maj 2008. Shitja e ndërmarrjes është bërë me spin off të thjeshtë, por me kusht që gjatë periudhës 2 vjeçare ndërmarrja të mbaj aktivitetin e vet si mulli respektivishte si depo për grumbullimin e drithërave.

Në bazën e të dhënave të ndërmarrjeve të privatizuara me spin off special apo me kushte të trashëguara nga AKM nuk ka qenë e përfshirë kjo ndërmarrje se duhet monitoruar, prandaj edhe nuk është monitoruar asnjëherë aktiviteti i saj deri në Shtator 2014.

Pas kësaj periudhe janë zhvilluar dy vizita monitoruese, gjatë këtyre vizitave është vërejtur se blerësi vazhdon ta mbajë aktivitetin prodhues pjesërisht, pasi që vazhdon ta prodhojë një sasi të vogël të bukës të cilën pastaj e shpërndan në markete të vogla. Blerësi thekson se ka vështirësi në ushtrimin e aktivitetit si pasojë e konkurrencës në treg. Është vërejtur se nuk ka dislokim të makinerisë nga hapësirat brenda objektit.

Në hapësirat ku gjendet ndërmarrja ka filluar të ndërtohet një objekt afarist-banesor, ku punimet në këtë objekt kanë shkuar deri në katin e shtatë dhe shihet se aty janë të angazhuar edhe më tutje punëtorët, materiali ndërtimor dhe makineritë të cilat janë të vendosura në oborrin e ndërmarrjes, ku vazhdojnë të kryhen punimet në ndërtimin e këtij objekti.

Është proceduar padia për Neë Co "Kualiteti International"lidhur me fillimin e ndërtimeve pa leje paraprake nga AKP-ja, të cilën Dhoma e Posaqme e ka hedhur poshtë prandaj zyra ligjore ka bërë prapësim në këtë vendim, ndërkohë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kemi marrë aktvendimin me të cilën

pranohet ankesa e AKP ndaj AKK lidhur me ndërtimet e bëra nga ana e Blerësit së bashku me ndërmarrjen ‘’Agrohermes’’ në hapësirat e ndërmarrjes dhe pa marrë aprovimin paraprak nga AKP-ja.

Ndëshkimet financiare për mospërmbushje te zotimeve

Për shkak të mospërmbushjes se zotimeve deri me tani janë aplikuar ndëshkimet financiare për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet.

Me poshtë japim formën tabelare të ndëshkimeve për periudhën kohore janar 2015 – dhjetor 2015 si dhe shumën e përgjithshme e ndëshkimeve financiare që janë aplikuar nga fillimi deri në dhjetor 2015:

Shuma totale e ndëshkimeve për 5 SSO-të		
Ndërmarrje Re	Ndëshkimet Janar – Dhjetor2015	Prej datës së fillimit deri më 31 Dhjetor 2015
Ndërmarrja e Re"Grand Hotel"'	0	8,822,314.97
Ndërmarrja e Re"IDGJ Tobacco"	0	4,573,649.11
Ndërmarrja e Re "Xim Strezovc"	0	7,298,170.76
Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"	0	8,447,812.27
Ndërmarrja e Re "Agrokosova Holding"		3,579,997.53
Ndërmarrja e Re "Llamkos"	29,029.28	1,715,488.79
Totali	**EUR 29,029.28**	**EUR 34,437,433.43**

Vërejtje:

Ndërmarrjeve të privatizuara me spin off special '' Grand Hotel'', '' ''Xim Strezovc'' dhe ''Mim Golesh'' iu janë marrë aksionet nga ana e AKP-së.

Aseti ,,Llamkos'' i cili është shitur me likudim dhe për shkak të obligimeve të Blerësit ndaj disa institucioneve financiare (Bankave), me vendim të Gjykatës ka filluar proceduara e falimentimit dhe Gjykata ka përcaktuar Administratorin i cili do të administron me te. AKP ka bërë kërkesë kreditore tek Administratori për këto ndëshkime të cilat iu janë aplikuar Blerësit për shkak të mospërmbushjes së marëveshjes së zotimeve dhe nga administratori kemi marrë një informatë se kërkesa jonë nuk mund të pranohet.

AKTIVITETET E TJERA

Me kërkesë të Departamentit ligjor te AKP-së është përgatitur dokumentacioni i kërkuar për Ndërmarrjen e cila ka qenë e Komercializuar - CRK Fapol (Kontrata dhe të gjitha letrat që i posedojmë nga Komercializuesi dhe letrat që i janë dërguar nga AKP-ja Komercializuesit si dhe Raportet e Auditimit dhe Vlerësimit të Ndërmarrjes CRK Fapol).

Blerësit të ndërmarrjes se Re "IMN Brick Factory'' ju është dorëzuar vendimi mbi lirimin nga Marrëveshja e zotimeve.

5.4. NJËSIA E ADMINISTRIMIT DIREKT

Në rrjedhën normale të ngjarjeve, mbikëqyrja, kontrolli dhe monitorimi i ndërmarrjeve bëhet nga Zyrat Rajonale të AKP-së. Masat e Administrimit Direkt janë implementuar në rastet specifike kur një NSH kishte ngadalësim apo ngecje në progres apo ishte në rrezikshmëri financiare për shkak të keqmenaxhimit, apo dëmtimit të aseteve e që reflektonte në dëm të interesave të NSH-së dhe punëtorëve të saj. Kur Zyrat Rajonale të kenë shterur të gjitha mundësitë dhe opsionet për të gjeneruar ndikim pozitiv në NSH-në e cila shfaq një trend të rënies, atëherë propozohen masat e Administrimit Direkt nga Zyrat Rajonale të AKP-së për t'u implementuar në këtë ndërmarrje. Të gjitha NSH-të e vendosura dhe/ose të larguara nga AD janë të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.

Gjatë periudhës raportuese Njësia e AD ishte kryesisht e fokusuar ne Administrimin e Ndërmarrjeve të cilat me vendim te Bordit ishin vendosur nën AD, po ashtu kishte përgatitur te dhënat për Ndërmarrjet të cilat janë larguar nga AD.

1) Ndërmarrja e Re "Mim Golesh" Sh.p.k

Pas hyrjes ne AD te Ndermarrjes eshte aplikuar në Drejtoratin për Kadastër në Lipjan për ndërrimin e titullarit të pronësisë dhe regjistrimin e Ndërmarrjes në pronësi te AKP-se. Drejtoria e Kadastrit në Lipjan ka ndryshuar titillarin e pronësisë dhe ka regjistruar Ndërmarrjen në pronesi të AKP-së, pas Vendimit të fundit që AKP ka marre nga Kolegji i Apelti të Dhomës së Posaçme, me të cilën ka refuzuar padinë e ish-blerësit lidhur me Vendimin e AKP-së për terheqjen e aksioneve dhe vendosjne e Ndërmarrjes "MIM Golesh" në Administrim të AKP-së .

Eshte bere regjistrimi i gjendjes se aseteve ne te gjithe hapesiren e Ndermarrjes;

Me vendim te menaxhmetit te AKP-se, jane emëruar Menaxheret e Perkohshem te Ndermarrjes se re "Mim Golesh" sh.p.k.

Gjithashtu jane punesuar edhe 20 punetore te nivelit tekniko – administrativ përmes programit buxhetor Riorganizmi dhe Administrimi i NSH-ve të kategorisë ekonomike subvendcion me qellim te mbarveajtjes se puneve ne Ndermarrje.

Janë realizuar pagat mujore dhe pagesat e tatimit të mbajtur në burim dhe kontributit pensional për këta 25 punëtorë te NSh "Mim Golesh" sh.p.k. përmes programit buxhetor Riorganizimi dhe Administrimi I NSH-ve të kategorisë ekonomike subvendcion;

Jane zhvilluar takime me investitor te ndryshem qe kane shpreh interesim per minierën.

Gjithashtu kemi shpallur dy herë ftesën për ofertë per shitjen e zhavorrit të Ndërmarrjes së re "MIM Golesh" si dhe për shitjen e materialit shkëmbor ultrabazik i perioditetit të Goleshit (material për mbushje) me granulacion - 60 +10 mm me qellim te inkasimit te te hyrave per realizimin e te gjitha obligimeve dhe detyrimeve te Ndermarrjes. Herën e pare nuk ka pasur palë të interesuara ndersa herën e dytë kane shprehur interesim vetëm dy Operator Ekonomik, por anëtarët e komisinot kanë konstatuar se vlera e cila është ofertuar ka qene e nënvleresuar dhe nuk ka qenë në përputhje me çmimin e tregut

Përpilimi i kontratave të punës për Menaxherët e Përkohshëm të Ndërmarrjes dhe punëtoreve të tjerë për periudhën prill – dhjetor 2015.

Përgatitja e kërkesës buxhetore për vitin fiskal 2016 dhe parashikimet për vitin 2017-2018 duke argumentuar në detaje për secilën nënvijë buxhetore.

Njësia e Administrimit Direkt/Menaxhmenti i AKP-se ka zhvilluar disa takime me Bechtell Enka me qëllim për të vazhduar kontratën për shfrytëzimin e dunitit e cila ka qenë në fuqi në momentin e tërheqjes së aksioneve. Megjithatë, për shkak që KPMM ka refuzuar bartjen e licencave nga ish pronari te AKP, marrëveshja nuk ka mundur të vazhdohet, e as të nënshkruhet nga AKP.

Gjendja momentale e kompleksit xehetaro-metalurgjik të MIM- Goleshit është e tillë, që pa investime financiare nuk është e mundur që të rifilloj procesi i prodhimit, prandaj stafi menaxhues i ndërmarrjes ka përgatitur planin emergjent të veprimit për regjenerimin e mjeteve financiare, duke shitur materialet të cilat i posedon ndërmarrja, si në vijim:

a) **Shkëmbinj ultrabazik** me granulacion -150 mm, materiali është i minuar nga Bechtel &Enka i pa thërrmuar, sasia e materialit rreth 200000t. Materiali mund të shitet me çmim rreth 0.70 €/ton.

b) **Shkëmbinj ultrabazik** me granulacion -60mm, material i thërrmuar, sasia 30000t. Materiali mund të shitet me çmim 3-5 €/ton.

c) **Zhavorr nga shkëmbinjtë e Dunitit** , me granulacion -5 +1mm, sasia rreth 1000m^3 ose rreth 2000t. Çmimi i materialit mund të shitet rreth 5- 7 €/t ose 1.5-3.5 €/m3.

2) Ndërmarrja "Ereniku – Industria" Gjakovë

Gjendja financiare në ndërmarrje është vështirësuar për shkak të ngecjes në pagesa të qirave. Qiramarrësit disa herë kanë dërguar kërkesa për zbritjen e qirave.

Është dërguar vërejtje finale me shkrim për mos pagesë të borxhit të akumuluar, "Ariani" sh.p.k. Përmes shkresës pala është njoftuar se aktualisht është duke shfrytëzuar asetin në fjalë pa kontratë të qirasë pasi që është refuzuar vazhdimi i kontratës së qirasë me çmimin e njëjtë. Njësia e Administrimit Direkt, përmes disa shkresave/vërejtjeve ka kërkuar që të paguhet borxhi i akumuluar me qëllim që të vazhdohet bashkëpunimi i ndërsjellë. Pasi që i njëjti nuk ka shprehur gatishmërinë që të paguaj borxhin e akumuluar në emër të qirasë Njësia e AD kishte kërkuar asistencen policore për të dëbuar shfrytëzuesin, gjatë procedurës së lirimit të objektit shfrytëzuesi kishte pranuar të paguaj një pjesë të borxhit, por me kushtë që kërkesa e tij për zbritje të qirasë të shqyrtohet. Duke u bazuar në kërkesën e qiramarresit "Ariani" sh.p.k Menaxhmenti i AKP-së ka emeruar tre anëtarë të komisionit me detyrë konstatimin e gjendjes faktike të shfrytezimit të hapësirës si dhe percaktimin dhe ndarjen e hapesirës e cila nuk shfrytezohet nga qiramarresi. Pas vizitës në terren dhe konstatimit të gjendjes faktike anëtarët e komisionit kane konstatuar se çmimi i kontraktuar të mos ndryshohet për faktin se nuk kemi ndryshim të konsiderueshëm të kushteve kontraktuale pas konstatimit të gjendjes faktike të asetit të NSH "Ereniku-Industria". Qiramarresi N.T.SH "Ariani" shpk edhe pse eshte njoftuar nga Njesia e AD për refuzimin e kërkesës për zbritje të qirasë ende vazhdon për mos kryerjen e

obligimeve kontraktuale. Përveç kësaj shfrytezuesi i asetit të Ndërmarrjes ka refuzuar të nënshkruaj kontratën e qirasë me kushtet të cilat qiramarrësi e ka shfrytëzuar këtë aset edhe më parë.

-Është dërguar vërejtje finale me shkrim për mos pagesë të borxhit të akumuluar "Litografisë". . Njësia e Administrimit Direkt, përmes disa shkresave/vërejtjeve si dhe takimeve të ndërsjella ka kërkuar që të paguhet borxhi i akumuluar me qellim që të vazhdohet bashkëpunimi i ndërsjellë. Edhe përkundër kësaj nuk është treguar gatishmëri që të vazhdohet me pagesën e qirasë konfrom marrëveshjes paraprake të qirasë. Njësia e AD kishte kërkuar asistencen policore për të dëbuar shfrytëzuesin, gjatë procedurës së lirimit të objektit shfrytëzuesi kishte pranuar të paguaj në tërësi borxhin. Pas kësaj periudhe shfrytezuesi i asetit të NSH "Ereniku-Industria" –Litografia deri në muajin nëntor 2015 ka kryer ogbiligimet e qirasë dhe ate sipas kontratës. Prej muajit nëntor 2015 e tutje kemi probleme në inkasimin e qirasë.

- Shfrytëzuesi i paligjshëm i asetit të NSH "Ereniku-Industria" Xhelal Sadiku është në kontest pronësor me Ndërmarrjen, dhe i njejti ka parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Gjakove për vërtetim të pronësisë. Shfrytëzuesi i paligjshem i asetit të Ndërmrrjes ka kërkuar të hynë në marrëdhënie kontraktuale deri në zgjidhjen e kontestit gjygjesor. Kërkesa është shqyrtuar nga NJAD dhe është përgaditë Kërkesa për Veprim për Opinion Ligjor. Në Opinion Ligjor eshte ceke se korniza ligjore që e rregullon çështjen e qiradhënjes nuk lejon që Ndërmarrja të hyje na marredhenie kontraktuale pa aprovimin paraprak të qiradhënies nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së. Me këtë rastë kjo çështje është pezulluar deri në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Janë zhvilluar disa korrespondenca me Kompaninë Publike të Mbeturinave "Qabrati" në Gjakovë, lidhur me shfrytëzimin e asetit i cili është në pronësi të Ndërmarrjes "Ereniku-Industria". Ndërmarrja ka refuzuar që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale duke u bazuar në një dokument të para luftes i cili nuk paraqet bazë ligjore për të garantuar të drejtën e shfrytëzimit të asetit. Gjatë vitit 2016 pritet dëbimi i kësaj Ndërmarrje nëse eventualisht nuk pajtohen që të vendosin marrëdhënie kontraktuale me Ndërmarrjen respektivisht AKP-në.

Ndërmarrja "Boksitet e Kosovës

Bordi Menaxhues i NSH "Boksitet e Kosovës" Klinë, ka marrë Vendimet si në vijim:

- për vazhdimin e kontratës aktuale me Kompaninë "Victoria Invest" i cili shfrytëzon me qera asetin e Ndërmarrjes-Fabrikën e Llaçit të thatë;

- për shpërndarjen e mjeteve financiare për punëtoret të cilët janë në asistencë teknike;

- për pagesën e borxhit ndaj KPMM-së për taksat e gurit dhe taksës administrative;

Pas vendimit të Bordit Menaxhues të NSH "Boksitet e Kosovës" Klinë, për pagesën e borxhit ndaj KPMM-së për taksat e gurit dhe taksës administrative, kemi zhvilluar takim me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, me qëllim të riprogramimit të borxhit të Ndërmarrjes për licencat e shfrytëzimit. Kryetari i Bordit të KPMM na bëri të qartë se fillimisht duhet të paguhet gjysma e borxhit, e mandej të procedohet me pagesën me këste të pjesës së mbetur.

Takim me Agjencine Pyjore të Kosoves për të diskutuar lidhur me taksen të cilën Boksitet duhet ta paguajne për shfrytezimin e dy aseteve të cilat i kanë të leshuara me qira. Ky lloj i takses është taksë për kalimin nëpër

pronen e cila figuron në emër të Ekonomise Pyjore, në mënyrë që të shfrytezohen këto dy asete. Po ashtu ky lloj pelqimi nevojitet edhe për vazhdimin e licencave të shfrytezimit në KPMM.

Vendimi i Ndermarrjes për të dëbuar një familje e cila e shfrytezon ish objektin e administrates së ndërmarrjes. Policia ka ushtruar kallezim penal ndaj Drejtorit të ndermarrjes. Lidhur me këtë ne kemi qenë ne stacionin policor ne Kline, mirepo Komandanti i policisë na ka udhezuar qe duhet të shkojm në Prokurorinë themelore ne Pëjë, pasi qe rasti udhehiqet nga nje Prokuror, dhe se vetem me të duhet të takohemi në menyrë që të sqarohen detajet dhe procedurat e mëutjeshme. Deri me tani nuk kemi pranuar asnje dokument me të cilin dëshmohet se familja e cila ka qenë e vendosur në objektet e ish administrates së Ndermarrjes, gëzon të drejten e shfrytëzimit me ndonje vendim të Habitatit apo Gjykates. Megjithate Policia e ka permendur në vendim të Habitatit me të cilin një personi të komunitetit serb i njihet e drejta e shfrytezimit të objektit ne fjale, mirepo Ndermarrja dhe AKP nuk e posedojëe atë dokument. Gjatë javës së ardhshme duhet zhvilluar një takim me prokurorin e rastit. Anetarët e Bordit të Ndermarrjes na kanë sqaruar se familja e vendosur në objekt i paguan qira familjes serbe e cila jeton në Serbi.

- Seancë Gjyqesore, ku padites është AKP si perfaqesuese e Boksiteve të Kosoves. Kontesti ka të bëjë me vertetimin e të drejtës së shfrytezimit të një banese e cila figuron në pronesi të Ndermarrjes mirepo është e uzurpuar. Si palë ndërgjygjese është edhe nje ish punetor i Ndermarrjes i cili gëzon të drejtën e shfrytezimit pasi që banesa në fjale i është ndarë me vendim të Ndermarrjes në vitin 1988 si dhe është konfirmuar me vendim pas luftës. Lidhur me këtë kontest kanë mbetur të zhvillohen edhe dy senaca deri në nxjerrjen e vendimit të Gjykates.

Drejtori i Ndërmarrjes mori përsipër nxjerrjen e pasqyrës së borxheve së bashku me ndëshkime si dhe pa ndëshkime, krejt kjo me qëllim të nxjerrjes së një pasqyre reale të borxhit ngase me ligjin e ri të nxjerr nga Qeveria e Republikës së Kosovës të gjitha borxhet deri me 01 janar 2009 do të shlyhen, me kusht që nese ka borxhe pas vitit 2009 duhet të nënshkruhet marrëveshje me ATK.

Me date 23.09.2015 në të përditshmet informative kemi shpalle Ftesën për Ofertë në lidhje me dhënien me qira të seperacionit aset i NSH “Boksitet e Kosovës” Klinë.

Me datë 30.09.2015 anëtaret e komisionit kane bërë hapjen dhe vlerësimin e ofertave.

Anëtarët e komisionit në mënyrë unanime morrën Vendim për përzgjedhjen e fituesit të tenderit për dhënien me qira të asetin të NSH “Boksitet e Kosovës”-Seperacionin dhe atë sipas kritereve të përcaktuara në Ftesën për Oferte-çmimi me i larte, Operatorin Ekonomik NNP “Joni-Tech” dhe atë në vlerë prej 5,205.00 €uro me TVSH.

Edhe përkundër faktit se është nënshkruar kontrata e qirasë në vlerë prej 5,205.00€, qiramarrësi ka parashturuar kërkesë për zbritje të qirasë gjate sezonit të dimrit dhe ate në nivelin prej 50% të vlerës së qirasë. Një kërkesë e tillë është refuzuar si e pabazuar dhe e jashtligjshme. Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoj kontraten e nënshkruar duke i shkaktuar dëme të konsiderueshme Ndërmarrjes. Në këtë rast është kërkuar nga Kompania e Sigurimit “ELSIG” për të ekzekutuar garancionin e lëshuar po nga kjo kompani në emër të Operatorit Ekonomik NNP JONI TECH. Garancioni per ekzekutimin e kontratës ka qenë pjesë përbërëse respektivisht kusht i tenderit publik. Po ashtu është proceduar kërkesa tek përmbaruesi privat cili ka nxjerr Aktvendim për përmbarim në shumë prej 5,250.00 euro. Në këtë Aktvendim pala ka ushtruar ankesë dhe rasti ka kaluar në kontest në Gjykatën e Apelit Departamentin Ekonomik. Bazuar në provat e parashtruar presim që shumë shpejt Gjykata të sjellë vendim në favor të Ndërmarrjes. Nga vendimi i Gjykatës si dhe nga Garancioni bankar Ndërmarrja pret që të inkasoj 10,410.00 euro.

5.5. DEPARTAMENTI PËR KOORDINIM TË LIKUDIMIT

Divizioni i Likuidimit (DL) është njëri nga dy divizionet përmbajtësore të Agjencisë. Në kuadër të këtij Divizioni vepron Departamenti për Koordinim të Likuidimit (DKL). Qëllimi kryesor i Departamentit për Koordinimit të Likuidimit është koordinimi i menaxhimit të procesit të likuidimit në Agjenci, si dhe mbikëqyrja e zhvillimit të politikave në funksion të implementimit të këtij procesi. Departamenti i Koordinimit të Likuidimit përbëhet nga tri njësi:

1. **Njësia për Menaxhimin e Projektit të Likuidimit;**
2. **Njësia e Likuidimeve nga AKP-ja; dhe**
3. **Njësia për Listat e Punëtorëve.**

NJËSIA PER MENAXHIMIN E PROJEKTIT TË LIKUIDIMIT

- Janë dorëzuar të gjitha raportet me rregull nga kontraktori si dhe janë mbajtur mbledhjet e rregullta ku janë diskutuar çështje të ndryshme lidhur me procesin e likuidimit, rrjedhimisht janë përgatitur edhe raportet shqyrtuese për raportet e dorëzuara.
- Numri i përgjithshëm i kërkesave ka arritur në: 89,630 kërkesa, ndërsa numri i vendimeve të marrura dhe të dërguara tek pretenduesit deri më tani ka arritur shifër: 89,268 vendime (83,282 vendime të marrura nga kontraktori dhe 5,986 vendime të mëhershme të marrura nga KL - AL);
- Numri i përgjithshëm i NSh-ve për të cilat ka filluar procesi i likuidimit deri më tani ka arritur shifrën prej 462 Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim;
- Gjatë periudhës raportuese janë regjistruar gjithsejtë: 820 kërkesa kreditore;
- Kërkesa të pasafatshme deri më tani janë regjistruar 1,526 sosh;
- Është pranuar Raporti i Auditimit nga Njësia e auditimit të brendshëm mbi aktivitetet e Departamentit për Koordinimit të Likuidimit si dhe monitorimin e kontratës me OShP-në për periudhën nëntor 2013 - tetor 2014. Në funksion të zbatimit të rekomandimeve nga raporti i fundit i pranuar nga auditori i brendshëm si dhe në funksion të mbarëvajtjes së procesit të tërësishëm të likuidimit është bërë edhe azhurnimi i aplikacionit.
- Janë publikuar grupe të komunikatave - njoftimet për vendime të AL-ve për pretenduesit për të cilët nuk u janë gjetur adresat në gazetat vendore si dhe në ato në Serbi dhe Mal të Zi sipas procedurave;
- Deparatmenti i Prokurimit ka përgatitur për nënshkrim aneksin ekontratës me Kontraktorin, me rastin e rritjes së vlerës së TVSh-së nga 16% në 18 %.
- Janë përgatitur kërkesat dhe Memo për Komitetin Drejtues të Likudimit-në dhe Komisionin e Bordit për aprovimin e raporteve të prezantuara në mbledhje të ndryshme të KDL-së të mbajtura gjatë tërë vitit;
- Eshtë aprovuar dhe ndryshuar dokumenti “Procedurat e angazhimit të ofruesve të shërbimeve” në bazë të cilit janë angazhuar dhe paguar OSh-të në zyrat rajonale të AKP-së;
- Stafit i DKL-së vazhdmimisht është caktuar që të merr pjesë në komisionet për hapjen dhe vlerësimin e ofertave për dhënien e aseteve me qira të NSh-ve në Likuidim të organizuara në Zyrat Rajonale të AKP-së;
- Janë bërë ndryshimet e nevojshme në përbërjen e AL-ve si nga ana e Kontraktorit ashtu edhe nga ana e stafit të AKP-së me qëllim të organizimit dhe shpërndarjes sa më të mirë të mundshme të punëve në mes të Zyrtarëve të Rastit.
- Vazhdimishtë është përcjell insertimi i dokumenteve nga AL-të në aplikacionin e Likuidimit nga të gjitha zyrat rajonale të AKP-së me qëllim të mbarëvajtjes se procesit të likudimit

- Komiteti Drejtues i Likuidimit (KDL) gjatë periudhës raportuese ka mbajtur 6 takime. Në mbledhjen e KDL-së (pjesa e përbërjes nga Agjencia) të mbajtur me datë 4 nëntor 2015 është vendosur që të zbatohen penalet ndaj kontraktorit për likuidimin e dëmeve të shkaktuara ndaj Agjencisë si pasojë e mos përfundimit të shqyrtimit dhe dërgimit tek pretenduesit të të gjitha kërkesave deri me datë 10 korrik 2015 ashtu si kërkohet edhe me kontratë (neni 17.1 faqe 19 Kushtet e Veçanta të Kontratës). Me këtë rast janë bërë llogaritjet ditore në lidhje me dëmet.
- Me datë 30 dhjetor 2015 Bordi i Drejtorëve të Agjencisë ka mbajtur mbledhje dhe ka aprovuar bartjen e fondeve tepricë nga 125 Ndërmarrje në likuidim në shumë prej € 61,310,628, në buxhetin e Republikë së Kosovës;

Kontraktori ka bërë shqyrtimin e kërkesave sipas planit të paraqitur në mënyrë tabelare si më poshtë:

Plani i prezantuar i punës për periudhën	**Plani**	**Të arriturat**	**%**
Janar 2015	500	840	170
Shkurt 2015	1,100	1,208	109
Mars 2015	1,400	1,199	85
Prill 2015	1,400	1,187	84
Maj2015	1,400	906	65
Qershor 2015	1,400	907	65
Korrik 2015	208	439	-

*Sipas planit të punës të prezantuar nga kontraktori për vitin 2015 është paraparë që shqyrtimi i kërkesave të kryhet deri me datë 10 korrik 2015, dhe si pasojë e rrethanave të ndryshme ka mbetur një numër i kërkesave pa u shqyrtuar.

Statusi i tanishëm i kërkesave:

Përshkrimi	Gjithsej
Numri i përgjithshëm i kërkesave kreditore të dorëzuara në Agjenci që nga fillimi i procesit të likuidimit	89,630
Numri i kërkesave kreditore të vendosura nga Komisionet e Likuidimit - KL	5,986
Numri i kërkesave kreditore të vendosura nga kontraktori nga korriku 2012 deri dhjetor 2015:	83,282
Numri i kërkesave kreditore të dorëzuara nga pretenduesit gjatë periudhës raportuese	820
Numri i vendimeve të dërguara palëve gjatë periudhës raportuese nga kontraktori	7,825
Numri i kërkesave kreditore ende të pashqyrtuara	362
Numri i kërkesave ende të pashqyrtuara që nuk janë nën kontrollin e OShP-së	0
Numri i NSh-ve për të cilat ka filluar procesi i likuidimit gjatë periudhës raportuese	2
Numri i të gjitha NSh-ve për të cilët ka filluar procesi i likuidimit që nga fillimi i procesit	462
Numri i NSh-ve për të cilët është kryer procesi i shqyrtimit të gjitha kërkesave kreditore gjatë periudhës raportuese	153
Numri i NSh-ve për të cilët janë përgatitur Draft Raportet e Shpërndarjes nga kontraktori gjatë periudhës raportuese	108

NJËSIA PËR LIKUIDIMIN E NSH-VE NGA AKP-JA

- Është emëruar Autoriteti i Likuidimit për: KB Bibaj, KB Gaçkë, KB Novobërda, KB Visoqa, Partizan Babush, CIK Kumanova, Gjeodezia, KB Përparimi Trstenik, KB Glloboqica dhe KB Xhafa, të njëjtat hyjnë në kategorinë e NSh-ve pa asete dhe/ose pa kërkesa kreditore dhe procesi i likuidimit të tyre do të përmbyllet nga Njësia për Likuidimin e NSh-ve nga AKP-ja.
- Është punuar në lidhje me sigurimin e dokumentacionit të duhur në lidhje me përmbylljen e procesit të likuidimit për këto NSh nga kjo njësi.
- Kreditorëve të NSh-ve pa asete u janë dërguar njoftimet për mungesë të fondeve ashtu siç edhe parashihet me procedura.
- Është punuar në përgatitjen e raporteve përfundimtare për:KB Bibaj, KB Gaçkë, KB Visoqa dhe KB Xhafa pa asete dhe/ose pa kërkesa.

Në këtë Njësi janë gjithsej 26 ndërmarrje të ndryshme ku për 7 nga të cilat ka përfunduar i tërë procesi i likuidimit me Aktvendime përkatëse të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe 19 NSh janë ende në proces.

Gjatë kësaj periudhe është punuar në përgatitjen e raporteve përfundimtare për ndërmarrjet të cilat sipas procedurave janë në kompetencë të kësaj njësie dhe që nuk kanë asete, ndërsa në rastet ku ka asete përgatitja e raporteve për këto NSh-të bëhet pas shitjes së aseteve të tyre. Nga kontraktori është përgatitur edhe një listë shtesë me emrat e 31 NSh-ve për të cilat pretendohet se janë pa asete dhe ose pa kërkesa kreditore dhe/ ose asetet e të cilave nuk janë të regjistruara në emër të tyre. Kjo listë do të jetë subjekt i riverifikimit të aseteve para se të dorëzohen për të u likuiduar nga kjo njësi e AKP-së.

NJËSIA PËR LISTAT E PUNËTORËVE PËR 20%

Shpërndarja e 20% për periudhën janar – dhjetor 2015

Gjatë periudhës raportuese janar - dhjetor 2015, është bërë shpërndarja e pjesës së 20% për punëtorët e kualifikueshëm të NSh-ve në shumë të përgjithshme prej € 8,028,314. kurse kanë përfituar nga shpërndarja e fondeve të 20% gjithsej 15,125 punëtorë.

5.6. NJËSIA E RIORGANIZIMIT DHE ADMINISTRIMI I NSH-VE

Më 29 janar 2015, Gazeta Zyrtare e RKS ka publikuar: LIGJIN Nr. 05/L-008 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-035 PËR RIORGANIZIMIN E NDËRMARRJEVE TË CAKTUARA DHE PASURISE TYRE, sipas së cilit ndryshohen afatet ligjore për dorëzim të Planit të Riorganizimit, duke u vazhduar deri me 1 nëntor, 2016. DhPGjS është njoftuar për këto ndryshime ligjore nga AKP dhe AKP së bashku me këto informata ka dorëzuar kërkesën për të shtyrë afatin për dorëzim të Planit Riorganizimit nga DhPGjS.

Vlen të theksohet se shumë nga punët e planifikuara në Planin vjetor për vitin 2015 nuk kanë mundur të fillohen për shkak të mos-emërimit për një kohë të gjatë të BiD, si organ kompetent për miratim të projekteve në kuadër të Riorganizimit.

Në kuadër të përgatitjes së Planit riorganizimit të Trepçës, NjRT gjatë kësaj periudhe ka koordinuar dhe mbikëqyr proceset e nevojshme për riorganizim, duke mbajtur takime me komisione profesionale për përcaktimin e rezervave minerare edhe për rivlerësimin e pasurisë së ndërmarrjes. Si rezultat janë përgatitur raportet: 1. Raporti i vlerësimit rezervave minerare dhe 2. Rivlerësimin i pasurisë së ndërmarrjes

NjRT gjithashtu, ka punuar në kërkesat e kreditoreve të paraqitura në AKP kundër Trepçës, duke i klasifikuar në kategori të ndryshme, plotësuar ato dhe përllogaritur vlerat preliminare të secilës kërkesë.

NjRT – Monitorimi i Trepçës (Menaxhmenti në Parkun Industrial në Mitrovicë)

Objektivi kryesor i mbikëqyrjes të afarizmit të ndërmarrjes është ruajta dhe shtimi i vlerës së ndërmarrjes, dhe përgatitja e saj për riorganizim, e që synohet të realizohet përmes veprimeve në vijim:

- Përkujdesi për rritje të prodhimit, rritjen e të hyrave nga shërbimet tjera dhe qiratë,
- Përkujdesja për zvogëlim të dalurave/ulje të kostos,
- Sigurimi i takimeve dhe asistimi i takimeve me palët e treta,
- Themelimi dhe pjesëmarrja në komisione me interes të veçantë.

Mbikëqyren shumë procese, por do të ndajmë ato më të rëndësishmet:

- Mbikëqyrja e procedurave të shitjes së Koncentratit të Trepçës,
- Mbikëqyrja e procedurave të prokurimit që tejkalon vlerën 10,000 Euro,
- Asistimi i Trepçës dhe angazhimi në kontestet Gjyqësore të saj, si dhe
- Luajtjen e rolit të urës ndërmjetësuese, apo kanalit komunikues ndërmjet Dhomës së Posaçme, AKP-së dhe Trepçës. NjRT gjatë periudhës raportuese ka dorëzuar raportet e rregullta tremujore në DhPGjS, si dhe të gjitha kërkesat, udhëzimet për veprim, dhe komunikimin e natyrave tjera, të dorëzuara në DhPGjS, të cilat janë iniciuar dhe proceduar nga NjRT, dhe të cilat janë realizuar në bashkëpunim me Trepçën dhe Departamentet gjegjëse të AKP-së.

Në këtë aspekt NjRT ka mbikëqyrë procedurat e shitjes së Koncentratit të Trepçës, procedurat e prokurimit që tejkalojnë vlerën 10,000 Euro të financuara nga mjetet vetanake të Trepçës, duke ndihmuar Trepçën në të gjitha fushat operative të saj si dhe është angazhuar në kontestet Gjyqësore të saj.. Gjithashtu, NjRT në

bashkëpunim me Doganat ka kontrolluar sasitë e eksportuara të xehes, nëse të njëjtat janë konform sasive të miratuara nga AKP.

Prodhimi gjatë vitit 2015, në Minierat e Artanës e Stantërgut nuk ka mundur të zhvillojë aktivitetet në mënyrë të rregullt. Lidhur me këtë në vijim janë përshkruar aktivitetet kryesore prodhuese në Trepçë bazuar në raportimet e Menaxhmentit në Parkun Industrial Mitrovicë:

Në janar 2015, janë zhvilluar situata të shumta për dhe rreth Trepçës dhe Trepça u shndërrua kryesisht në problem politik. Gjegjësisht, Aktvendimi i Gjykatës AC i – 14-0247- A0001, për dorëzim të Planit të Riorganizimit deri me datë 2 shkurt ’15, që ishte afat i ndryshuar nga afati i diktuar nga e njëjta Gjykatë më parë, shkaktoi një varg pakënaqësish që rezultuan edhe në formë të grevës së minatorëve, por edhe të protestave në rrugë me kërkesën “Trepça - Ndërmarrje Publike”. Ngjarjet e lartcekura kanë rezultuar në volum më të vogël të punëve operative në Trepçë, duke reflektuar edhe prodhim më të vogël.

Prej ndërprerjes së punëve në janar për shkak të grevës në miniera (Stantërg dhe Artanë), deri te rikthimi i dinamikës së punëve të përditshme, kanë kaluar dy javë, e që si periudhë nuk zgjati shumë. Respektivisht, pas një varg ngjarjesh, dhe qetësimit të situatës dhe rikthimit të dinamikës së punëve prodhuese, nuk kaloi një javë dhe dinamika e prodhimit ka rënë sërish pasi që me 24/01/2015, Trepçës i ka skaduar Licenca për eksploatim të xehes, licencë kjo që lëshohet nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale KPMM, i cili nuk kishte Bord, e që është organi i vetëm Kompetent për lëshimin e licencës.Trepça nuk u pajis me licencë deri në muajin maj kur u emërua dhe u vu në funksion Bordi i KPMM. Sipas Raporteve të Menaxhmentit Trepçës si pasojë e mos-vazhdimit të Licencës, mungesa e eksplozivit si dhe pasoja të tjera që rrjedhin nga mos pajisja me licencë ndikuan në rënien e prodhimit në këtë periudhë.

Mungesa e prodhimit paraqiti problem të madh në sigurimin e pagave që nga marsi e tutje për shkak të mungesës së prodhimit dhe mos-mundësisë së shitjes dhe mungesës së mjeteve të nevojshme për paga.

Pas pranimit të vendimit nga DhPGjS (CV-15-0006) për lejimin e shitjes së koncentratit të plumbit dhe zinkut, Trepça ka zhvilluar tenderin për realizim të kësaj shitjeje. Pas dështimit të realizimit të kontratës nga ana e fituesit në procesin e parë të tenderimit, ndërmarrja ka zhvilluar me përsëri procedurat e tenderimit në muajin shtator, me ç’rast lidhi kontratë me dy kompani për shitje të koncentratit të Pb dhe Zn. Realizimi i kontratave të shitjes së koncentrati do të mbikëqyret për së afërmi nga AKP - NjRT.

Në mënyrë që të ilustrojmë aktivitetin primar të Trepçës - e që është nxjerrja dhe përpunimi i xehes, më poshtë mund të shihet raporti i prodhimit vitin 2015 për të cilin e kanë raportuar Menaxhmenti Mitrovicë dhe raporti i prodhimit për periudhën 1 janar deri më 30 nëntor 2015 të raportuar nga Menaxhmenti në Zveçan i "Trepca - Ndërmarrje në Administrim të AKP”, meqense nuk ka raportuar ende raportin përfundimtar vjetor, të dhënat e paraqitura përfshijnë vetëm periudhën deri në muajin nëntor 2015.

Prodhimi i realizuar në minierën Stantërg dhe Artanë me flotacione Tuneli Parë dhe Kizhinicë

Gjatë vitit 2015 është realizuar eksploatimin i 180,994 ton xehe të Plumbit dhe Zinkut (204,140 ton në vitin 2014) nga dy minierat, që ka rezultuar me prodhim të 12,320 ton koncentrati Pb/Zn ne Flotacionet Tunel i

Parë dhe Kizhnicë prej të cilave 5,440 ton konc. Pb dhe 6,880 konc. Zn. Kjo sasi e prodhuar e koncentratit për vitin 2015, është për 26.08% më e ulët se prodhimi i vitit të kaluar 2014.

	Koncentrat Pb (ton)	Koncentrat Zn (ton)	Gjithsej kon. Pb dhe Zn (ton)
Viti 2014	7,330.63	9,336.50	16,667.13
Viti 2015	5,440.00	6,880.00	12,320.00
Krahasimi në % i prodhimit të konc. ndër vite	-25.79%	-26.31%	-26.08%

Është hera e parë gjatë dhjetë viteve pas riaktivizimit të Trepçës, që gjatë një viti këto dy miniera të kenë rënie të prodhimit të tillë. Nëse prodhimi nuk ngritët nivelin e vitit paraprak apo për rreth 30% nga prodhimi aktual, shpresat që Trepça të mund të shlyejë obligimet dhe të sigurojë pagat njëkohësisht, janë shumë të vogla, dhe vështirësitë financiare do ta ndjekin ndërmarrjen edhe gjatë vitit të ardhshëm, 2016. Andaj kërkohet nga Menaxhmenti performancë e shtuar për të menaxhuar mirë dhe shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion për rritje të Prodhimit.

5.7. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL

Departamenti i Koordinimit Rajonal bënë mbikëqyrjen dhe Koordinimin e punës së Zyrave Rajonale të AKP-së. AKP-ja ka pesë Zyra Rajonale (ZR) në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjilan dhe Mitrovicë që përfshin të gjithë territorin e Kosovës dhe dy zyre satelitore në Leposaviq dhe Shtërpce, të cilat përgjegjësi kryesore kanë grumbullimin e informative lidhur me NSh-të në rajonet përkatëse si dhe implementimin e privatizimit, likuidimit dhe aktivitetet e qeverisjes korporative.

Departamenti i Koordinimit Rajonal ka përgatitur Planin e Punës 2015 ku ky plan përfshin gjithësej 726 asete për shitje gjatë vitit 2015, te shpërndar në 8 (tetë) valë. Mirëpo përshkak të mungesës së Bordit të Drejtorëve deri ne fund të vitit 2015 ky plan ende është në pritje të aprovimit.

Po ashtu duhet potencuar se veçse janë finalizuar dokumentet për SHAL 27 dhe SHAL 28 kurse zyret rajonale kane vazhduar me vizitat në teren si dhe përgatitje e dokumenteve për SHAL 29 dhe po ashtu SHAL 30, të cilat për shkak të vonesave të cekura më lartë me siguri se do të duhet të azhurnohen.

Të arriturat

TRAJTIMI I ASETEVE TË UZURPUARA

Lidhur me trajtimin e aseteve të uzurpuara të dhënat janë paraqitur në Përmbledhjen Ekzekutive.

Si rezultat i aktiviteteve te shtuara dhe veprimeve te ndërmarra per lirimin e aseteve te uzurpuara dhe aktiviteteve te shtuara ne kontekst te administrimit te Aseteve, ka pasur ngritje të jashtëzakonshme në inkasimi i qirave në llogaritë bankare të Ndermarrjeve shoqërore ne tranzicion dhe likuidim në raport me periudhën e njejtë periudhë të vitit te kaluar 2014.

Trajtimi i Ndërtimeve Ilegale:

Gjate kësaj periudhe tek Komisioni për Ndërtime Ilegale janë dërguar :

Zyrja Rajonale	Nr.
Zyra Rajonale në Gjilan	48
Zyra Rajonale në Prishtinë	69
Zyra Rajonale në Mitrovicë	32
Zyra Rajonale në Prizren	37
Zyra Rajonale në Pejë	28
Gjithsej	**214**

Përcaktimi Statusit të NSh-ve

Gjatë këtij viti janë procesuar format e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit (SDR) për Asetet e NSh-ve me seli jashtë Kosovës të ciltat janë identifikuar gjatë vitit 2015, për shqyrtim nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Përcaktimin e Statusit të NSh-ve.

Qiradhënia e Pronave te NSh-ve në Likuidim

Zyret rajonale kanë përgatit me kërkesë dhe aprovim nga kryesuesit e AL-ve dhe menaxhmentit, listën për qiradhënie të pronave te NSH-ve në Likuidimdhe janë bërë shpalljet për qiradhënje më 25 prill 2015, 16 maj 2015, 25 korrik 2015, 05 shtator 2015, 08 tetor 2015 si dhe shpallja e fundit me 01 dhjetor 2015.

Punë të Tjera

Iniciativa me Drejtoratin e Arkivave ndërkomunale dhe Inspeksion për rregullimin e arkivave sipas ligjit për Arkivat, ku janë bërë vizitat në të gjitha zyret rajonale rreth mbrojtjes, evidentimit, mënyrës së klasifikimit dhe arkivimit të dokumentacionit të bartur nga arkivat e NSh-ve në arkivin e Ndërmarrjeve në Likuidim.

Është vazhduar puna me përgatitjen e vendimeve të lëshuara nga AL, regjistrimin e kërkesave të reja ne databazë, verifikimin e të gjitha kërkesave të regjistruara në databazë, skanimet e tyre, rregullimet e arkivave si dhe insertimin e dokumentet në databazë.

Zyret rajonale kanë pasur vazhdimisht takime të ndryshme me menaxhmente të NSH-ve, zyrtar të lartë komunal, palë të ndryshme, vizita në teren po ashtu zyrtaret ligjor kanë marr pjesë në përfaqësime në gjykata, ushtrimin e padive, ushtrimin e ankesave, ushtrimin e përgjigjeve në ankesa, ushtrimin e përgjigje në padi dhe të parashtresave tjera drejtuar gjykatave,etj.

5.8. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT

Departamenti i Financave dhe Buxhetit ofron shërbime financiare për Agjencinë: Divizionin e Shitjes, Divizionin e Likuidimit, degën Ekzekutive, Zyret Rajonale dhe Departamentet/Njësitë përkatëse të Agjencisë.

Departamenti i Financave dhe Buxhetit kontribuon duke ofruar përkrahje profesionale në zbatimin e procedurave të mirëfillta financiare, operimin e duhur të sistemeve financiare dhe praktikave më të mira sipas standardeve vendore dhe ndërkombëtare.

Departamenti i Financave dhe Buxhetit në kuadër të Agjencisë mbulon dy aktivitete të menaxhimit financiar:

1. Buxhetin për: aktivitetet administrative dhe operative të Agjencisë dhe aktivitete të tjera nën administrim të saj; dhe
2. Buxhetin për - Fondet në mirëbesim të Ndërmarrjeve Shoqërore.

1. AKTIVITETET NGA BUXHETI I AGJENCISË KOSOVËS

1.1 PASQYRAT FINANCIARE

- Pasqyrat financiare e të Hyrave të Dedikuara, Grandit të Përgjithshëm Qeveritar dhe Grandet të Donatorëve për vitin fiskal 2015 janë përgatitur dhe janë dorëzuar me 29 Janar 2016 në Ministrinë e Financave.

1.2 BUXHETI

Burim kryesor i financimit për aktivitetet e Agjencisë për vitin 2015 janë të **Hyrat e Dedikuara**[14] dhe **Fondi i Përgjithshëm Qeveritar**[15]. Agjencia gjatë kësaj periudhe nuk ka përfituar financime nga Grantet e Donatorëve apo pagesa që janë realizuar nga palët e treta në të mirë të Agjencisë.

Departamenti i Financave dhe Buxhetit gjatë kësaj periudhe sa i përket buxhetit ka përshirë aktivitetet e mëposhtme:

- Monitorimi i përformancës së buxhetit 2015;
- Korniza afatmesme e shpenzimeve 2016 - 2018; dhe
- Përgatitja e buxhetit për vitin 2016.

1.2.1. Përformanca e Buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2015

Përformanca e buxhetit[16] gjatë periudhës raportuese ka përshirë monitorimin dhe implementimin e buxhetit të Agjencisë si dhe aktivitetet e kërkesave për kursime, transfere dhe nevoja shtesë për programet buxhetore gjatë procesit të rishikimit gjysmë vjetor.

[14] Shih nenin 21 të ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit si dhe nenin 64 të ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë.

[15] Fondi i përgjithshëm Qeveritar apo Granti Qeveritar janë burim i financimit për të mbuluar aktivitetet që nuk ndërlidhen në mënyrë direkte për Agjencinë, por janë për mbulimin e shpenzimeve që Agjencia administron e që kanë të bëjnë me riorganizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore e në këtë rast është vetëm Riorganizimi i NSh Trepça. Fondi i përgjithshëm qeveritar është fondi kryesor i Republikës së Kosovës për financimin e buxheteve të organizatave buxhetore.

	A	C	C/A
Përshkrimi	**Buxheti më 31 Dhjetor 2015**	**Shpenzimet**	**Realizimi në %**
Gjithsej	**6,822,356**	**5,970,268**	**87.51%**
Te hyrat e dedikuara	6,811,383	5,959,695	87.50%
Te hyrat Qeveritare	10,973	10,573	96.35%

Buxheti gjatë vitit fiskal 2015 është shkurtuar vetëm tek Granti Qeveritar në shumën prej EUR 3,389,027 dhe atë:

- shumën prej EUR 1,553,487 përmes procesit të rishikimit gjysmëvjetor të Buxhetit; dhe
- shumën prej EUR 1,835,540 përmes vendimit nr. 09/65 të Qeverisë më datën 23 Dhjetor 2015.

Kërkesa e AKP-së dhe buxheti i aprovuar për paga dhe mëditje për vitin 2015

Në ligjin e aprovuar të Buxhetit për vitin 2015 numri i stafit prej 258 është aprovuar ndërsa shuma e fondeve të kërkuara, gjegjësisht buxheti i kërkuar prej EUR 4,273,837 për paga dhe mëditje për shkak të disa gabimeve teknike nga ana e Ministrisë së Financave (MF) nuk është aprovuar në tërësi.

Buxheti i aprovuar për këtë kategori është EUR 3,886,391.00 dhe ky buxhet, siç e kemi njoftuar edhe MF nuk mjafton të realizohen pagat për të gjithë numrin e stafit të planifikuar dhe aprovuar të AKP-së deri në fund të vitit fiskal 2015.

Rishikimi i buxhetit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për vitin 2015 (LIGJI Nr. 05/L -046)

Duke iu referuar kërkesës së Ministrisë së Financave lidhur rishikimin e buxhetit për vitin 2015, AKP ka analizuar buxhetin, shpenzimet, kursimet si dhe nevojat shtesë.

Me miratimin e ligjit të Rishikimit nga Qeveria, kërkesa e AKP-së për transfer të mjeteve në kategorinë e pagave nuk është aprovuar. Gjithashtu edhe kërkesa për mjete shtesë prej 5,000,000€ për financimin e Autoritetit të Likuidimit nga Grandi Qeveritar nuk është aprovuar. Nga MF është aprovuar vetëm transferi i shumës prej 10,000€ në kategorinë ekonomike të subvencioneve.

Qeveria e Kosovës gjatë procesit të rishikimit të buxhetit ka reduktuar buxhetin për planin e riorganizimit të Trepçës i cili financohet nga Granti i Përgjithshëm Qeveritar në shumë prej EUR 1,553,487.00.

Mos aprovimi i kërkesës për buxhetin shtesë prej 5,000,000€ për financimin e Autoritetit të Likuidimit nga Granti Qeveritar nuk i përmbushë të priturat dhe kërkesat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP).

[16] Përformanca e buxhetit 2015 përfshinë aktivitetet e shumta sa i përket planifikimit, monitorimit dhe implementimin të buxhetit, vlerësimeve në fillim të vitit si dhe rishikimin e buxhetit gjysmë vjetor. Ngjarjet bazohen në Qarkoret buxhetore, Ligjin e buxhetit (LIGJI Nr. 05-L-001) Ligjin e rishikimit gjysmë vjetor (LIGJI Nr. 05/L -046) 2015 dhe Qarkoren e parë dhe të dytë buxhetore për vitin 2016.

Transferi i mjeteve të kursyera në kategorinë Paga dhe Mëditje

Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 23 Nëntor 2015 ka marrë Vendim (Nr. 04/60) dhe ka aprovuar transferin e shumës së kërkuar prej 481,311€ në kategorinë e Pagave. Raporti I ndërrimeve në buxhet është prezantuar në pasqyrat financiare.

Vendimi i Qeveris Nr. 09/65 i datës 23 Dhjetor 2015 lidhur me Kursimet në ndarjet buxhetore për vitin 2015

Qeveria e Republikës së Kosovës me datën 23 Dhjetor 2015 ka marrë Vendim për kursimin e mjeteve buxhetore nga Granti Qeveritar në kategorinë Mallra dhe Shërbime, ku në bazë të këtij Vendimi është reduktuar edhe buxheti i AKP-së i cili financohet nga Grantit Qeveritar në shumë prej EUR 1,835,540

1.2.2 Korniza afatmesme e shpenzimeve

Sipas kërkesës së Ministrisë së Financave lidhur përgatitjen e Kornizës Afat-Mesme të Shpenzimeve (KASH), AKP me datën 10 Prill 2015 ka përgatitur dhe dorëzuar në MF përmbledhjen e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të AKP-së për vitet 2016-2018 si më poshtë:

KASH	2016	2017	2018
Gjithsej	11,077,449	7,083,249	6,884,249
Te hyrat e dedikuara	7,677,449	7,063,249	6,864,249
Te hyrat Qeveritare	3,400,000	20,000	20,000

1.3 PROCESIMI i PAGESAVE

- Procesimi i 2,877 transaksioneve (1,385 zotime dhe 1,502 pagesa) nga buxhetit vjetor i Kosovës e cila financohet nga të hyrave të dedikuara të Agjencisë dhe fondit të përgjithshëm të Qeverisë (për Trepçën).

1.4 RAPORTIMET

- Harmonizimi i raporteve dhe raportimi në baza mujore i raporteve financiare për pasqyrat financiare 2015 ndaj;
  - Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave;
  - Menaxhmentit dhe mbajtësve të Buxhetit;
  - Publikimi i raporteve në ueb faqen zyrtare të Agjencisë në gjuhën shqip, serbisht dhe anglisht;
- Raportimet mujore në Ministrinë e Financave për faturat e papaguara;
- Raporti i blerjeve mbi EUR 500.00 për vitin 2015 ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.

1.5 AKTIVITETET TJERA

- Harmonizimi mujor i listës së pagave për periudhën Janar – Dhjetor 2015 me Ministrinë e Administratës Publike;
- Inkasimet ditore për telefoninë fikse dhe mobile. Këto inkasime janë për shpenzimet që kanë tejkaluar limitet të cilat i mbulon Agjencia sipas politikave për telefoni fikse dhe mobile. Vlen të theksohet se pas propozimit nga Departamenti i Financave dhe Buxhetit është marrë vendim nga Menaxhmenti për ndalesë në 50% të pagës bruto për obligimet e papaguara deri në periudhën 30 Qershor 2015;
- Është mbajtur trajnimi për pesë punonjës të Departamentit të Financave dhe Buxhetit në trajnimin e organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës "Vlerësues i Pronave të Paluajtshme";

1.6 PASURITË

Pasuritë e Agjencisë të blera nga fondet e buxhetit dhe pasuritë e dhëna donacion janë mbajtur në përputhje me Rregulloren nr. 02/2013 të Ministrisë së Financave. Detaje lidhur me pasuritë janë shpalosur në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese.

1.7 AUDITIMET

- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dorëzuar raportin e auditorit për Pasqyrat financiare vjetore të vitit 2014 për buxhetin vjetor. ZAP-i ka dhënë opinion të modifikuar lidhur me çështjen e pagesave për Autoritetin e likuidimit. Agjencia ka paraqitur me shkrim ZAP-it argumentet dhe mospajtimet lidhur me këtë opinion.
- Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dorëzuar raportin e auditorit për Pasqyrat financiare nëntëmujore Janar – Shtator 2015 për buxhetin vjetor. ZAP-i ka dhënë rekomandimet me në Memorandumin e Auditimit. Agjencia ka paraqitur me shkrim ZAP-it argumentet dhe mospajtimet lidhur me këtë opinion.Njësia e Auditimit të Brendshëm të AKP-së (NJAB) ka përfunduar auditimin e Departamentit të Financave dhe Buxhetit për periudhën Janar 2013 – 31 Maj 2015. Raporti Final është dorëzuar, përderisa është përpiluar Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së.

2. FONDET NË MIRËBESIM

2.1 PASQYRAT FINANCIARE

- Pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim për vitin fiskal 2015 janë përgatitur dhe janë dorëzuar më 29 Janar 2016 në Sekretariatin e Bordit të Drejtorëve dhe më 29 Janar 2016 janë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

2.2 BUXHETI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE I CILI FINANCOHET NGA FONDET NË MIRËBESIM

Buxhet për Fondet në mirëbesim është për ndërmarrjet shoqërore të cilat hyjnë në likuidim. Janë gjithsej 462 Ndërmarrje Shoqërore të cilat kanë hyrë në likuidim. Buxheti përfshinë periudhën që nga hyrja e Ndërmarrjes në likuidim e deri në përfundim të saj.

Përgatitja e buxhetit të fondeve në mirëbesim për NSh-të në likuidim është jashtë kompetencave të Departamentit të Financave dhe Buxhetit, por që ka filluar të jetë pjesë e procesit të monitorimit dhe kontrollit që nga mbledhja e muajit Gusht 2014 të bordit të drejtorëve, kjo sipas kërkesave të ZDM – Likuidimi në mënyrë që të rritet cilësia, plotësia dhe zvogëlimi i rrezikut të tejkalimit të buxhetit;

Buxheti i NSh-ve i shpenzuar deri më 31 Dhjetor 2015

Buxheti	GJITHSEJ SHPENZIMET	Buxheti i mbetur	% e shpenzimeve
13,350,546	5,232,498	8,117,962	32.19

2.3 PROCESIMI I PAGESAVE

- Procesimi i 12,598 transakcioneve dalëse të fondeve në mirëbesim në BQK dhe harmonizimi i 22,004 transaksioneve (hyrëse dhe dalëse) nga fondet në mirëbesim.

2.4 RAPORTIMET

- Harmonizimi me Bankën Qendrore të Kosovës dhe raportimet në baza mujore të raporteve për pasqyrat financiare për Fondet në Mirëbesim ndaj:
  - Menaxhmentit dhe Drejtorëve;
  - Zyrave Rajonale dhe Autoritetit të Likuidimit - Raporteve Përmbledhëse të Llogarive të Likuidimit dhe Kartelave bankare. Raportimi në baza mujore përfshinë periudhën Janar deri më 31 Dhjetor 2015. Raportet janë paraqitur dhe në uebfaqen e AKP-së (në gjuhët shqipe, sërbe dhe angleze); dhe
  - pPublikimi i raporteve në ëeb faqen zyrtare të Agjencisë në gjuhët: shqipe, sërbe dhe angleze.

2.5 INVESTIMET E FONDEVE NË MIRËBESIM

Sa i përket investimeve të fondeve në mirëbesim, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e orientuar në tregun e investimeve afatshkurtra siç janë depozitat deri në dymbëdhjetë muaj (12) në Bankën Qendrore të dhe bankat komerciale të Kosovës si dhe në letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës (bonot e thesarit).

Ministria e Financave më datën 7 Shtator 2015 ka themeluar komisionin për projekt ligjin për plotësim dhe ndryshimin e ligjit 04-L/034 mbi AKP-në. Pjesë e diskutimit të këtij komisioni është edhe zgjerimi i kornizës ligjore (shtesë neni 19A) mbi Agjencinë rreth investimeve të fondeve në mirëbesim. Përveç afatizimeve të sipër shënuara. Shkurtimisht, po i paraqesim propozimet e Komisionit:

- Afatizimi i mjeteve në bankat komerciale edhe jashtë Kosovës;
- Letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga Qeveria e Kosovës apo shtet tjetër sovran;
- Letra me vlerë të borxhit të emetuara nga ndonjë Korporatë me seli në SHBA apo të ndonjë shteti të Bashkimit Evropian;
- Fonde të tregtuara në berzë (Exchange Traded Funds), ose fonde të përbashkëta (Mutual Funds); dhe
- Marrëveshje të ri-blerjes që kanë për bazë letra me vlerë të përcaktuara sipas pikave të sipër shënuara.

2.5.1 Afatizimi i mjeteve në depozita kohore

Gjatë vitit 2015, interesi i fituar është prej EUR 5,000 nga afatizimi i mëposhtëm:

1. Një depozit në afat dymbëdhjetëmujor, gjithsej në shumën totale prej 5,000,000.00 që ka maturuar më 5 Korrik 2015.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2015. Agjencia nuk ka qenë aktive në këtë treg, për shkak të normave tepër të ulta të interesit. Në disa raste norma e interesit ka qenë negative si p.sh. me MINUS 20%.

2.5.2 Investimi në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Kosovës (bonot e Thesarit)

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e datës 21 Qershor 2012 ka marrë vendim që Menaxhmentit t'i lejohet diskutimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Ministrinë e Financave dhe Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Qëllimi i Marëveshjes së Mirëkuptimit do të mundësonte investimin e fondeve në mirëbesim në tregun primar dhe tregtimi i tyre në tregun sekondar të letrave me vlerë të emetuara nga Qeveria.

Deri më tani nuk bërë ende ndonjë investim ose pjesëmarrje në ofertat e letrave me vlerë të Qeverisë, për shkak se, nuk është përfunduar me sukses përpjekja e Agjencisë për këto investime për arsyet të cilat nuk janë të njohura për Agjencinë.

2.6 DETAJE TJERA LIDHUR ME AKTIVITETET FINANCIARE TË AGJENCISË

Detaje tjera lidhur me aktivitetet financiare të Agjencisë janë shpalosur në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Buxhetit Vjetor dhe në tabelat financiare dhe shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim.

5.9. DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor (tutje DL) ofron shërbime ligjore për aktivitetet e Agjencisë përfshirë privatizimin, likuidimin, prokurimin dhe rastet specifike të Trepçës.

Departamenti është ndarë në njësi punuese të organizimit, ndarjes së punëve dhe përgjegjësive me qëllim të realizimit në mënyrë efikase dhe efektive në tërësi të objektivave dhe përgjegjësive të Departamentit Ligjor dhe të cilat janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e përgjithshme të AKP-së.

Në vijim janë sqaruar aktivitetet bazuar në sipas njësive në Departamentin Ligjor:

1. Njësia për Përfaqësime në Gjykatë(NjPGj).
2. Njësia për Opinione Ligjore(NjOL).
3. Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA).
4. Sekretariati i KSHALP-së: Për shqyrtimin e ankesave për 20 %.
5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KShALP).

Departamenti Ligjor shërben si ombrellë për Komisionin Shqyrtues për Ankesat e Listave të Punëtorëve (KShALP), megjithëse ky komision vepron në mënyrë autonome dhe i raporton vetëm Bordit të Drejtorëve të Agjencisë.

1. Njësia për Përfaqësime në Gjykatë (NjPGj)

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor janë pranuar gjithsej 522 lëndë ndërsa për veprimet procedurale në lëndë për periudhën në fjalë janë ndërmarr këto veprime:

- 366 Mbrojtje në padi, 89 Kundërpërgjigje, 10 Përgjigje në masë të përkohshme24, Ankesa, 46 Përgjigje në ankesa, 41 Parashtresa, 11 Përgjigje në përgjigje të ankesave, 90 Seanca Gjyqësore dhe 43 Përgjigje në urdhër.

Sa i përket çështjeve lidhur me listat e punëtorëve të NSH-ve, gjatë periudhës Janar – Dhjetor janë pranuar gjithsej 559 lëndë kurse veprimet e ndërmarra në lëndë për këtë periudhë janë si më poshtë:

- 65 Përgjigje në Urdhra,1 Pjesëmarrje në seancë gjyqësore,185 Aktgjykime, 58 Aktvendime, 183 Përgjigje në ankesa dhe 78 Parashtresa.

2. Njësia për Opinione Ligjore (NjOL)

Gjatë kësaj periudhe raportuese NJOL ka kontribuar në përformancën e Agjencisë duke dhënë afërsisht 31 opinione ligjor sipas 'Kërkesave për Veprim' të njësive dhe departamenteve por edhe Menaxhmentit të Agjencisë.

Krahas opinioneve ligjore, sipas nevojës NJOL ka hartuar apo ka marrë pjesë në hartimin, shqyrtimi apo analizimin e mëse 40 dokumenteve të ndryshme, si rregullore të brendshme, vendime, kontrata, letër-përgjigje, kërkesa, etj.

3. Njësia për Regjistrimin e Ankesave (NjRA)

Gjatë periudhës një vjeqare 1 janar- 31 dhjetor 2015 Njësia për ankesa e Departamentit Ligjor ka regjistruar dhe proceduar rreth 811 kërkesa /lëndë të reja dhe 2.262 dokumente/ parashtresa shtesë lidhur me lëndët e regjistruara me herët; gjithsejtë janë pranuar **3.073** parashtresa.

4.Sekretariati i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në Listat e Punëtorëve (KSHALP) për 20%

Për këtë periudhë, Sekretariati i KSHALP-së ka punuar rreth shqyrtimit të ankesave të pasafatshme për ndërmarrjet e poshtë shënuara:

• NSH " IBG –Bateria " në Gjilan
• NSH " Bankkos " në Prishtinë.
• NSH " Ratko Mitrovic - Kulla" në Prishtinë.
• NSH " Vreshtaria "- Landovicë - Prizren
• NSH " Prizren Market " në Prizren.
• NSH "Qumështorja Konsume" Fushë Kosovë/ZR Prishtinë
• NSH "Liria" Prizren/ZR Prishtinë
• NSH "28 Nëntori" - Gjilan
• NSH "Mekanizimi" Prishtinë/ZR Prishtinë
• NSH "Rilindja" në Prishtinë/ZR Prishtinë
• NSh "Industria Ushqimore' në Prizren/Prizren
• NSH "Ramiz Sadiku" Prishtinë/ ZR Prishtinë
• NSH ''Komuna – Prizren/ZR Prizren;
• NSH ''Ramiz Sadiku " – Prizren/ZR Prizren.

5. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve (KShALP) për 20%

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të punëtorëve (KSHALP) është themeluar me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë në Muajin shtator 2011, në përputhje me nenin 10, pika 10.4 të Politikave Operuese dhe është organ i pavarur, i brendshëm për shqyrtim administrativ të ankesave në listat e punëtorëve për 20%-in. Përderisa për vendimet e veta Komisioni i raporton Bordit të Drejtorëve, në anën operacionale është njësi organizative e Departamentit Ligjor. KSHALP asistohet nga Sekretariati e cila është poashtu njësi e Departamentit Ligjor dhe është përgjegjëse për mbështetjet të KSHALP-së në ofrimin e asistencës së nevojshme në bashkëpunim dhe sipas udhëzimeve të Kryesuesit të KSHALP-së.

Gjatë periudhës raportuese, KSHALP ka qenë i angazhuar kryesisht në takimet me palë për sqarim për mospërfshirjen e tyre në listat finale lidhur me 20%.

5.10. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i Administratës ka për detyrë të ofroj kushte sa më të mira njerëzore, infrastrukturore dhe logjistike për arritjen e objektivave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në kuadër të Departamentit të Administratës bëjnë pjesë këto njësi: Njësia e Burimeve Njerëzore, Njësia e Përkthimeve, Njësia e Protokollit, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Arkivit, Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme dhe Zyra e Transportit.

NJËSIA E BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë periudhës raportuese në Njësinë e Burimeve Njerëzore janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

Pagat:

- Është bërë azhurnimi dhe konfirmimi, si dhe janë dërguar për ekzekutim në baza mujore Listat e Pagave (Payrollit) për muajt: janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhejtor 2015.

Personeli:

- Është finalizuar Procesi i Rekrutimit dhe Selektimit për 6 (gjashtë) pozita të lira:
    - Zyrtar për Likuidim ZR Pejë, ZR Mitrovicë dhe ZR Gjilan;
    - Zyrtar Ligjor ZR Pejë;
- Është finalizuar Procesi i Rekrutimit dhe Selektimit për 4 (katër) pozita zëvendësuese:
    - Vozitës;
- Ka dhënë dorëheqje 1 (një) punonjës;
- 4 (katër) punonjës në pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës;
- 1 (një) rast i shkëputjes së marrëdhënies së punës me rastin e pensionimit sipas moshës (65 vjet);
- Me rastin e hetimeve të disa zyrtarëve të AKP-së, janë përgatitur vendimet për pezullim parandalues për 4 (katër) zyrtarë të AKP-së.
- Me rastin e emërimeve funksionar publik, kanë pezulluar marrëdhënien e tyre të punës 3 (tre) zyrtarë të AKP-së;
- Pas mbarimit të periudhës së pezullimit të dakorduar, janë kthyer në punë në pozita ekuivalente 2 (dy) zyrtare të AKP-së;
- Me Vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (A 02/211/2015 dhe A 02/173/2015) dhe Gjykatave relevante, i është ndërprerë marrëdhënia e punës 3 (tre) Zyrtarëve të Likuidimit dhe 1 (një) Zyrtari Ligjor në ZR Pejë;
- 1 (një) zyrtari të Agjencisë i është aprovuar kërkesa për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës;
- Janë avancuar me vendim të Menaxhmentit 8 (tetë) Asistentë Administrativë në pozitën Zyrtarë Administrativë;
- Me aprovim të Komisionit relevant mjekësor pranë Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, 1 (një) zyrtares së Agjencisë i është aprovuar pushimi mjekësor me pagesë;

- Janë përgatitur pesëdhjetë e dy (52) Akte të Reja të Emërimit për zyrtarët në pozitën Zyrtar i Operacioneve për Administrim të Aseteve /Departamenti i Koordinimit Rajonal.

Zhvillimi i stafit:

- Në bazë të Planeve Individuale të Zhvillimit të punonjësve, është përgatitur Plani Vjetor i Agjencisë për Trajnim dhe Zhvillim të punonjësve për vitin kalendarik 2015;
- Është koordinuar pjesëmarrja në Trajnimet e mëposhtme:
    - Programi Certifikues "Vlerësues i Pronave" për 40 zyrtar të AKP-së;
    - Trajnimi SCAAK për 3 zyrtarë të AKP-së;
    - Trajnimi Motion Graphics për 1 (një) Zyrtar për Ëeb Design ;
    - Trajnimin "Digital Marketing – Search Marketing" për 1 (një) zyrtar të AKP-së;
    - Trajnimi Executive Assistant Masterclass për dy (2) zyrtar të AKP-së;
    - Trajnimi për Provim të Jurisprudencës) për katër (4) zyrtar të AKP-së;
    - Trajnim për CISCO për një (1) zyrtar të AKP-së;
    - Trajnimi për TOEFL për 2 (dy) zyrtarë të AKP-së;
    - Trajnimi ri-licencues për Vlerësues të Pronave për 1 (një) zyrtar të AKP-së;
    - Trajnimi "Business English" për 3 (tre) zyrtarë të AKP-së;

Procesi i Menaxhimit të Performancës:

- Ka përfunduar mbledhja e vlerësimeve të performancës për vitin 2014, planet individuale të punës si dhe Planet Individuale të Zhvillimit për vitin 2015 të punonjësve (përpilimi i Udhëzuesit Intern të Agjencisë mbi Menaxhimin e Performancës, modifikimi i formularëve relevant, informimi/ këshillimi dhe pajisja e punonjësve me të njëjtat, kolektimi, selektimi, popullimi i bazës së të dhënave, kalkulimi i mesatares në baza individuale si dhe përgatitja e raportit vjetor);
- Në proces menaxhimi i Vlerësimit të Performancës së zyrtarëve të AKP-së për vitin 2015 dhe Planet individuale të punës si dhe Planet Individuale të Zhvillimit për vitin 2016 të punonjësve;

Raportimet:

- Është përpiluar dhe dërguar në DASHC/ MAP, pyetësori për të dhënat në shërbimin civil të AKP-së për vitin 2014;
- Është përgatitur pyetësori vetë-vlerësues për MFK;
- Është ripërpiluar raporti mbi Planin e Personelit të AKP-së për vitin 2015 sipas Formularit të azhurnuar sipas kërkesës së MAP-it dhe i njëjti është ri dërguar në DASHC/MAP;
- Përgatitja e raportit për finalizimin e procesit 3 vjeçar lidhur me Kualifikimin Akademik të punonjësve të Agjencisë;
- Përgatitja dhe dërgimi i listës së Zyrtarëve të Lartë të AKP-së për deklarim të pasurisë në Agjencinë kundër Korrupsion;
- Është dorëzuar Raporti preliminar mbi Procesin e Vlerësimit të Performancës në Punë për periudhën Janar – Dhjetor 2014;
- Janë dërguar në KPMSHC, komentet në Raportin e KPMSHC gjatë vizitës së tyre në shtator 2014;
- Është finalizuar dhe dërguar në Ministrinë e Administratës Publike përvoja e punës për stafin e AKP-së;
- Janë plotësuar 2 (dy) pyetësor të kërkuara nga Komisioneri i Gjuhëve;

- Është përpiluar dhe dërguar në Ministri për Administratë Publike raporti mbi Planin e Personelit të AKP-së për vitin 2016;
- Përgatitja e Raporteve të rregullta në baza javore dhe mujore mbi aktivitetet e Njësisë së BNJ;

Çështje të tjera:

- Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka shqyrtuar dhe ka marr vendim për **34 (tridhjetekatër)** ankesa ;
- Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar dhe ka marr vendim për **5 (pesë)** raste;
- Komisioni për Rishikim të pagës ka shqyrtuar dhe ri-shqyrtuar **35 (tridhjetëepesë)** kërkesa të zyrtarëve të AKP-së;
- Komisioni Disiplinor në proces të shqyrtimit të 1 (një) rasti (KD 02/2015);
- Janë shqyrtuar dhe finalizuar azhurnimet e një numri të madh të Përshkrimeve të Punës ;
    - Sekretaria Ekzekutive e Bordit të Drejtorëve;
    - Njësia për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë;
    - Departamenti i Koordinimit të Likuidimit;
    - Njësia e Teknologjisë Informative;
    - Departamenti i Administratës;
    - Departamenti Ligjor;
    - Njësia për Menaxhimin e Projektit të Likuidimit;
- Në bashkëpunim me zyrën e ZDM likuidimi, është draftuar Katalogu i Punës për pozitat aktuale në AKP;
- Janë shqyrtuar dhe finalizuar azhurnimet e Përshkrimeve të Punës për:
    - Zyrtar i Lartë për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë/ Njësia për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë;
    - Zyrtar Kadastral (regjione)/ Departamenti i Shitjes;
    - Drejtor i Departamentit Ligjor/ Departamenti Ligjor;
    - Kryesues i Njësisë për Përfaqësime Ligjore/ Departamenti Ligjor;
    - 8 (tetë) Përshkrime të Punës për pozitën Zyrtar Administrativ;
    - Zyrtar i Operacioneve për Administrim të Aseteve/Departamenti i Koordinimit Rajonal;
    - Drejtor i Departamentit për Koordinim Rajonal/ Departamenti i Koordinimit Rajonal;

- Janë përgatitur Deklaratat nën betim si dhe Vendimet përkatëse për 258 punëtorë të AKP-së për përvojë pune (mbledhja e të gjitha dëshmive për përvojë pune në dosje fizike të zyrtarëve dhe bashkëngjitja në Deklaratën nën betim) dhe për të njëjtat është njoftuar Ministria e Administratës Publike.

NJËSITË TJERA TË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS

Aktivitetet kryesore për këtë periudhë të raportimit paraqiten për njësitë: **Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme, Njësia e Arkivit, Njësia e Përkthimeve, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Protokollit dhe Zyra e Transportit.**

Njësia e Përkthimeve:

- Njësia e Përkthimeve ka përkthyer **439 dokumente** me **4,183 faqe** dhe ka siguruar përkthyesit për **14 takime**.

Njësia e Protokollit:

Gjate kësaj periudhe janë pranuar procesuar:

- dokumente hyrëse në këtë zyre 4157 shkresa;
- shkresa dalëse nga kjo zyre janë regjistruar 3411;
- Të regjistruara në sistem hyrje/dalje janë 7568;
- Pranimi me Postë 822;
- Dërgimi me Postë 1361;
- Dërgimi me Libër Personal brenda AKP-së 4157;
- Dërgimi me Libër jashtë AKP-së 252;

Njësia e Teknologjisë Informative:

- Si veçanti e kësaj periudhe është migrimi total i upgrade të PC që kanë qenë në sistem të vjetër ËINDOËS XP, i cili në tërësi ka përfunduar në muajin Mars;
- Vendosja e masave parandaluese për mbrojtjen nga programet e shkarkuara nga interneti si dhe Vendosja e dokumentimit fizik të kontrollit; javor për:
- *funksionimin e replikimit;*
- *update të antivirusit;*
- *funksionalitetit të e-mail serverit*
- *kontrollit të blacklistës; dhe*
- *GSM testimit të Alarmit në Server Room dhe recovery center*
- Për te minimizuar rrezikun nga viruset dhe prishjes së disqeve nga puna e pandërprerë, kompjuterët janë programuar te ndalen pas orarit te punës. Ndalja e kompjuterëve pas orarit të punës po tregohet shumë e suksesshme në përmirësimin e punës së kompjuterëve dhe aplikimit të updata-ve. Përveç minimizimit të rrezikut nga sulmet e jashtme dhe prishjet eventuale , është konstatuar **kursim i konsiderueshëm i energjisë elektrike** (të dhënat nga fakturat e rrymës);
- Procedurat e tenderit janë iniciuar me sukses dhe është përmbush plani vjetor i lidhur me blerjen e shërbimeve apo pajisjeve të TI-së;
- Është arritur një marrëveshje në mes të BQK-së dhe AKP-së mbi ruajtjen e dokumentacionit elektronik të AKP në kuadër të marrëveshjeve kornizë që ka BQK-ja në ruajtjen e aseteve të klientëve;
- Përplilimi i rregullores së re të TI-së;
- Është inicuar procedurat standarde për shërbime të Internetit dhe Rrjetit;

- Është inicuar procudura për certifikatën e e-mail sistemit (pasi skadon me 27 janar 2016)

Njësia e Arkivit:

- Regjistratorë të skanuar, regjistruar dhe arkivuar për Departamentet dhe Njësitë e AKP-së, gjithsejtë 338 regjistratorë;
- Skanimi dhe arkivimi i Librave të Protokollit të Departamenteve, Njësive, Regjioneve të AKP-së, gjithsej 14 libra Protokolli dhe 14 Libra të Postës;
- Ofrim i ekzaminimit te dokumentacionit arkivor, Departamenteve/Njësive/Regjioneve të AKP-së, si dhe kërkesa nga pala e jashtme, gjithsej 17 kerkesa;

Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme:

- Gjatë kësaj periudhe nëntëmujore kemi asistuar në dëbimin e uzurpatorëve të pronave shoqërore në rajonin e Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Gjilanit dhe Prishtinës, në gjithsej 98 njësi aty ku është shfaqur nevoja;
- Kemi bërë të gjitha riparimet e kërkuara, si në Zyrën Qendrore po ashtu edhe në Zyrat Rajonale të AKP-së, që në total janë 326 riparime;
- Janë protokolluar 393 fatura, të cilat janë përcjellë në Departamentin e Financave, prej tyre janë futur në freebalance 348 fatura, si dhe janë nënshkruar 212 urdhërblerje ;
- Kemi mbuluar 561 kërkesa për furnizim me material administrativ;
- Gjatë muajve Prill dhe Maj kemi implementuar projektin e vendosjes se shenjave emergjente në tërë zyrat e AKP-së bazuar në Ligjin për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe mbushja dhe vendosja në mënyrë profesionale e aparateve kundër zjarrit;
- Kemi iniciuar kërkesën për kontraktimin e një kompanie për mirëmbajtjen dhe servisimin e Air Kondicionerëve, ku pas përfundimit të procedurave nga Prokurimi, kemi bërë servisimin e të gjithë air kondicionerëve që kanë pasur nevojë;
- Në momentin e raportimit, jemi në proces të kontraktimit të një kompanie për servisimin dhe mirëmbajtjen e ngrohjeve qendrore dhe gjeneratorëve nëpër objektet e AKP-së;
- Gjatë kësaj përiudhe raprtuese kemi iniciuar dhe realizuar projektin për vendosjen e kamerave të sigurisë që nga data 14 Dhjetor 2015 32 kamera mbulojnë tërë hapsiren brenda dhe jashtë objektit selinë qëndrore të AKP-së;

Zyra e Transportit:

- Gjate kësaj periudhe 9 mujore kemi pasur 2018 kërkesa për shërbime të rregullta dhe 1689 shërbime-kërkesa urgjente, të cilat janë mbuluar po ashtu;
- Janë nënshkruar kontratat për furnizimin me karburante për vetura, kontrata për sigurimin e veturave dhe është bërë kontrollimi dhe regjistrimi i të gjitha veturave qe i kemi;

- Është bërë çregjistrimi i 8 veturave për shkak te vjetërsisë së tyre dhe gjatë servisimit të disa veturave Clio kemi bërë ndërrimin e pjesëve duke i marr pjesët e këtyre veturave të cilat nuk do ti përdorim, me ç'rast janë kursyer dukshëm shpenzimet e mirëmbajtjes se tyre;
- Kanë filluar punën 4 vozitësit e rinj pas pezullimit te vozitësve tanë i cili pezullim parandalues vazhdon ende dhe nga data 15 Tetor 2015 pa pagesë deri në vendimin e gjykatës.

5.11. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Departamenti i Prokurimit gjatë periudhës raportuese ka nënshkruar 53 kontrata duke përdorur te gjitha procedurat e prokurimit: procedura te prokurimit me vlere te madhe, procedura e prokurimit me vlere te mesme, kuotimi me vlere te vogël dhe kuotimi me vlere minimale si dhe procedura e negociuar pa publikim e njoftimit për kontrate. Vlera e përgjithshme e kontratave është 1,153,772.82 €

Gjithsej janë 41 kontrata ne kategorinë e shërbimeve dhe 12 janë Furnizime.

Departamenti i Prokurimit gjatë periudhës raportuese ka nënshkruar 53 kontrata duke përdorur te gjitha procedurat e prokurimit: procedura te prokurimit me vlere te madhe, procedura e prokurimit me vlere te mesme, kuotimi me vlere te vogël dhe kuotimi me vlere minimale si dhe procedura e negociuar pa publikim e njoftimit për kontrate.

1. Kontratat me gazetën serbe"Danas"
2. Kontrata me gazetën malaziase "Vijesti"
3. Anex Kontrate:"Shërbimet e internetit dhe rrjetit te Teknologjisë Informative"
4. Shërbimet e internetit dhe rrjetit te Teknologjisë Informative
5. Anex kontrata "Furnizim me nafte për veturat e AKP-se"
6. Anex kontrata "Furnizim me nafte për gjeneratorë te AKP-se"
7. Vazhdimi i kontratës për objektin me qira ne Zyrën Satelitore ne Leposaviq
8. Ri tender- Furnizim me karburante për nevojat e AKP-se
9. Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve zyrtare te AKP-se
10. Shërbimet e shtypjes se materialeve promovuese
11. Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve
12. Emetimi i TV reklamave dhe shpalljeve
13. Prodhimi dhe shtypja e biznes kartelave
14. Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve nen garancion DACIA Sandero
15. Furnizim me nafte për ngrohje dhe gjeneratorë(procedure emergjente)
16. Furnizim me karburante për vetura(procedure emergjente)
17. Kontrata me Radio 21
18. Kontrata me Radio Dukagjini,
19. Kontrata me Radio Kosovën,
20. Kontrata me Institutin e medieve te Kosovës,
21. Kontrata me Radio Gracanica,
22. Kontrata me Radio Kontakt Plus-ne gjuhen serbe
23. Kontrata për Mirëmbajtjen e data bazës se Njësisë për Ankesa te Departamentit Ligjor
24. RI-Ri tender- Furnizim me derivate te naftës për ngrohje dhe gjeneratorë
25. Mjetet për zerim dhe përkthim simultant
26. Mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit dhe furnizim me shenja emergjente
27. Vazhdimi i kontratës për objektin me qira Zyra Shtërpcë
28. Mirëmbajtja dhe furnizimi me Air Kondicioner
29. Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative,
30. Furnizim me material Higjenik
31. Furnizim me Material Administrativ
32. Shërbimi i fotokopjimit dhe Printimit, Servisimi i pajisjeve te Teknologjisë Informative (TI)
33. Kontrate për shpallje ne gazetat ditore: Koha Ditore,

34. Kontrate për shpallje ne gazetat ditore: Zëri,
35. Kontrate për shpallje ne gazetat ditore: Epoka e Re,
36. Kontrate për shpallje ne gazetat ditore: Bota Sot,
37. Kontrate për shpallje ne gazetat ditore: Kosova Sot
38. Shërbimi për "Hosting" dhe "Domain Name" për dy faqet e internetit ëëë.pak-ks.org dhe ëëë.kta-kosovo.org
39. Servisimi dhe mirëmbajtja e Ngrohjeve Qendrore dhe Gjeneratorëve
40. Furnizim me shtypin ditor
41. Furnizim me pajisjet sanitare, elektrike dhe te punës
42. Kontrate me portalin Indeksonline,
43. Kontrate me portalin Express,
44. Kontrata me portalin A.L. Kosovapress,
45. Kontrata me portalin Lajmi,
46. Kontrata me portalin Gazeta Blic,
47. Kontrata me portalin gazeta Tribuna,
48. Kontrata me portalin Infokus,
49. Kontrata me portalin Orainfo,
50. Xhirimi dhe emetimi i drejtpërdrejtë i Ceremonisë se Dorëzimit dhe pranimit te Ofertave
51. Larja e veturave te AKP-se
52. Furnizim dhe montimi me kamera te sigurisë dhe pjese përcjellëse
53. Organizimi I ndejës se fundvitit pe stafin e AKP-se

5.12. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) me sukses ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2015, duke i ofruar menaxhmentit të lartë rekomandime konkrete. Raporti i përmbledhur paraqitet më poshtë:

1. **Auditimi i Njësisë për Marrëdhënie me Publikun dhe Medie (NJMPM):** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me punën e NJMPM-së, gjegjësisht nëse procesi i shqyrtimit të kërkesave nga palët e jashtme për qasje në dokumentet publike është bërë konform kërkesave ligjore. Ky auditim ka rezultuar me 8 rekomandime përkatëse.

2. **Auditimi i Departamentit të Administratës (DA):** Objektivat e këtij auditimi kryesisht ishin të lidhura me menaxhimin e proceseve, gjegjësisht shfrytëzimin e pajisjeve dhe mjeteve të AKP-së konform rregullativës ligjore, mbulimit të mjaftueshëm ligjor të çështjeve që lidhen me administrimin e proceseve në DA, planifikimin e aktiviteteve dhe detyrave, përkatësisht se puna e realizuar në këtë departament dhe njësitë e tij, është zhvilluar sipas një plani vjetor me objektiva të vendosura dhe të aprovuara nga Menaxhmenti. Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, ky auditim ka rezultuar me 12 rekomandime përkatëse.

3. **Auditimi i Departamentit Ligjor (DL)**: Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar kryesisht në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me Departamentin Ligjor. Ky auditim nuk ka rezultuar me ndonjë të gjetur konkrete, përveç disa konkluzioneve qe kemi dhënë në lidhje me procesin në përgjithësi. Si rezultat i kësaj, asnjë rekomandim nuk është adresuar, pasi që mostrat e përzgjedhura për testim nuk kanë rezultuar me ndonjë parregullsi materiale apo procedurale në DL.

4. **Auditimi i Departamentit të Financave (Menaxhimi i Fondeve në Mirëbesim):** Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me mënyrën e menaxhimit të Fondeve në Mirëbesim, gjegjësisht nëse këto fonde janë investuar duke respektuar rregullat e brendshme si dhe kornizën ligjore në fuqi. Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, auditimi i Departamentit të Financave dhe Buxhetit, përkatësisht menaxhimi i fondeve në mirëbesim, ka rezultuar me 12 rekomandime përkatëse.

5. **Auditimi i Departamentit të Koordinimit Rajonal (ZR e Pejës dhe ZR e Mitrovicës)**: Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me procesin e dhënies së objekteve (lokaleve) me qira në ZR të Pejës dhe ZR të Mitrovicës, implementimin efektiv të vendimeve të Bordit dhe Menaxhmentit nga ana e Departamentit të Koordinimit Rajonal gjegjësisht zyrat përkatëse, si dhe aktivitetet tjera të ndërmarra nga këto zyre. Auditimi në fjalë ka rezultuar me 4 rekomandime përkatëse.

6. **Auditimi i Departamentit të Prokurimit (DP)**: duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it, ky auditim ka filluar në fund të muajit Gusht. Auditimi në fjalë është përqendruar në rishikimin e procedurave për aktivitetet e prokurimit publik, duke përfshirë përgatitjen e planit të punës, përgatitjen e dosjes

së tenderit, vlerësimin e kontratave publike, specifikimet teknike, reklamimin dhe transparencën, udhëheqjen me procedurat e prokurimit dhe kërkesat mbi përshtatshmërinë, pagesat, përmbarimi i kontratës, etj. Bazuar në të gjeturat e auditimit dhe konkluzionet e dhëna, ky auditim ka rezultuar me 8 rekomandime përkatëse.

7. **Auditimi i Departamentit të Koordinimit të Likuidimit (DKL) dhe Autorititeteve të Likuidimit (AL)**: duke u bazuar në planin e punës së NJAB-it, ky auditim ka filluar në fund të muajit Tetor. Auditimi në fjalë është përqendruar kryesisht në rishikimin e procedurave të Autoriteteve të Likuidimit, gjegjësisht procesit të qiradhënies së aseteve nga AL-të. Pasi që ky auditim ka një kompleksitet më të madh, si dhe për shkak të vonesave në kompletimin e dokumentacionit nga Autoritetet e Likuidimit, ky auditim do të përmbyllet në fillim të vitit 2016.

8. **Auditimi i Divizionit të Shitjes, përkatësisht Njësisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes**: Objektivat kryesore të këtij auditimi janë bazuar në vlerësimin e rrezikut, të cilat janë të ndërlidhura me veprimet e ndërmarra brenda Divizionit të Shitjes, përkatësisht në Njësinë e Kontrollit dhe të Mbikëqyrjes, nëse këto veprime ishin në pajtueshmëri me kornizën ligjore të AKP-së. Pasi që gjatë këtij auditimi jemi ballafaquar me vonesën e ofrimit të disa informatave nga Sekretaria Ekzekutive e Bordit të Drejtorëve, e që kishin të bënin me disa vendime që ndërlidhen me Divizionin e Shitjes, puna rreth finalizimit të këtij raporti do të bëhet në fillim të vitit 2016.

9. **Auditimi mbi Përcjelljen e Implementimit të Rekomandimeve:** Ky auditim ka përfshirë përcjelljen e implementimit të rekomandimeve për auditimet e kryera gjatë periudhës 2009-2010-2011-2012-2013,2014 si dhe nëntëmujorin e vitit 2015. Departamentet dhe njësitë të cilat janë përfshirë në këtë auditim mbi përcjelljen e rekomandimeve janë si vijon: Njësinë e Burimeve Njerëzore, Divizionin e Likuidimit (Qeverisjes Koorporative), Departamentin e Shitjes, Sekretarinë Ekzekutimeve të Bordit të Drejtorëve, Departamentin Ligjor, Departamentin e Koordinimit të Likuidimit dhe Autoritetet e Likuidimit, Departamentin e Prokurimit, Departamentin e Financave dhe Buxhetit, Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Zyrat Rajonale përkatëse, Divizionin e Shitjes, Departamentin e Administratës, Njësinë e Riorganizimit, si dhe Njësinë për Marrëdhënie me Publikun dhe Medie. NJAB, ka bërë përcjelljen e 229 rekomandimeve, nga të cilat ka arritur të kuptoj se 106 rekomandimeve janë implementuar plotësisht apo 44 % e totalit, 44 rekomandime nuk janë implementuar fare ose shprehur në % i bie të jetë 26%. NJAB sipas testimeve të bëra ka vërejtur se 76 rekomandime të dhëna janë implementuar pjesërisht apo 29% e totalit të rekomandimeve të dhëna. Për më tepër për arsye objektive, NJAB nuk ka mundur të konstatoj për shkak të mungesës së informacioneve statusin e 3 rekomandimeve (1% të totalit) nëse ato janë zbatuar apo jo në praktikë, megjithatë me një auditim gjithëpërfshirës në vazhdimësi, ne do të mbledhim informacionet e duhura edhe për këtë kategori të rekomandimeve.

10. **Hartimi i Strategjisë (2016-2018) dhe Planit të Punës për 2016:** është rishikuar Strategjia e NJAB-it për vitet 2014-2016 dhe e njëjta pritet të amandamentohet për vitet 2016-2018. Po ashtu, duke iu referuar kërkesave që dalin nga Ligji i Auditimit të Brendshëm Nr.03/L-128, neni 14(8), kemi përgatitur Planin e Punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të AKP-së për vitin 2016. Për shkak të rrethanave të krijuara në AKP, pasi që Bordi i Drejtorëve nuk ishte funksional, dhe si rezultat i mos

funksionimit të tij nuk ka pasur mundësi që të aprovohet Plani i punës së NJAB-së nga Bordi i Drejtorëve. Andaj, për të përmbushur obligimet ligjore, ne e kemi përgatitur planin e punës së auditimit të brendshëm për vitin 2016 duke u bazuar në strategjinë e rishikuar të NJAB-it për periudhat 2014-2016 (e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve në vitin 2013). Në frymën e kësaj dhe duke e konsideruar aprovimin e planit strategjik, plani vjetor i NJAB-it për vitin 2016 është nënshkruar vetëm nga u.d Zëvendës Drejtorit Menaxhues – Likuidimi.

11. **Trajnimi i stafit të NJAB-së:** Gjatë periudhës raportuese stafi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm ka marrë pjesë në trajnimet/seminaret si në vijim:
    - Trajnimi për Licencimin e Vlerësuesve për Pronat e Paluajtshme;
    - Seminari i organizuar nga OSBE-ja: "Zhvillimi i kapaciteteve të Policisë së Kosovës në luftimin e korrupsionit të nivelit të lartë";
    - Trajnimi i organizuar nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave për Pamje dhe Raportim në Version e ri - V7.0.

5.13. NJËSIA PËR MEDIA DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Në përputhje me Planin Vjetor të Punës së AKP-së, raporti i Njësisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun për periudhën e vitit **2015** përfshinë realizimin e aktiviteteve të parapara për realizimin e objektivave të përgjithshme.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka siguruar përkrahje të plotë për të gjitha aktivitetet e realizuara nga AKP, Institucioneve të Shtetit dhe Organizatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja e komunikatave për media lidhur me takimet me Institucione ndërkombëtare dhe vendore , odat ekonomike dhe delegacione të ndryshme publikimin në veb faqen e Agjencisë, dhe përgatitja e komunikatave për media.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun është pikë kontaktuese me media në ofrimin dhe sigurimin e komunikimit me media lidhur me aktivitet e Agjencisë, si në pranimin e pyetjeve dhe në përgatitjen e përgjigjeve duke u koordinuar me departamentet/njësitë përkatëse dhe Drejtorin Menaxhues. Njësia ka pasqyruar aktivitetet e Agjencisë tek media dhe opinioni i gjerë, duke prezantuar aktivitetet dhe qëndrimet e Agjencisë në media.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka përgatitur rreth **300** përgjigje me shkrim të dërguara përmes emalit në pyetje të gazetarëve të medieve të ndryshme;

-Prononcime përmes telefonit – Mbi **130** prononcime me telefon;

-Përgjigje dhe prononcime në **Televizione** - (Rreth **50** prononcimet në TV);

-Përgjigje dhe prononcime në **Radio:** Rreth **100** prononcime për Radio vendore dhe ndërkombëtare;

Njësia për Marrëdhënie me Publikun dhe Media, gjatë vitit 2015 ka hartuar dhe dërguar për media dhe përmes tyre tek opinioni i gjerë mbi **24 Komunikata për Media** për aktivitetet e ndryshme të Agjencisë, ndërkaq ka lëshuar **3 Komunikata** në formë sqarimi/reagimi ndaj shkrimeve/deklaratave dezinformuese për Agjencinë.

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka vazhduar të populloj ueb faqen e AKP-së me të gjitha informatat në lidhje me aktivitetet e Agjencisë dhe procesin e privatizimit në Kosovë.

Marrëdhënie me Publik dhe Qasje në dokumente Publike

Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka bërë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në Dokumente, mbajtjen e evidencës së saktë për numrin e kërkesave për qasje në dokumente si dhe për numrin e lejuar apo refuzuar të këtyre kërkesave.

Janë përgatitur raporte të rregullta (çdo tre muaj) dhe këto raporte i janë dërguar njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, e cila përgatit raportin gjithëpërfshirëse të institucioneve publike, për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Numri i kërkesave të pranuara 2014					
Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E kufizuar	Pa përgjigje	Arsye tjera
15	**8**	**7**	-1	-	

5.14. KOMISIONET

Agjencia ka një numër të caktuar të komisioneve të cilat i kryejën detyrat sipas udhëzimeve të Bordit apo Menaxhmentit.

KOMISIONI I BANESAVE PËR NSH-TË - SHITJA

Komisioni ka regjistruar gjithsejtë **1376** kërkesa për blerje të banesave duke llogaritur nga 01/04/2012, prej të cilave deri me tani nga Bordi i AKP-së janë vendosur 574 kërkesa për shitjen e banesave.

- Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2015, nga Komisioni për Shitjen e Banesave janë shqyrtuar 527 kërkesa. Nga numri i kërkesave të shqyrtuara (527) në mënyrë meritore janë vendosur-rekomanduar dhe janë përfshirë në Raportet me Rekomandime për Bordin e Drejtorëve 396 kërkesa të cilat presin aprovimin final nga Bordi i Drejtorëve;
- Gjatë vitit 2015 janë përmbyllur 94 kontrata për shitjen e banesave;
- Gjatë periudhës raportuese janë pranuar 141 kërkesa të reja për blerjen e banesave të cilat janë sistemuar në databazën e kërkesave;
- Janë kontaktuar 761 palë për ti kompletuar dëshmitë e kërkesës;
- Gjatë periudhës raportuese janë kërkuar 478 konfirmime nga Agjencia Kosovare e Pronës lidhur me atë nëse banesat për të cilat palët kanë paraqitur kërkesë për shitjen e banesave pranë AKP-së kanë qenë objekt kontesti pranë ish Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore apo tani pranë Agjencisë Kosovare për Prona;
- Janë draftuar gjithsej 450 Memorandume Informuese për kërkesat e përcjellura në Komision për shqyrtim;

  Gjatë kësaj periudhe është bërë pranimi i 719 dokumenteve shtesë si përgjigje e palëve ndaj kërkesave të Komisionit për dokumente shtesë. Numër total i lëndëve të pa vendosura (rekomanduara Bordit) në Komision është 4**06.**

KOMISIONI PËR TRAJTIMIN E NDËRTIMEVE JOLIGJORE NË PRONAT E NSH-VE

Komisioni gjatë periudhës raportuese ka realizuar 14(katërmbëdhjetë) mbledhje me anëtarët e komisionit ku janë shqyrtuar lëndët nga zyret rajonale, gjatë periudhës raportuese janë aprovuar lëndët si në vijim:

-ZR. e Prishtinës me 55(pesëdhjetepesë) lëndë të aprovuara

-ZR. e Mitrovicës me 29(njëzetenëntë) lëndë të aprovuara

-ZR. e Gjilanit me 33(tridhjetetre) lëndë të aprovuara

-ZR. e Pejës me 9(nëntë) lëndë të aprovuara

Gjatë periudhës raportuese Komisioni ka përpiluar Raportin Referues për bord- Ndërmarrja Shoqërore

"Integj", Gjilan-085.

Në bashkëngjitje gjeni tabelen e rasteve të raportuara dhe të aprovuara në KNJoL:

Raste të raportuara në Komision:	214
Zyra Rajonale në Gjilan	48
Zyra Rajonale në Prishtinë	69
Zyra Rajonale në Mitrovicë	32
Zyra Rajonale në Prizren	37
Zyra Rajonale në Pejë	28
Raste të aprovuara	128

KOMISIONI PËR PËRCAKTIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE - KPS

Komisioni për përcaktimin e statusit juridik të ndërmarrjeve është Komision i themeluar me Vendim të Drejtorit Menaxhues të AKP-së më 15 Gusht 2012, në përputhje me nenin 11, pika 4 dhe nenin 16, pika 1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenit 2.1 të Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të aprovuara më 28 shtator 2011.

Ky komision është themeluar me qëllim të përcaktimit të statusit juridik të ndërmarrjeve dhe aseteve që bien në kompetencën administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Të dhënat lidhur me shqyrtimin e KPS-ne në periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2015 janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Statusi i KPS-ve	Janar-Dhjetor 2015
Numri i KPS-ve të shqyrtuara nga Komisioni dhe aprovuar nga Bordi i Drejtoreve	Nuk ka
Numri i KPS-ve të shqyrtuara nga Komisioni, por të pa aprovuara nga Bordi i Drejtorëve	12 KPS
Numri i KPS-ve në proces shqyrtimi	16 KPS
Numri i KPS-ve të shqyrtuara nga Komisioni, për të cilat është njoftuar Menaxhmenti i AKP-së lidhur me pengesat për aprovim te mëtutjeshëm në Bordin e Drejtorëve	4 KPS

6. PJESA TEKSTUALE E RAPORTIT FINANCIAR SIPAS FORMATIT TË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në këtë pjesë është paraqitur pjesa tekstuale e raportit vjetor financiar për Buxhetin e Kosovës sipas formatit raportues të aprovuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa tabelat financiare të këtij formati të raportimit janë paraqitur në shtojcë.

Raporti Financiar për vitin 2015 (buxheti vjetor)

Kodi i Organizatës Buxhetore: 239

Zyrtari Kryesor Administrativ:
Avni Jashari, u.d. Zëvendës Drejtor Menaxhues - likuidimi, Tel: 500 400 lok. 1088
E-mail: avni.jashari@pak-ks.org
Zyrtari Kryesor Financiar:
Adem Selishta, u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Tel:500 400 lok.1135
